

**DORACAK PËR SHKOLLA
VLERËSIMI NDËRKOMBËTAR
PISA NË LEXIM, MATEMATIKË
DHE SHKENCË**

Falënderim,

Duke parë rëndësinë që vlerësimi ndërkombëtar PISA ka për zhvillimin akademik dhe social të nxënësve në të gjitha vendet dhe ekonomitë që janë pjesë e vlerësimit, ngritja e rezultateve të nxënësve konsiderohet detyrë e domosdoshme e gjithë shoqërisë, veçanërisht atyre që merren me edukimin dhe mirëqenien e fëmijëve. Lidhur me këtë, bazuar edhe në rezultatet e vlerësimit PISA 2022, MASHTI ka vendosur që të ndërmarrë aktivitete promovuese dhe të ndërhyrjes në terren (siç është përmes mësimdhënësve), për ta mbështetur procesin e vlerësimit në mënyre që në të ardhmen të ngritet shkalla e rezultateve.

Për të ndihmuar realizimin e këtyre aktiviteteve është përgatitur edhe doracaku, i strukturuar në mënyrë lehtë të kuptueshme, me informata të përgjithshme dhe shembuj konkret nga testet e kaluara të vlerësimit ndërkombëtar, në këtë rast PISA.

Hartimi i këtij doracaku është mbështetur nga Ministria Arbërie Nagavci dhe Sekretarja e Përgjithshme Fadile Dyla. Grupi punues është udhëhequr nga Shqipe Bruqi, poashtu anëtare e Bordit Qendror PISA, ndërsa anëtarë dhe kontribues të grupit punues të përfshirë në hartimin e doracakut, janë Fatmir Elezi, Nizafete Bardhi Kutllovci, Vjollca Ymerhalili, Mirlinda Dehari Zeka nga DVSM, nga MASHTI dhe Vjollca Sopi, konsulente në MASHTI.

Shënim: materialet e përfshira në këtë Doracak janë nga dokumentet publike të OECD-së, dhe mund të përdoren vetëm për qëllime informimi dhe edukimi.

PËRMBAJTJA

I. PËRMBLEDHJE E SHKURTË	5
i. Qëllimi i këtij Udhëzuesi:	5
ii. Përmbajtja e Udhëzuesit	5
iii. Nxënësit pjesëmarrës në PISA.....	6
iv. Pyetësorët dhe llojet e pyetjeve në PISA 2022	6
II. VEÇORITË E VLERËSIMIT PISA	7
III. Fushat (lëndët) kryesore në PISA 2022	7
IV. FUSHA E LEXIMIT (LEXIMI SI FUSHË E VLERËSIMIT NDËRKOMBËTAR PISA	8
V. Detyrat.....	8
VI. Përcaktimi i niveleve të aftësisë për lexim	9
VII. Shembuj leximi.....	13
VIII. Fusha e matematikës	38
IX. Njohuri për përmbajtjen matematikore.....	38
X. Arsytimi në matematikë	39
XI. Zgjidhja e problemeve	39
XII. Përmbledhje e përshkrimit të tetë niveleve të aftësisë matematikore në PISA 2022	39
XIII. Shembuj nga Testi PISA në Matematikë:	42
XIV. Fusha e shkencës.....	67
XV. Shembuj nga fusha e shkencës nga testi PISA 2018	70
XVI. LITERATURA	84

I. PËRMBLEDHJE E SHKURTË

Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) lëshoi Programin për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve (PISA) në vitin 1997 dhe vlerësimi i parë që ofron dëshmi të krahasueshme ndërkombëtarisht mbi performancën e nxënësve, u krye në vitin 2000. Për shkak të pandemisë COVID-19, vlerësimi i planifikuar për vitin 2021, është shtyrë për në vitin 2022.¹

PISA është një vlerësim (pyetësor/test) trevjeçar i nxënësve 15-vjeçar në mbarë botën, që vlerëson shkallën e njohurive dhe shkathtësive kyçe thelbësore për pjesëmarrjen e plotë të tyre në jetën sociale dhe ekonomike. Vlerësimet e PISA-s, nuk konstatojnë vetëm atë se a mund të riprodhojnë atë që kanë mësuar nxënësit që janë afër përfundimit të arsimit të tyre të detyrueshëm; por gjithashtu edhe atë se sa mirë nxënësit mund të zgjerojnë ('ekstrapolojnë' - *veprimi i vlerësimit ose përfundimit të diçkaje duke supozuar se tendencat ekzistuese do të vazhdojnë ose një metodë aktuale do të mbetet e zbatueshme*" madhësitë u vlerësuan me *ekstrapolim*"), nga ajo që kanë mësuar dhe të zbatojnë njohuritë e tyre në mjedise të panjohura, si brenda dhe jashtë shkollës.

Republika e Kosovës për herë të parë në këtë vlerësim mori pjesë në vitin 2015, për të vazhduar pjesëmarrjen edhe në vitin 2018 dhe 2022 dhe do të marrë pjesë edhe në vitin 2025 dhe vlerësimet e tjera.

i. Qëllimi i këtij Udhëzuesi:

Ky Udhëzues, është menduar që t'u shërbejë mësimdhënësve, nxënësve, udhëheqësve të shkollave të Kosovës dhe komunitetit të interesuar, për t'u informuar lidhur me Programin ndërkombëtar të vlerësimit të nxënësve (PISA).

ii. Përmbajtja e Udhëzuesit

Udhëzuesi është i ndarë në 3 pjesë, bazuar në fushat e përcaktuara të vlerësimit të nxënësve:

1. Udhëzuesi për Lexim
2. Udhëzuesi për Matematikë
3. Udhëzuesi për Shkencë

Të tre udhëzuesit të cilët janë tërësisht të bazuar në dokumentet publike të OECD-së (të referencuara në fund të secilës faqe përkatëse të këtij dokumenti dhe po ashtu në pjesën e literaturës në fund të këtij dokumenti,) përfshijnë të dhëna informuese dhe vetëdijësuese për atë se:

1. Çka është PISA dhe çfarë matë ajo për secilën fushë të përcaktuar të vlerësimit - si dhe cili është qëllimi i saj (zbërthyer me shembujt e dhënë në praktikë)?
2. Cilat janë konceptet kryesore bazuar në vlerësimin PISA?
3. Cilat janë fushat kryesore të vlerësimit PISA dhe të rejtat e zhvillimit nëpër vite?
4. Nivelet e PISA-s/performancës sipas kriterëve të OECD-së (1 - 6, nga me i ulëti deri tek me i larti),
5. Cilët janë disa nga faktorët që ndikojnë në rezultatet (e mira/jo të mira) e nxënësve në vlerësimin PISA?

¹ PISA 2022 Results: The state of learning and equality in Education (për më shumë, shih, https://read.oecd-ilibrary.org/view/?ref=1235_1235421-gumq51fbgo&title=PISA-2022-Results-Volume-I)

iii. Nxënësit pjesëmarrës në PISA

Në PISA 2022, kane marrë pjesë gjithsej 690 000, duke përfaqësuar rreth 29 milionë 15-vjeçarë nga shkollat e 81 vendeve dhe ekonomive, ndërsa nga Republika e Kosovës kanë marrë 6027 nxënës (nga 6616 nxënës të përzgjedhur) nga 229 shkolla. Nxënësit që marrin pjesë në PISA janë të moshës nga 15 vjeç e 3 muaj deri në 16 vjeç e 2 muaj në kohën e vlerësimit dhe ata që kanë përfunduar së paku 6 vjet të shkollimit formal. Përdorimi i kësaj moshe nëpër vende, me kalimin e kohës i lejon PISA-s të krahasojë vazhdimisht njohuritë dhe aftësitë e individëve të lindur në të njëjtin vit, të cilët janë ende në shkollë në moshën 15-vjeçare, pavarësisht llojlojshmërisë së historive të tyre të arsimimit brenda dhe jashtë shkollës. Ata mund të regjistrohen në çfarëdo institucioni, të marrin pjesë në shkollim me kohë të plotë ose të pjesshme, në programe shkollorë/akademike ose profesionale dhe të ndjekin shkolla publike ose private ose shkolla të huaja brenda vendit.

iv. Pyetësorët dhe llojet e pyetjeve në PISA 2022

Pyetësorët janë bërë në kompjuter dhe nxënësit kanë pasur dy orë kohë në dispozicion për kryerjen e testit. Pyetjet kanë qenë të përziera, një pjesë e tyre me shumë zgjidhje dhe pyetjet tjera që kërkonin nga nxënësit që të ndërtojnë përgjigje. Pyetjet kanë qenë të organizuara në grupe dhe janë bazuar në situata reale jetësore, me nxënësit që kanë marrë kombinime të ndryshme të pyetjeve të testit.

Nxënësit, po ashtu i janë përgjigjur pyetësorit të prejardhjes që do të thotë, informata rreth shtëpive të tyre, shkollës dhe përvojave të tyre. Drejtorët e shkollave, po ashtu kanë plotësuar pyetësorët, lidhur me sistemin shkollor dhe mjedisin mësimor. Po ashtu, (meqë ky test përfshin edhe kohën e pandemisë), nga nxënësit janë kërkuar informata lidhur me pengesat për mësimin e nxënësve dhe informatat për mirëqenien në shkollë (pjesëmarrjen në sistemin arsimor).

Përgjatë 35 minutave, nxënësit iu përgjigjën një pyetësori historik në pyetjet lidhur me qëndrimet, prirjet dhe besimet e nxënësve, shtëpitë e tyre dhe përvojat e tyre shkollorë dhe mësimore. Drejtorët e shkollave plotësuan një pyetësor që mbulonte menaxhimin dhe organizimin e shkollës dhe mjedisin mësimor. Si nxënësit ashtu edhe shkollat iu përgjigjën pikave/çështjeve në Modulin e Krizave Globale në pyetësorët e tyre përkatës. Këto çështje synonin të nxirrnin perspektivat e tyre se si organizohej mësimi kur shkollat u mbyllën për shkak të pandemisë COVID-19. Po ashtu, disa vende/ekonomi, shpërndanë pyetësorë shtesë për të nxjerrë më shumë informacion. Këto përfshinin: një *pyetësor për mësuesit* që pyesnin për veten dhe praktikën e tyre të mësimdhënies dhe një *pyetësor për prindërit* që u kërkon atyre të japin informacion në lidhje me perceptimet e tyre dhe përfshirjen në shkollën dhe mësimin e fëmijës së tyre. Vendet/ekonomitë mund të zgjedhin gjithashtu të shpërndajnë dy pyetësorë të tjerë opsionalë për nxënësit: një *pyetësor për njohjen e nxënësve me kompjuterë* dhe një *pyetësor për mirëqenien e nxënësve*.

Për më shumë informata lidhur me mësimdhënësit, disa vende/ekonomi kanë shpërndarë pyetësorë për të mësuar për nevojat për trajnim dhe zhvillim profesional të mësimdhënësve, praktikën e tyre mësimore dhe sa të kënaqur janë ata me punën e tyre, derisa në disa vende/ekonomi tjera pyetësorë opsional janë shpërndarë edhe për prindërit, lidhur me perceptimin e tyre për dhe përfshirjen në shkollën e fëmijës së tyre, mbështetjen e tyre për mësimin në shtëpi dhe angazhimin e tyre me matematikë. Vendet/ekonomitë, po ashtu kanë mund të zgjedhin pyetësorë opsional për nxënësit lidhur me familjaritetin/njohurinë e tyre me/dhe përdorimin e teknologjisë informative dhe të komunikimit. Një pyetësor opsional për njohurinë financiare, po ashtu është shpërndarë për vendet/ekonomitë e OECD-së.

II. VEÇORITË E VLERËSIMIT PISA

PISA është një vlerësim i veçantë nga programet e tjera të vlerësimit, në kuptim të:

- **Orientimit të politikave** - që lidhë të dhënat për rezultatet e të nxënësve me të dhënat mbi prejardhjen dhe qëndrimet e nxënësve ndaj të nxënësve dhe me aspektet kyçe që formësojnë të nxënësve të tyre, brenda dhe jashtë shkollës.
(Me këtë, PISA mund të nxjerrë në pah ndryshimet në performancë dhe të identifikojë karakteristikat e nxënësve, shkollave dhe sistemeve arsimore që performojnë mirë).
- **Konceptit inovativ të kompetencës së të nxënësve**, - i referohet kapacitetit të nxënësve për të zbatuar njohuritë dhe shkathtësitë e tyre në fusha kyçe dhe për të analizuar, arsyetuar dhe komunikuar në mënyrë efektive, ndërsa identifikojnë, interpretojnë dhe zgjidhin problemet në situata të ndryshme.
- **Rëndësisë për të mësuarit gjatë gjithë jetës** - PISA u kërkon nxënësve të raportojnë mbi motivimin e tyre për të mësuar, bindjet e tyre për veten dhe strategjitë e tyre të të mësuarit.
- **Rregullsinë** - u mundëson vendeve të monitorojnë progresin e tyre në përmbushjen e objektivave kryesore të të mësuarit.
- **Mbulueshmërinë** - PISA 2022, ka përfshirë 37 vende të OECD-së dhe 44 vende dhe ekonomi partnere.²

III. Fushat (lëndët) kryesore në PISA 2022³

Testimi apo vlerësimi përmes programit PISA kryhet çdo tre vjet dhe fokusohet në tri fusha kryesore kurrikulare: shkencë, lexim dhe matematikë, por duke u zhvilluar me komponentë të reja, të nxitura nga zhvillimi teknologjik dhe shoqëror). PISA 2022 është përqendruar në matematikë, lexim, shkencë dhe të menduarit krijues (kreativ) si fusha të vlerësimit. Në vitin 2022 (po ashtu në 2012 dhe 2003), lënda kryesore ishte matematika. Leximi ka qenë lënda kryesore në 2000, 2009 dhe 2018, derisa shkenca ishte lënda kryesore në vitin 2006 dhe 2015. Mendimi kreativ, u vlerësua si një fushë e re për herë të parë në PISA 2022, po ashtu, PISA 2022 ka përfshirë edhe një vlerësim (opsional) të njohurive financiare. Në vijim janë dhënë disa përkufizime dhe përshkrime më të detajuara të temave të vlerësimit PISA 2022:⁴

- **MATEMATIKA** - aftësia e nxënësve për të arsyetuar matematikisht dhe për të formuluar, përdorur dhe interpretuar matematikën për të zgjidhur probleme në një sërë kontekstesh të botës reale. Kjo përfshin koncepte, procedura, fakte dhe mjete për të përshkruara, shpjeguar dhe parashikuar fenomene. Po ashtu, i ndihmon individët të bëjnë vlerësime (gjykime) dhe vendime të bazuara duke u bërë qytetarë konstruktiv, të angazhuar dhe reflektues të shekullit të 21-të.
- **LEXIMI** - aftësia e nxënësve për të kuptuar, përdorur, vlerësuar, reflektuar dhe angazhuar me tekstet për të arritur qëllimet, për të zhvilluar njohuritë dhe potencialin e tyre dhe për të marrë pjesë në shoqëri.
- **SHKRIM-LEXIMI SHKENCOR** - aftësia e nxënësve për t'u angazhuar si qytetar reflektues për çështje që lidhen me shkencën dhe me idetë e shkencës. Një person që di

² PISA 2022 Results: The state of learning and equality in Education (për më shumë, shih, https://read.oecd-ilibrary.org/view/?ref=1235_1235421-gumq51fbgo&title=PISA-2022-Results-Volume-I)

³ Po aty.

⁴ PISA 2022 Assessment and Analytical Framework, OECD, 2023

shkrim e lexim shkencor, është i gatshëm të përfshihet në një bisedë (diskurs) të arsyetuar rreth shkencës dhe teknologjisë, kërkon kompetenca për të shpjeguar fenomenet në mënyrë shkencore, për të vlerësuar dhe hartuar kërkime shkencore dhe për të interpretuar të dhënat dhe provat në mënyrë shkencore.

- **MENDIMI KRIJUES** - aftësia e nxënësve për t'u angazhuar në mënyrë produktive në gjenerimin, vlerësimin dhe përmirësimin e ideve që mund të rezultojnë në zgjidhje origjinale dhe efektive, përparime në njohuri dhe shprehje me ndikim të imagjinatës.

IV. FUSHA E LEXIMIT (LEXIMI SI FUSHË E VLERËSIMIT NDËRKOMBËTAR PISA⁵)

Sikur edhe më lartë, leximi ka qenë fusha kryesore e Programit për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve - PISA 2018. Përkufizimet lidhur me leximin dhe shkrim-leximin kanë ndryshuar me kalimin e kohës për të pasqyruar ndryshimet në shoqëri, ekonomi, kulturë dhe teknologji.

Të lexuarit nuk konsiderohet më një aftësi e fituar vetëm në fëmijëri gjatë viteve të para të shkollimit. Për më shumë, leximi shihet si një grup në zgjerim i njohurive, aftësive dhe strategjive që individët ndërtojnë gjatë gjithë jetës në kontekste të ndryshme, nëpërmjet ndërveprimit me bashkëmoshatarët e tyre dhe komunitetin më të gjerë. Kështu, leximi duhet të merret parasysh në mënyra të ndryshme në të cilat qytetarët ndërveprojnë dhe rolin e tij në të mësuarit gjatë gjithë jetës.

Në hartimin e vlerësimit të shkrim-leximit PISA, dy konsideratat më të rëndësishme janë, *së pari*, të sigurohet një mbulim i gjerë i asaj që lexojnë nxënësit dhe për çfarë qëllimesh ata lexojnë, si brenda dhe jashtë shkollës, dhe, *së dyti*, të përfaqësojë një gamë të natyrshme vështirësish në tekste dhe detyra.

Vlerësimi i PISA-s për aftësinë për lexim bazohet në tri karakteristika kryesore: teksti – diapazoni i materialit që lexohet; proceset – qasja njohëse që përcakton se si lexuesit angazhohen me një tekst; dhe skenarët – gamën e konteksteve ose qëllimeve të gjera për të cilat zhvillohet leximi. Ndërsa, brenda skenarëve janë detyrat - qëllimet e caktuara që lexuesit duhet të arrijnë në mënyrë që të kenë sukses.

V. Detyrat

Çdo skenar përbëhet nga një ose më shumë detyra. Në çdo detyrë, nxënësve mund t'u bëhen pyetje në lidhje me tekstet e përfshira në to, duke filluar nga artikujt tradicional të të kuptuarit (vendosja e informacionit, nxjerrja e një konkluzioni) deri te detyrat më komplekse si sinteza dhe integrimi i teksteve të shumta, vlerësimi i rezultateve të kërkimit në internet ose vërtetimi i informacionit në shumë tekste.

Çdo detyrë është projektuar për të vlerësuar një ose më shumë nga proceset e identifikuar në kuadër të kornizës së leximit. Detyrat në një skenar mund të renditen nga më pak të vështira tek ato më të vështira për të matur aftësitë e nxënësve.

Për shembull, nxënësi mund të ndeshet me një detyrë fillestare në të cilën ai ose ajo duhet të gjejë një dokument të caktuar bazuar në një rezultat kërkimi. Në detyrën e dytë, nxënësit mund t'i duhet t'i përgjigjet një pyetjeje në lidhje me informacionin që është shprehur në mënyrë specifike në tekst. Së fundi, në detyrën e tretë, nxënësit mund t'i duhet të përcaktojnë nëse këndvështrimi i autorit në tekstin e parë është i njëjtë me atë të një teksti të dytë.

⁵ <https://www.oecd-ilibrary.org/docserver/5c07e4f1-en.pdf?expires=1707741253&id=id&accname=guest&checksum=C8608D0F085A6E2223710D0810895015>

Detyrat e shkrim-leximit rregullohen përgjatë një shkalle që tregon nivelin e tyre të vështirësisë dhe nivelin e aftësisë që kërkohet për t'iu përgjigjur në mënyrë të saktë detyrës.

Detyrat e shkrim-leximit të përdorura në PISA ndryshojnë shumë nga situata, formati i tekstit dhe kërkesat e detyrës dhe ato gjithashtu ndryshojnë në vështirësi.

Vështirësia përcaktohet pjesërisht nga gjatësia, struktura dhe kompleksiteti i vetë tekstit. Janë një numër variablash të identifikuar që mund të ndikojnë në vështirësinë e çdo detyre të shkrim-leximit, duke përfshirë kompleksitetin dhe sofistifikimin e proceseve mendore integrale të procesit të detyrës (marrje, interpretim ose reflektim), sasinë e informacionit që lexuesi duhet të asimilojë dhe familjariteti ose specifika e njohurive që lexuesi duhet të nxjerrë si nga brenda ashtu edhe nga jashtë tekstit.

VI. Përcaktimi i niveleve të aftësisë për lexim

Tabela në vijim paraqet një përmbledhje të përshkrimit të tetë niveleve të aftësisë në lexim në PISA 2022

Niveli	Kufiri i pikëve nga më i ulëti	Përqindja e nxënësve që janë në gjendje të kryejnë detyra në çdo nivel apo më lartë (mesatarja e OECD)	Karakteristikat e detyrave
6	698	1.2%	Lexuesit në Nivelin 6 mund të kuptojnë tekste të gjata dhe abstrakte, në të cilat informacioni me interes është thellësisht i lidhur vetëm në mënyrë indirekte me detyrën. Ata mund të krahasojnë dhe integrojnë informacione që përfaqësojnë perspektiva të shumta dhe potencialisht të ndryshme, duke përdorur kritere të shumta dhe duke gjeneruar konkluzione në pjesë të caktuara se si mund të përdoret informacioni. Lexuesit në Nivelin 6 mund të reflektojnë thellë mbi burimin e tekstit në lidhje me përmbajtjen e tij, duke përdorur kritere të jashtme për tekstin. Ata mund të krahasojnë informacionin nëpër tekste, duke identifikuar dhe zgjidhur mospërputhjet dhe konfliktet ndërtekstuale përmes konkluzioneve rreth burimeve të informacionit, interesave të tyre të qarta ose të zotëruara, si dhe shenjave të tjera për vlefshmërinë e informacionit. Detyrat në nivelin 6 zakonisht kërkojnë që lexuesi të krijojë plane të përpunuara, duke kombinuar kritere të shumta dhe duke gjeneruar konkluzione për të lidhur detyrën dhe tekstin (et). Materialet në këtë nivel përfshijnë një ose disa tekste komplekse dhe abstrakte, që përfshijnë këndvështrime të shumta.
5	626	7.2%	Lexuesit në Nivelin 5 mund të kuptojnë tekste të gjata, duke nxjerrë përfundimin se cilat informacione në tekst janë të rëndësishme edhe pse informacioni me interes mund të anashkalohej lehtësisht. Ata mund të kryejnë forma që lidhen me shkakun ose forma të tjera arsyetimi bazuar në një kuptim të thellë të pjesëve të zgjeruara të tekstit. Ata

DORACAK PËR SHKOLLA VLERËSIMI NDËRKOMBËTAR
PISA NË LEXIM, MATEMATIKË DHE SHKENCË

			<p>gjithashtu mund t'u përgjigjen pyetjeve indirekte duke nxjerrë në përfundim marrëdhënien midis pyetjes dhe një ose disa pjesëve të informacionit të shpërndara brenda ose nëpër tekst dhe burime tjera të shumta. Detyrat reflektuese kërkojnë prodhimin ose vlerësimin kritik të hipotezave, duke u mbështetur në informacione specifike. Lexuesit mund të vendosin dallime midis përmbajtjes dhe qëllimit dhe midis faktit dhe opinionit siç zbatohet për deklarata komplekse ose abstrakte. Ata mund të vlerësojnë neutralitetin dhe paragjykimet bazuar në shenja të qarta ose të nënkuptuara që kanë të bëjnë me përmbajtjen dhe/ose burimin e informacionit. Ata gjithashtu mund të nxjerrin përfundime në lidhje me besueshmërinë e pretendimeve ose përfundimeve të ofruara në një pjesë të tekstit. Për të gjitha aspektet e leximit, detyrat në Nivelin 5 zakonisht përfshijnë trajtimin e koncepteve që janë abstrakte ose kundërintuitive dhe kalimin nëpër disa hapa derisa të arrihet qëllimi. Për më tepër, detyrat në këtë nivel mund t'i kërkojnë lexuesit të trajtojnë disa tekste të gjata, duke kaluar përpara dhe mbrapa nëpër tekste në mënyrë që të krahasojë informacionin.</p>
4	553	24.1%	<p>Në nivelin 4, lexuesit mund të kuptojnë paragrafe të zgjeruara në cilësime me tekst të vetëm ose të shumëfishtë. Ata interpretojnë kuptimin e nuancave të gjuhës në një pjesë të tekstit duke marrë parasysh tekstin në tërësi. Në detyra të tjera interpretuese, nxënësit demonstrojnë të kuptuarit dhe zbatimin e kategorive ad hoc. Ata mund të krahasojnë perspektivat dhe të nxjerrin përfundime bazuar në burime të shumta. Lexuesit mund të kërkojnë, lokalizojnë dhe integrojnë disa pjesë të informacionit të integruar në prani të distraktorëve (një përgjigje zakonisht e besueshme, por e pasaktë e dhënë si zgjedhje në një test me shumë zgjedhje). Ata mund të gjenerojnë konkluzione bazuar në deklaratën e detyrës në mënyrë që të vlerësojnë rëndësinë e informacionit të synuar. Ata mund të trajtojnë detyra që kërkojnë që ata të mësojnë përmendësh kontekstin e detyrës së mëparshme. Përveç kësaj, nxënësit e këtij niveli mund të vlerësojnë marrëdhënien midis deklaratave specifike dhe qëndrimit ose përfundimit të përgjithshëm të një personi për një temë. Ata mund të reflektojnë mbi strategjitë që autorët përdorin për të përcjellë pikat e tyre, bazuar në tipare të spikatura të teksteve (p.sh. tituj dhe ilustrime). Ata mund të krahasojnë dhe krahasojnë pretendimet e bëra në mënyrë eksplicite në disa tekste dhe të vlerësojnë besueshmërinë e një burimi bazuar në kriteret e spikatura. Tekstet në Nivelin 4 janë shpesh të gjata ose komplekse dhe përmbajtja ose forma e tyre mund të mos jenë standarde. Shumë nga detyrat janë të vendosura në</p>

DORACAK PËR SHKOLLA VLERËSIMI NDËRKOMBËTAR
PISA NË LEXIM, MATEMATIKË DHE SHKENCË

			cilësime me shumë tekst. Tekstet dhe detyrat përmbajnë sinjale indirekte ose të nënkuptuara
3	480	49,4%	Lexuesit në Nivelin 3 mund të përfaqësojnë kuptimin e mirëfilltë të teksteve të vetme ose të shumëfishta në mungesë të përmbajtjes eksplicite ose të dhënave organizative. Lexuesit mund të integrojnë përmbajtjen dhe të gjenerojnë konkluzione bazë dhe më të avancuara. Ata gjithashtu mund të integrojnë disa pjesë të një pjese teksti për të identifikuar idenë kryesore, për të kuptuar një marrëdhënie ose për të interpretuar kuptimin e një fjale ose fraze kur informacioni i kërkuar paraqitet në një faqe të vetme. Ata mund të kërkojnë informacion bazuar në udhëzimet indirekte dhe të gjejnë informacionin e synuar që nuk është në një pozicion të dukshëm dhe/ose është në prani të shpërqendruarve. Në disa raste, lexuesit në këtë nivel e njohin marrëdhënien midis disa pjesëve të informacionit bazuar në kritere të shumta. Lexuesit e nivelit 3 mund të reflektojnë në një pjesë të tekstit ose një grup të vogël tekstesh dhe të krahasojnë disa pikëpamje të autorëve bazuar në informacione të qarta. Detyrat reflektuese në këtë nivel mund të kërkojnë që lexuesi të bëjë krahasime, të gjenerojë shpjegime ose të vlerësojë një veçori të tekstit. Disa detyra reflektuese kërkojnë që lexuesit të demonstrojnë një kuptim të hollësishëm të një pjese teksti që trajton një temë të njohur, ndërsa të tjerat kërkojnë një kuptim bazë të përmbajtjes më pak të njohur. Detyrat në Nivelin 3 kërkojnë që lexuesi të marrë parasysh shumë veçori kur krahason, kundërshton ose kategorizon informacionin. Informacioni i kërkuar shpesh nuk është i dukshëm ose mund të ketë një sasi të konsiderueshme informacioni konkurrues. Tekstet tipike të këtij niveli mund të përfshijnë pengesa të tjera, të tilla si ide që janë në kundërshtim me pritshmëritë ose të formuluar negativisht.
2	407	73.7%	Lexuesit në Nivelin 2 mund të identifikojnë idenë kryesore në një pjesë teksti me gjatësi mesatare. Ata mund të kuptojnë marrëdhëniet ose të interpretojnë kuptimin brenda një pjese të kufizuar të tekstit kur informacioni nuk është i dukshëm duke prodhuar konkluzione bazë dhe/ose kur teksti/et përfshijnë disa informacione të shpërqendruara. Ata mund të zgjedhin dhe aksesojnë një faqe në një grup bazuar në kërkesa të qarta, por ndonjëherë komplekse, dhe të lokalizojnë një ose më shumë pjesë informacioni bazuar në kritere të shumta, pjesërisht të nënkuptuara. Lexuesit në Nivelin 2, kur nënkuptohen në mënyrë të qartë, mund të reflektojnë mbi qëllimin e përgjithshëm, ose për qëllimin e detajeve specifike, në tekste me gjatësi të moderuar. Ato mund të reflektojnë mbi veçori të thjeshta vizuale ose tipografike. Ata mund të krahasojnë


DORACAK PËR SHKOLLA VLERËSIMI NDËRKOMBËTAR
PISA NË LEXIM, MATEMATIKË DHE SHKENCË

			pretendimet dhe të vlerësojnë arsyet që i mbështesin ato bazuar në deklarata të shkurtra dhe të qarta. Detyrat në nivelin 2 mund të përfshijnë krahasime ose kontraste bazuar në një veçori të vetme në tekst. Detyrat tipike reflektuese në këtë nivel kërkojnë që lexuesit të bëjnë një krahasim ose disa lidhje midis tekstit dhe njohurive të jashtme duke u mbështetur në përvojën dhe qëndrimet personale.
1 a	335	90.3%	Lexuesit në Nivelin 1a mund të kuptojnë kuptimin e mirëfilltë të fjalive ose pjesëve të shkurtra. Lexuesit në këtë nivel mund të njohin gjithashtu temën kryesore ose qëllimin e autorit në një pjesë të tekstit për një temë të njohur dhe të bëjnë një lidhje të thjeshtë midis disa pjesëve të informacionit ngjitur, ose midis informacionit të dhënë dhe njohurive të tyre të mëparshme. Ata mund të zgjedhin një faqe përkatëse nga një grup i vogël bazuar në kërkesa të thjeshta dhe të gjejnë një ose më shumë pjesë të pavarura informacioni brenda teksteve të shkurtra. Lexuesit e nivelit 1a mund të reflektojnë mbi qëllimin e përgjithshëm dhe mbi rëndësinë relative të informacionit (p.sh. ideja kryesore kundrejt detajeve jo thelbësore) në tekste të thjeshta që përmbajnë sinjale të qarta. Shumica e detyrave në këtë nivel përmbajnë sinjale të qarta në lidhje me atë që duhet bërë, si të bëhet dhe ku në tekst/et, lexuesit duhet të përqendrojnë vëmendjen e tyre.
1b	262	97.9%	Lexuesit në nivelin 1b mund të vlerësojnë kuptimin e mirëfilltë të fjalive të thjeshta. Ata gjithashtu mund të interpretojnë kuptimin e mirëfilltë të teksteve duke bërë lidhje të thjeshta midis pjesëve të informacionit ngjitur në pyetje dhe/ose tekst. Lexuesit në këtë nivel mund të skanojnë dhe të gjejnë një pjesë të vetme të informacionit të vendosur dukshëm, të shprehur në mënyrë eksplicite në një fjali të vetme, një tekst të shkurtër ose një listë të thjeshtë. Ata mund të hyjnë në një faqe përkatëse nga një grup i vogël bazuar në udhëzime të thjeshta kur janë të pranishme shenja të qarta. Detyrat në nivelin 1b i drejtojnë në mënyrë eksplicite lexuesit që të marrin në konsideratë faktorët përkatës në detyrë dhe në tekst. Tekstet në këtë nivel janë të shkurtra dhe zakonisht ofrojnë mbështetje për lexuesin, si p.sh. përmes përsëritjes së informacionit, figurave ose simboleve të njohura. Ekziston një informacion minimal konkurrues.
1c	189	99.8%	Lexuesit në Nivelin 1c mund të kuptojnë dhe pohojnë kuptimin e fjalive të shkurtra, me sintaksë të thjeshta në një nivel të mirëfilltë dhe të lexojnë për një qëllim të qartë dhe të thjeshtë brenda një kohe të kufizuar. Detyrat në këtë nivel përfshijnë fjalor të thjeshtë dhe struktura sintaksore.

VII. Shembuj leximi

Përkufizimet e fushës

- ⇒ **Leximi:** Vlerësimi i leximit në PISA mat shkathtësinë e individit për të kuptuar, përdorur, vlerësuar, reflektuar dhe për tu angazhuar me tekste për të arritur qëllimet, për të zhvilluar njohurit dhe potencialet, si dhe për të marrë pjesë në shoqëri.
- ⇒ **Shkrim-leximi:** Përkufizohet si shkathtësia e nxënësve për të kuptuar, përdorur, vlerësuar, reflektuar tekstet e shkruara, për të arritur qëllimet e tyre. PISA vlerëson performancën e nxënësve në lexim përmes pyetjeve që përfshijnë një sërë:
 - **Proceset (aspektet):** Nxënësit nuk vlerësohen për shkathtësitë bazike të leximit, siç supozohet, se shumica e nxënësve 15-vjeçarë do t'i kenë fituar. Përkundrazi, nxënësit pritët të demonstrojnë aftësitë e tyre në gjetjen e informacionit, duke përfshirë qasjen dhe marrjen e informacionit brenda një pjese të tekstit, kërkimi dhe përzgjedhja e tekstit përkatës; kuptimin e tekstit, duke përfshirë edhe marrjen e një paraqitjeje të kuptimit të mirëfilltë të tekstit dhe ndërtimin e një paraqitjeje të integruar të tekstit; vlerësimin dhe reflektimin mbi tekstin, duke përfshirë edhe vlerësimin, cilësinë dhe besueshmërinë e tij, dhe reflektimin mbi përmbajtjen dhe formën.
 - **Formatet e tekstit:** PISA përdor tekste me një burim dhe me shumë burime; tekste statike dhe dinamike; tekste në vazhdimësi (të organizuara në fjali dhe paragrafë siç janë, gazetat, raportet, esetë, novelat, tekste të shkurta etj.).
 - tekste jo në vazhdimësi (p.sh. lista, formularë, grafikët ose diagramet); dhe tekste të përziera.
 - **Situatat:** Këto përcaktohen nga përdorimi për të cilin është ndërtuar teksti. Për shembull, një roman, letra personale ose biografia është shkruar për përdorim personal të njerëzve; dokumentet zyrtare ose shpalljet janë për përdorim publik; një manual ose raport është për përdorim profesional; dhe një libër shkollor ose fleta e punës është për përdorim edukativ. Meqenëse disa nxënës mund të performojnë më mirë në një lloj leximi në një situatë se sa në një tjetër, në tekst përfshihen një sërë situatash të leximit.



The screenshot shows the PISA interface with a blue header bar containing the word 'PISA', a progress indicator, a power button, a help icon, and navigation arrows. Below the header is a blue box titled 'Forumi për Pulat' with a sub-header 'Hyrije'. The main content area contains the following text:

Lexo Hyrjen. Më pas kliko shigjetën TJETËR.

Ti je duke i vizituar të afërmit e tu të cilët rishtazi janë vendosur në një fermë për të rritur pula. Ti pyet tezen tënde, "Si mësove të rritësh pulat?"

Ajo thotë, "Kemi biseduar me shumë njerëz që rrisin pula." Dhe ka shumë burime në internet. Për shembull, është një forum i Shëndetit të Pulave që dëshiroj ta vizitoj. Më ndihmoi shumë rishtazi kur njëra nga pulat e lëndoi këmbën e saj. Po të tregoj bisedën që e pata."

Kliko shigjetë TJETËR për të lexuar forumin.

PISA [Progress Bar] [Help Icon] [Navigation Icons]

ww.shëndetiipulës.com/ofrumi/aspirina-pulat

Shëndeti i Pulës
Burimi juaj online për pulat e shëndetshme

Rreth nesh | **Forumi** | Fotografitë

Dhënia e aspirinës pulave

Irma_88 FILLIMI I DISKUTIMIT Postuar më 28 tetor 18:12

Përsëritet gjithëherë!
A është në rregull t'i jap aspirinë pulës time? Ajo është 2 vjeçe dhe mendoj që e ka lënduar këmbën. S'mund të shkoj te veterinari deri të hënën, dhe veterinari nuk po përgjigjet në telefon. Pula ime duket të ketë shumë dhembje? Do të doja t'i jepja diçka që të ndjehet më mirë derisa të mund të shkoj te veterinari. Faleminderit për ndihmën tuaj.

NinaB79 Postuar 28 tetor 18:36

Nuk e di nëse aspirina është e parrezikshme për pulat apo jo. Gjithmonë konsultohem me veterinarin tim para se t'i jap barna zogjve të mi. E di që disa ilaçe të cilat janë të parrezikshme për njerëzit mund të jenë shumë të rrezikshme për zogjtë.

Monika Postuar 28 tetor 18:52

Ia dhashë një aspirinë njëres prej pulave të mia kur u lëndua. Nuk pati probleme. Ditën tjetër shkova tek veterinari por ajo ishte bërë më mirë. Mendoj që mund të jetë me rrezik nëse i jepni shumë, andaj mos e tejkaloni dozën! Shpresoj të ndihet më mirë!

Ofertat_për shpezëtari Postuar 28 tetor 19:07

Tung! Mos harroni t'i shikoni ofertat e mia super të ulta për të gjitha furnizimet për shpezë. Aktualisht kam shitje të madhe!

Bujari Postuar 28 tetor 19:15

A mundet dikush, ju lutem, të më tregojë si ta kuptoj se një pulë është sëmurë? Faleminderit.

Fredi Postuar 28 tetor 19:21

Procesi njohës	Paraqet kuptimin e drejtpërdrejtë
Formati i përgjigjes	Zgjedhje e thjeshtë e shumëfishtë – Kodim (pikëzim) me kompjuter
Vështirësia	328 – Niveli b1

Për kredi (pikë) të plota nxënësi zgjedh (A) “Nëse mund t'i japë aspirinë pulës sime”.

Në këtë kërkesë/pyetje, nxënësi duhet të marrë parasysh postimin e Irma_88 dhe të kuptojë kuptimin e mirëfilltë të postimit. Nxënësi duhet të përputhet me parafrazën e pyetjes fillestare të Irma_88 (A është në rregull t'i jap aspirinë pulës sime?) me opsionet në kërkesës/pyetjes. Kjo nuk është thjesht një kërkesë/pyetje "Qasja dhe marrja e informacionit brenda një teksti" sepse nuk ka një përputhje të drejtpërdrejtë dhe fjalë për fjalë midis opsioneve të kërkesës/pyetjes dhe materialit nxitës.

PISA

Forumi për Pulat
Pyetja 2 / 7

Referoju Forumit Shëndeti i Pulave në të djathtë. Kliko një alternativë për t'iu përgjigjur pyetjes.

Pse Irma_88 vendosi të postojë pyetjen e saj në një forum në internet?

- Sepse nuk di si të gjejë një veterinar.
- Sepse mendon se problemi i pulës nuk është serioz.
- Sepse dëshiron ta ndihmojë pulën e saj sa më shpejt që është e mundur.
- Sepse nuk ka mundësi të shkojë te veterinari.

Irma_88 FILLIMI I DISKUTIMIT Postuar më 28 tetor 18:12

Përsëritje të gjithëve!
A është në rregull t'i jap aspirinë pulës time? Ajo është 2 vjeçe dhe mendoj që e ka lënduar këmbën. S'mund të shkoj te veterinari deri të hënën, dhe veterinari nuk po përgjigjet në telefon. Pula ime duket të ketë shumë dhembje? Do të doja t'i jepja diçka që të ndjehet më mirë derisa të mund të shkoj te veterinari. Faleminderit për ndihmën tuaj.

NinaB79 Postuar 28 tetor 18:36

Nuk e di nëse aspirina është e parrezikshme për pulat apo jo. Gjithmonë konsultohem me veterinarin tim para se t'i jap barna zogjve të mi. E di që disa ilaçe të cilat janë të parrezikshme për njerëzit mund të jenë shumë të rrezikshme për zogjtë.

Monika Postuar 28 tetor 18:52

Ja dhashë një aspirinë njëres prej pulave të mia kur u lëndua. Nuk pati probleme. Ditën tjetër shkova tek veterineri por ajo ishte bërë më mirë. Mendoj që mund të jetë me rrezik nëse i jepni shumë, andaj mos e tejkaloni dozën! Shpresoj të ndihet më mirë!

Ofertat_për shpezëtari Postuar 28 tetor 19:07

Tung! Mos harroni t'i shikoni ofertat e mia super të ulta për të gjitha furnizimet për shpezë. Aktualisht kam shitje të madhe!

Bujari Postuar 28 tetor 19:15

A mundet dikush, ju lutem, të më tregojë si ta kuptoj se një pulë është sëmurë? Faleminderit.

Fredi Postuar 28 tetor 19:21

Tung Irma,
Unë jam veterinar i specializuar për zogjtë. Është mirë t'i japësh pulave të sëmurura aspirinë nëse tregojnë shenja se kanë dhimbje. Kur rekomandoj aspirinë shpezëve, ndjek udhëzimet e publikuara në Mjekësinë Klinike të Shpezëve. Pulat duhet të marrin 5mg aspirinë në një kg peshë të trupit. Mund t'ia jepni këtë 3-4 herë në ditë derisa të mund të shkoni te veterinari. Është shumë e rëndësishme të bëni vizitën tek veterineri. Paçi fat!

Procesi njohës	Integroni dhe gjeneroni konkluzione
Formati i përgjigjes	Zgjedhje e thjeshtë e shumëfishtë – Kodim (pikëzim) me kompjuter
Vështirësia	357 – Niveli 1a

Për kredi (pikë) të plota nxënësi/ja zgjedh (C) “Sepse ajo dëshiron të ndihmojë pulën e saj sa më shpejt të jetë e mundur”.

Në këtë kërkesë/pyetje, nxënësi/ja duhet të kuptojë postimin e Irma_88 në një nivel më të thellë se në kërkesën/pyetjen e mëparshme. Nxënësi/ja duhet të shkojë përtej asaj që përfaqësohet fjalë për fjalë në postim (nuk mund të shkojë te veterinari deri të hënën dhe veterinari nuk po përgjigjet në telefon), kontekstin e plotë të postimit të saj për të identifikuar përgjigjen e saktë. Nxënësi/ja mund të konkludojë se për shkak se pula e saj ka shumë dhimbje ajo nuk është në gjendje të marrë një përgjigje të shpejtë në një mënyrë tjetër (duke shkuar te veterinari ose duke e telefonuar), ajo ka postuar në forum.

Forumi për Pulat
Pyetja 3 / 7

Referoju Forumit Shëndeti i Pulave në të djathtë. Kliko alternativat në tabelë për t'u përgjigjur pyetjes.

Disa postime në forum mund të jenë relevante për temën ndërsa disa postime nuk janë. Kliko ose tek **Po** ose **Jo** për të treguar nëse postimet në tabelën më poshtë lidhen me problemin e Irma_88.

A lidhet postimi me problemin e Irma_88?	Po	Jo
Postimi i NinaB79	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Postimi i Monikës	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Postimi Ofertat_për Shpezëtari	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Postimi i Bujarit	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Postimi i Fredit	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>

Shëndeti i Pulës
Burimi juaj online për pulat e shëndetshme

Rreth nesh | Forumi | Fotografitë

Dhënia e aspirinës pulave

Irma_88 FILLIMI I DISKUTIMIT Postuar më 28 tetor 18:12

Pershëndetje të gjithëve!
A është në rregull t'i jap aspirinë pulës time? Ajo është 2 vjeçe dhe mendoj që e ka lënduar këmbën. S'mund të shkoj te veterinari deri të hënën, dhe veterinari nuk po përgjigjet në telefon. Pula ime duket të ketë shumë dhembje? Do të doja t'i jepja diçka që të ndjehet më mirë derisa të mund të shkoj te veterinari. Faleminderit për ndihmën tuaj.

NinaB79 Postuar 28 tetor 18:36

Nuk e di nëse aspirina është e parrezikshme për pulat apo jo. Gjithmonë konsultohem me veterinarin tim para se t'i jap barna zogjve të mi. E di që disa ilaçe të cilat janë të parrezikshme për njerëzit mund të jenë shumë të rrezikshme për zogjtë.

Monika Postuar 28 tetor 18:52

Ia dhashë një aspirinë njëres prej pulave të mia kur u lëndua. Nuk pati probleme. Ditën tjetër shkova tek veterineri por ajo ishte bërë më mirë. Mendoj që mund të jetë me rrezik nëse i jepni shumë, andaj mos e tejkaloni dozën! Shpresoj të ndihet më mirë!

Ofertat_për shpezëtari Postuar 28 tetor 19:07

Tung! Mos harroni t'i shikoni ofertat e mia super të ulta për të gjitha furnizimet për shpezë. Aktualisht kam shitje të madhe!

Bujari Postuar 28 tetor 19:15

A mundet dikush, ju lutem, të më tregojë si ta kuptoj se një pulë është sëmure?
Faleminderit.

Fredi Postuar 28 tetor 19:21

Procesi njohës	Reflektim për përmbajtjen dhe formën
Formati i përgjigjes	Zgjedhja komplekse e shumëfishtë – Pikëzim me kompjuter
Vështirësia	458 – Niveli 2

Për kredi (pikë) të plota, nxënësve iu kërkua të merrnin të sakta të 5 rreshtat: Po, Po, Jo, Jo, Po. Në këtë kërkesë/pyetje, nxënësi duhet të plotësojë një tabelë duke zgjedhur "Po" ose "Jo" për çdo rresht. Pyetja i kërkon nxënësit-es të identifikojë nëse çdo postim në forum është i rëndësishëm për temën. Nxënësi/ja duhet së pari të kuptojë kuptimin e mirëfilltë të çdo postimi dhe më pas të reflektojë mbi përmbajtjen dhe mënyrën se si ajo lidhet me temën kryesore - Dhënia e aspirinës për pulat.

PISA [Progress Bar] [Clock Icon] [Help Icon] [Navigation Icons]

www.shendetipules.com/ofrumi/aspirina-pulat

Shëndeti i Pulës
Burimi juaj online për pulat e shëndetshme

Rreth nesh | **Forumi** | Fotografitë

Dhënia e aspirinës pulave

Irma_88 FILLIMI I DISKUTIMIT Postuar më 28 tetor 18:12
Pershëndetje të gjithëve!
A është në rregull t'i jap aspirinë pulës time? Ajo është 2 vjeçe dhe mendoj që e ka lënduar këmbën. S'mund të shkoj te veterinari deri të hënën, dhe veterinari nuk po përgjigjet në telefon. Pula ime duket të ketë shumë dhembje? Do të doja t'i jepja diçka që të ndjehet më mirë derisa të mund të shkoj te veterinari. Faleminderit për ndihmën tuaj.

NinaB79 Postuar më 28 tetor 18:36
Nuk e di nëse aspirina është e parrezikshme për pulat apo jo. Gjithmonë konsultohem me veterinarin tim para se t'i jap barna zogjve të mi. E di që disa ilaçe të cilat janë të parrezikshme për njerëzit mund të jenë shumë të rrezikshme për zogjtë.

Monika Postuar më 28 tetor 18:52
Ia dhashë një aspirinë njëres prej pulave të mia kur u lëndua. Nuk pati probleme. Ditën tjetër shkova tek veterinari por ajo ishte bërë më mirë. Mendoj që mund të jetë me rrezik nëse i jepni shumë, andaj mos e tejkaloni dozën! Shpresoj të ndihet më mirë!

Ofertat_për shpezëtari Postuar më 28 tetor 19:07
Tung! Mos harroni t'i shikoni ofertat e mia super të ulta për të gjitha furnizimet për shpeze. Aktualisht kam shitje të madhe!

Bujari Postuar më 28 tetor 19:15
A mundet dikush, ju lutem, të më tregojë si ta kuptoj se një pulë është sëmure?
Faleminderit.

Fredi Postuar më 28 tetor 19:21

Procesi njohës	Paraqesin kuptimin e drejtpërdrejtë
Formati i përgjigjes	Zgjedhje e thjeshtë e shumëfishtë – Kodim (pikëzim) me kompjuter
Vështirësia	328 – Niveli 1b

Për kredi (pikë) të plotë përgjigja është (C) Monika.

Në këtë kërkesë/pyetje, nxënësit/es i kërkohet të kuptojë kuptimin e mirëfilltë të postimeve nga Irma 88, NinaB79, Monika dhe Bujari. Nëse nxënësi/ja ka kuptuar kuptimin e mirëfilltë të secilës, nxënësi/ja do të kuptonte që Irma 88 po pyet nëse ajo mund t'i japë aspirinë një pule, NinaB79 po paralajmëron Irma 88 për dhënie e ilaçeve për pulat, Bujari ka postuar diçka të parëndësishme dhe është Monika ajo që ka thënë se i ka dhënë aspirinë pulës së saj dhe ishte në rregull.

Procesi njohës	Integrimi dhe gjenerimi i konkluzioneve
Forma e përgjigjes	Zgjedhje e thjeshtë e shumëfishtë – Kodimi (pikëzimi) me kompjuter
Vështirësia	347 – Niveli 1a

Për kredi (pikë) të plotë përgjigja është (A) Për të promovuar një biznes.

Në këtë kërkesë/pyetje, nxënësi/ja duhet të shkojë përtej kuptimit të mirëfilltë të dhënë në tekstin e postimit të Oferta për Shpezitari dhe të bëjë një përfundim se pse ky person e ka bërë postimin. Postimi nga Oferta për Shpezitari nuk thotë në mënyrë eksplicite se ata po promovojnë biznesin e tyre, kështu që nxënësi/ja duhet të konkludojë për këtë nga informacioni i dhënë në postim.

The screenshot shows a web browser window with the URL www.shëndetiipulës.com/ofrumi/aspirina-pulat. The page title is "Shëndeti i Pulës" (Chicken Health) and it is described as "Burimi juaj online për pulat e shëndetshme" (Your online source for healthy chickens). The forum has three tabs: "Rreth nesh" (About us), "Forumi" (Forum), and "Fotografitë" (Photos). The main content is a thread titled "Dhënia e aspirinës pulave" (Giving aspirin to chickens). The first post is by Irma_88, asking if aspirin is safe for chickens. Other users like NinaB79, Monika, and Fredi respond with advice and information about chicken health and aspirin use.

Procesi njohës	Vlerësoni cilësinë dhe besueshmërinë
Formati i përgjigjes	Përgjigje e hapur – Koduar nga vlerësuesi
Vështirësia	409 – Niveli 2

Për pikë të plota, nxënësi/ja mund të zgjedhë çdo opsion përveç Ofertat_për Shpezëtari dhe të marrë pikë me kusht që nxënësi/ja, të japë një nga elementët e saktë të përshkruar më poshtë, i cili mbështet arsyen pse përzgjedhja është e besueshme.

- Zgjedh ose përgjigjet NinaB79 në mënyrë eksplicite ose të nënkuptuar DHE thekson se përgjigja e NinaB79 nënkuptonte që Irma_88 duhet të kontrollojë pulën e saj te veterineri i saj përpara se t'i japë asaj ndonjë.
 - [NinaB79] NinaB79 tha se fillimisht ta pyeste veterinerin e saj
 - [Pa përzgjedhje] NinaB79 nuk i tha Irma_88 çfarë të bënte, por ajo tha se ta kontrollon te veterineri i saj përpara se të japë ilaçe.
 - Zgjedh ose i përgjigjet Monika në mënyrë eksplicite ose implicite DHE thotë se Monika i dha aspirinë pulës së saj dhe pula u shërua.
 - [Monika] Monika i dha aspirinë pulës së saj dhe zogu u bë më mirë.
 - [Monika] Monika ka një pulë që u shërua kur i dha aspirinë.
 - Zgjedh ose përgjigjet Fredi në mënyrë eksplicite ose implicite DHE deklaron se Fredi është veterinar/specialist i shpendëve ose ka njohuri për trajtimin e zogjve.
 - [Fredi] Ai është veterinar.
 - [Fredi] Fredi është i specializuar për zogjtë.
 - [Fredi] Fredi i njeh udhëzimet e dozimit për pulat.
 - [Pa përzgjedhje] Fredi flet për një libër rreth mjekësisë së shpendëve.

PISA [Progress Bar] [Clock]

www.shëndetiipulës.com/ofrumi/aspirina-pulat

Shëndeti i Pulës

Burimi juaj online për pulat e shëndetshme

Rreth nesh | **Forumi** | Fotografitë

Dhënia e aspirinës pulave

Irma_88 FILLIMI I DISKUTIMIT Postuar më 28 tetor 18:12

Përshendetje të gjithëve!
A është në rregull t'i jap aspirinë pulës time? Ajo është 2 vjeçe dhe mendoj që e ka lënduar këmbën. S'mund të shkoj te veterinari deri të hënën, dhe veterinari nuk po përgjigjet në telefon. Pula ime duket të ketë shumë dhembje? Do të doja t'i jepja diçka që të ndjehet më mirë derisa të mund të shkoj te veterinari. Faleminderit për ndihmën tuaj.

NinaB79 Postuar 28 tetor 18:36

Nuk e di nëse aspirina është e parrezikshme për pulat apo jo. Gjithmonë konsultohem me veterinarin tim para se t'i jap barna zogjve të mi. E di që disa ilaçe të cilat janë të parrezikshme për njerëzit mund të jenë shumë të rrezikshme për zogjtë.

Monika Postuar 28 tetor 18:52

Ia dhashë një aspirinë njëres prej pulave të mia kur u lëndua. Nuk pati probleme. Ditën tjetër shkova tek veterinari por ajo ishte bërë më mirë. Mendoj që mund të jetë me rrezik nëse i jepni shumë, andaj mos e tejkaloni dozën! Shpresoj të ndihet më mirë!

Ofertat_për shpezëtari Postuar 28 tetor 19:07

Tung! Mos harroni t'i shikoni ofertat e mia super të ulta për të gjitha furnizimet për shpezë. Aktualisht kam shitje të madhe!

Bujari Postuar 28 tetor 19:15

A mundet dikush, ju lutem, të më tregojë si ta kuptoj se një pulë është sëmurë? Faleminderit.

Fredi Postuar 28 tetor 19:21

Procesi njohës	Integroni dhe gjeneroni(nxirrni) konkluzione nëpër burime të shumta
Formati i përgjigjes	Përgjigje e hapur – Koduar (pikëzuar) nga vlerësuesi
Vështirësia	466 – Niveli 2

Kredi (pikë) të plota jepen kur nxënësi deklaron se pesha ose madhësia e pulës nuk është dhënë/nuk dihet.

PISA

Rapa Nui
Pyetja 1 / 7


Referoju pjesës Blogu i Profesoreshës në të djathtë. Kliko një alternativë për t'iu përgjigjur pyetjes.

Sipas blogut, kur e filloi punën në terren profesoresha?

- Gjatë viteve 1990.
- Nëntë muaj më parë.
- Një vit më parë.
- Në fillim të Majit.

Blog


www.bloguiprofesoreshës.com/punanëterren/RapaNui

 Blogu i Profesoreshës






Postuar 23 maj, ora 11:22

Ndërsa vështroj tej dritares këtë mëngjes, shikoj panoramën që kam mësuar të dua këtu në Rapa Nui, të njohur në disa vende me emrin Ishulli i Pashkëve. Bari dhe kaçubet janë të gjelbërta, qielli është i kaltër, dhe vullkanet e vjetër, tashmë të shuar, ngrihen në sfond.

Jam paksa e pikëlluar duke e ditur që kjo është java ime fundit në ishull. Kam mbaruar punën në terren dhe do të kthehem në shtëpi. Më vonë sot, do të bëj një shëtitje nga kodrat për t'i thënë mirupafshim moait që kam studiuar gjatë nëntë muajve të fundit. Ja një foto e disa prej këtyre statujave masive.



Nëse e keni ndjekur blogun tim këtë vit, atëherë e dini se populli i Rapa Nui i ka skalitur këto moai qindra vjet më parë. Këto moai mbresëlënëse janë skalitur në një gurorë të vetme në pjesën lindore të ishullit. Disa prej tyre peshojnë mijëra kilogramë, por megjithatë populli i Rapa Nui ka qenë në gjendje t'i zhvendosë ato

PISA     

Rapa Nui
Hyrje

Lexo Hyrjen. Më pas kliko shigjetë TJETER.

Imagjino se një bibliotekë lokale po mban një leksion javën që vjen. Ligjërata do të mbahet nga një profesorëshë e universitetit të afërt. Ajo do të diskutojë punën e saj në terren në ishullin e Rapa Nui në Oqeanin Paqësor, më shumë se 3.200 kilometra në perëndim të Kilit.

Klasa e historisë do të ndjekë leksionin. Mësimdhënësi juaj ju kërkon të interesoheni për historinë e Rapa Nui në mënyrë që do të dini diçka para se të ndiqni ligjëratarën.

Burimi i parë që do të lexosh është një blog i shkruar nga një profesorëshë derisa ajo ka jetuar në Rapa Nui.

Kliko shigjetën TJETER për të lexuar blogun.

Procesi njohës	Qasja dhe marrja e informacionit brenda një teksti
Formati i përgjigjes	Zgjedhje e thjeshtë e shumëfishtë –Kodim (pikëzim) me kompjuter
Burimi i kërkesës së burimit për kërkesën/pyetjen	E thjeshtë
Vështirësia	559 – Niveli 4

Përgjigja më e saktë është (B)

Në këtë kërkesë/pyetje, nxënësi/ja duhet të gjejë informacionin e saktë brenda postimit në blog. Vështirësia e saj ka të ngjarë të nxitet nga ekzistenca e informacioneve të tjera të lidhura me kohën brenda blogut, d.m.th. nga data e postimit dhe periudha kohore në të cilën u zgjidh misteri i parë i moait (vitet 1990).

PISA

?
◀ ▶

Rapa Nui
Pyetja 2 / 7

Referoju pjesës Blogu i Profesoreshës në të djathtë. Shtyp përgjigjen tënde për pyetjen.

Në paragrafin e fundit të blogut, profesoresha shkruan: "Një mister tjetër mbetet..."

Cilët mister i referohet ajo?

Blog

www.bloguiprofesoreshës.com/punanëterren/RapaNui

Nëse e keni ndjekur blogun tim këtë vit, atëherë e dini se populli i Rapa Nui i ka skalitur këto moai qindra vjet më parë. Këto moai mbresëlënëse janë skalitur në një gurorë të vetme në pjesën lindore të ishullit. Disa prej tyre peshojnë mijëra kilogramë, por megjithatë populli i Rapa Nui ka qenë në gjendje t'i zhvendosë ato në vendet shumë larg nga gurorja, pa vinça ose pajisje të tjera të rënda.

Për vite, arkeologët nuk e dinin sesi ishin zhvendosur këto statuja masive. Ka mbetur mister deri në vitet 1990, kur një grup arkeologësh dhe banorësh të Rapa Nui demonstroi se statujat moai mund të jenë transportuar dhe ngritur me anë të litarëve të bërë nga bimët dhe cilindra druri dhe rrugë të bëra nga pemët e mëdha që dikur lulëzonin në ishull. Misteri i moaive u zgjidh.

Megjithatë, mbetet një mister tjetër. Çfarë ndodhi me këto bimë dhe pemë të mëdha që u përdorën për zhvendosjen e statujave moai? Siç thashë, ndërsa vështroni teç dritares, shoh barëra dhe kaçube dhe një a dy pemë të vogla, por asgjë që mund të jetë përdorur për zhvendosjen e këtyre statujave të mëdha. Është një gjëgjëzë mahnitëse, një që do të eksplorohet në postimet dhe ligjëratat e ardhshme. Deri atëherë, ju mund të dëshironi të investigoni misterin vetë. Sugjeroj të filloni me një libër të quajtur *Shkatërrimi* nga Jared Diamond. [Kjo recencë e Shkatërrimi është një vend i mirë për të filluar.](#)

Udhëtari_14

24 maj, ora 16:31

Përsëritje Profesoreshë! Më pëlqen të ndjek punën tuaj në Ishullin e Pashkës. Mezi pres ta lexoj *Shkatërrimin!*

Ishulli_KB

25 maj, ora 9:07

Gjithashtu më pëlqen të lexoj për përvojat tuaja në Ishullin e Pashkëve, e megjithatë, mendoj se ka një teori tjetër që duhet të merret në konsideratë. Shikoni këtë artikull: [www.lajmeshkencore.com/Minjete_Polineziane_Rapa_Nui](#)

Procesi njohës	Paraqesin kuptimin e drejtpërdrejtë
Formati i përgjigjes	Përgjigje e hapur – Koduar (pikëzuar) nga vlerësuesi
Kërkesa e burimit për kërkesën/pyetjen	E thjeshtë
Vështirësia	513 – Niveli 3

- Kredi (pikë) të plota u jepet përgjigjeve që i referohen zhdukjes së materialeve të përdorura për të lëvizur statujat (moai).
 - Çfarë ndodhi me këto bimë dhe pemë të mëdha që ishin përdorur për të lëvizur moain? [Citim i drejtpërdrejtë]
 - Nuk ka mbetur asnjë pemë e madhe që mund të kishte lëvizur moain.
 - Ka barëra, shkurre dhe disa pemë të vogla, por nuk ka pemë aq të mëdha sa të lëvizin statujat e mëdha.
 - Ku janë pemët e mëdha? [Minimal]
 - Ku janë bimët? [Minimal]
 - Çfarë ndodhi me burimet që nevojiteshin për transportimin e statujave?
 - Ajo po i referohej asaj që e lëvizi Moain sepse kur shikoi përreth nuk kishte pemë apo bimë të mëdha. Edhe ajo po pyet se çfarë ka ndodhur me ta. [Edhe pse kjo përgjigje fillon duke iu referuar misterit të gabuar, ajo përmban elementet e duhura.]

Në këtë kërkesë/pyetje, nxënësi duhet të kuptojë se misteri i dytë i përmendur në postimin në blog - çfarë ndodhi me pemët e mëdha që dikur u rritën në Rapa Nui dhe u përdorën për të lëvizur moai? Për këtë kërkesë/pyetje, nxënësi mund të sigurojë një citim të drejtpërdrejtë nga blogu ("Çfarë ndodhi me këto bimë dhe pemë të mëdha që ishin përdorur për të lëvizur moai?") ose një parafrazë të saktë.

PISA ?

Rapa Nui
Pyetja 3 / 7

Referoju pjesës Recenca e librit Shkatërrimi në të djathtë. Kliko alternativat në tabelë për t'iu përgjigjur pyetjes.

Të renditura më poshtë janë thënie nga Recenca e librit Shkatërrimi. A janë thënie fakte apo opinione? Kliko ose tek **Fakt** ose **Opinion** për secilën thënie.

A është thënia fakt apo opinion?	Fakt	Opinion
Në libër, autori përshkruan disa civilizime që u shkatërruan për shkak të zgjedhjeve që bënë dhe ndikimi i tyre në mjedis.	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Një nga shembujt më shqetësues në libër është Rapa Nui.	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Ata skalitën moait, statujat e famshme, dhe përdorën burimet natyrore të disponueshme për t'i zhvendosur këto moait të mëdha në vende të ndryshme të ishullit.	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Kur Evropianët e parë zbarkuan në Rapa Nui në 1722, moait ishin akoma aty, por pemët ishin zhdukur.	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Libri është shkruar mirë dhe meriton të lexohet nga çdokush që shqetësohet për mjedisin.	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>

Blog Recensë Libri
www.recenselibriakademik.com/Shkatërrimi

Recensë e librit Shkatërrimi

Libri i ri nga Jared Diamond, *Shkatërrimi*, është një paralajmërim për pasojat e dëmtimit të mjedisit tonë. Në libër, autori përshkruan disa civilizime që u shkatërruan për shkak të zgjedhjeve që bënë dhe impakti i tyre në mjedis. Një nga shembujt më shqetësues në libër është Rapa Nui.

Sipas autorit, Rapa Nui u popullua nga Polinezianët diku pas viteve 700 mb. K. Ata zhvilluan një shoqëri të lulëzuar me, ndoshta, 15.000 njerëz. Ata skalitën moait, statujat e famshme, dhe përdorën burimet natyrore të disponueshme për t'i zhvendosur këto statuja të mëdha në vende të ndryshme rreth ishullit. Kur Evropianët e parë zbarkuan në Rapa Nui në 1722, moait ishin akoma aty, por pemët ishin zhdukur. Popullsia ishte pakësuar në disa qindra njerëz, që po përiqeshin të mbijetonin. Z. Diamond shkruan se populli i Rapa Nui e pastroi token për bujqësi dhe qëllime të tjera dhe se ata i shfarosën duke i gjuajtur speciet e shumta në det dhe zogjtë në tokë që jetonin në ishull. Ai spekulon se pakësimi i burimeve natyrore çoi në lufta civile dhe shkatërrimin e shoqërisë së Rapa Nui.

Mësimi nga ky libër i mrekullueshëm por frikësues është se në të kaluarën, njerëzit zgjedhën të shkatërronin mjedisin e tyre duke prerë të gjitha pemët dhe gjuajtur deri në shfarosjen llojet e kafshëve. Me optimizëm, autori nxjerr në pah se ne mund të zgjedhim **të mos** bëjmë të njëjtat gabime sot. Libri është shkruar mirë dhe meriton të lexohet nga çdokush që shqetësohet për mjedisin.

Procesi njohës	Reflektoni për përmbajtjen dhe formën
Formati i përgjigjes	Zgjedhje e thjeshtë e shumëfishtë – Kodim (pikëzim) me kompjuter
Kërkesa për burimin e kërkesës/pyetjes	E thjeshtë
Vështirësia	654 – Niveli 5

Përgjigjet e sakta janë: Fakt, Opinion, Fakt, Fakt, Opinion.

Për të marrë kreditë (pikët) e plota për këtë kërkesë/pyetje, nxënësit/es iu kërkuar të merrte të sakta të 5 rreshtat.

Për kredi (pikë) të pjesshme, nxënësve iu kërkuar të merrnin saktë 4 nga 5 rreshtat.

Nëse nxënësit kishin më pak se 4 rreshta të sakta, ata nuk merrnin pikë.

Për këtë kërkesë/pyetje, nxënësit/es i prezentohet teksti i dytë në njësinë (fragmenti), një përmbledhje e librit të Kolapsit, i cili u referua në postimin në blog. Nxënësi /ja duhet të plotësojë një tabelë duke zgjedhur “Fakt” ose “Opinion” për çdo rresht. Kërkesa/pyetja i kërkon nxënësit/es të identifikojë nëse çdo pohim nga rishikimi i librit është fakt apo opinion. Nxënësi/ja duhet së pari të kuptojë kuptimin e mirëfilltë të çdo deklaratë dhe më pas të vendosë nëse përmbajtja ishte faktike apo përfaqësonte këndvështrimin e autorit të rishikimit. Në këtë mënyrë, nxënësi/ja duhet të përqendrohet në përmbajtjen dhe mënyrën se si paraqitet dhe jo vetëm në kuptimin.

PISA

Rapa Nui
Pyetja 4 / 7

Referoju artikullit "A i shkatërruan Brejtësit Polinezianë pemët në Rapa Nui?" në të djathtë. Kliko një alternativë për t'u përgjigjur pyetjes.

Çfarë përmendin shkencëtarët në artikull me të cilin bie dakord dhe Jared Diamond ?

- Njerëzit janë vendosur në Rapa Nui para qindra vitesh.
- Pemët e larta janë zhdukur nga Rapa Nui.
- Brejtësit polinezian hëngrën farat e pemëve të mëdha në Rapa Nui.
- Evropianët mbërritën në Rapa Nui në shekullin e 18^{të}.

Blog Recencë Libri Lajme Shkencore

www.lajmeshkencore.com/Brejtësit_polinezianë_Rapa_Nui

LAJME SHKENCORE

A i shkatërruan Brejtësit Polinezianë pemët në Rapa Nui?
Nga Mondit Kruja, Reporter Shkencor

Në vitin 2005, Jared Diamond botoi *Shkatërimi*. Në libër, ai përshkroi popullimin e njerëzve të Rapa Nui (të quajtur gjithashtu si Ishulli i Pashkëve).

Libri shkaktoi një mosmarrëveshje të madhe menjëherë pas botimit të tij. Shumë shkencëtar vunë pikëpyetje mbi teorinë e Diamondit për atë që ndodhi në Rapa Nui. Ata bien dakord se pemët e mëdha ishin zhdukur në kohën kur mbërritën Evropianët e parë në ishull në shek. e 18^{te}, por nuk binin dakord me teorinë e Jared Diamond për shkakun e zhdukjes.

Tani, dy shkencëtarë, Carl Lipo dhe Terry Hunt, kanë publikuar një teori të re. Ata besojnë se brejtësit Polinezianë i hëngrën farat e pemëve, duke penguar rritjen e pemëve të reja. Ata besojnë se brejtësit u sollën ose aksidentalisht ose qëllimisht me kanoet e përdorura nga njerëzit e parë që u vendosën në Rapa Nui.

Studimet kanë treguar se popullata e brejtësve mund të dyfishohet çdo 47 ditë. Këta janë shumë brejtës për t'u ushqyer. Për të mbështetur teorinë e tyre, Lipo dhe Hunt tregojnë shenjat e bëra nga brejtësit në mbetjet e arrave të palmave. Sigurisht, ata pranojnë se njerëzit luajtën një rol në shkatërimin e pyjeve në Rapa Nui. Por besojnë se brejtësi Polinezian ka qenë keqbërësi edhe më i madh mes një sërë faktorësh.

Procesi njohës	Qasja dhe marrja e informacionit brenda një teksti
Formati i përgjigjes	Zgjedhje e thjeshtë e shumëfishtë – Kodim (pikëzim) me kompjuter
Burimi i kërkesës për kërkesën/pyetjen	E thjeshtë
Vështirësia	634 – Niveli 5

Përgjigja e saktë është (B) Pemë të mëdha janë zhdukur nga Rapa Nui.

Për këtë kërkesë/pyetje, nxënësit/es i prezantohet teksti i tretë i njësisë, një artikull nga një revistë shkencore online. Vini re, se në këtë pikë të njësisë, të tre tekstet janë në dispozicion të nxënësit/es duke përdorur një strukturë skedash; nxënësi mund të klikojë në çdo skedë për të kaluar përpara dhe mbrapa midis teksteve. Vetë kërkesa/pyetja mbetet e fiksuar në anën e majtë të ekranit gjatë çdo veprimi ndërrimi. Në këtë kërkesë/pyetje, nxënësit i kërkohej të gjejë seksionin e artikullit që përmban referencën për shkencëtarin dhe Jared Diamond (paragrafi 2) dhe të identifikojë fjalinë që përmban informacionin për të cilin është rënë dakord. Ndërsa tekstet janë të disponueshme për nxënësin/en, ky artikull nuk klasifikohet me një proces njohës që pasqyron përdorimin e burimeve të shumta. Kjo ndodh sepse nxënësi mund ta gjejë përgjigjen brenda këtij teksti dhe udhëzimet e kërkesës/pyetjes në këndin e sipërm majtas e udhëzojnë nxënësin t'i referohet vetëm këtij artikulli. Kështu, mbështetja nga udhëzimet e kërkesës/pyetjes eliminon nevojën për të marrë parasysh burimet e tjera. Vështirësia e kësaj kërkesë/pyetjeje ka të ngjarë të shkaktohet nga ekzistenca e informacionit të besueshëm (por të pasaktë) shpërqendruar brenda paragrafit në lidhje me vendbanimin njerëzor.

The screenshot shows a PISA test interface. On the left, there is a sidebar with the title 'Rapa Nui' and 'Pyetja 5 / 7'. Below this, there is a reference to an article 'Referoju artikullit "A i shkatërruan Brejtësit Polinezianë pemët në Rapa Nui?" në të djathtë. Kliko një alternativë për t'iu përgjigjur pyetjes.' and a question: 'Çfarë provash paraqesin Carl Lipo dhe Terry Hunt për të mbështetur teorinë e tyre se pse u zhdukën pemët e mëdha në Rapa Nui?'. There are four radio button options: 'Bretjtësit arritën në ishull me kanonet e njerëzve të parë që u vendosën aty.', 'Bretjtësit mund të jenë sjellë nga njerëzit e parë që u vendosën aty qëllimisht.', 'Popullat e bretjtësve mund të dyfishohet çdo 47 ditë.', and 'Mbetjet e arrave të palmave tregojnë shenjat e bëra nga bretjtësit.' On the right, there is a browser window showing a news article titled 'LAJME SHKENCORE' with the sub-header 'A i shkatërruan Brejtësit Polinezianë pemët në Rapa Nui?' and the author 'Nga Mondit Kruja, Reporter Shkencor'. The article text discusses the theory of Polynesian rat extermination on Rapa Nui in 2005, mentioning Jared Diamond's theory and the discovery of rat droppings by Carl Lipo and Terry Hunt.

Procesi njohës	Zbuloni dhe trajtoni konfliktin
Formati i përgjigjes	Zgjedhje e thjeshtë e shumëfishtë – Kodimi (pikëzim) me kompjuter
Burimi i kërkesës për kërkesën/pyetjen	E thjeshtë
Vështirësia	597 – Niveli 4

Përgjigja e saktë është (D) Mbetjet e arrave të palmës tregojnë shenja gërryese të bëra nga minjtë. Në këtë kërkesë/pyetje, nxënësit/es i kërkohet të kuptojë se çfarë informacioni në tekst mbështet, ose vërteton, teorinë e paraqitur nga shkencëtarët. Këtu, nxënësi/ja duhet të shkojë përtej kuptimit të tekstit dhe të identifikojë se cili element i tekstit mund të përdoret si provë (dëshmi) për të mbështetur një pretendim.

PISA ?

Rapa Nui
Pyetja 6 / 7

Referoju që të tre burimeve në të djathtë duke klikuar në secilën prej ikonave.

Tërhiq dhe lësho shkaqet dhe efektet e përbashkëta të teorive në vendet e duhura në tabelë.

Teoritë

Shkaktari	Efekti	Mbështetësit e Teorisë
		Jared Diamond
		Carl Lipo dhe Terry Hunt

Moait janë skalitur në guroren e njëjtë.	Brejtesit polinezianë i hanin farat e pemëve dhe si rezultat i kësaj asnjë pemë nuk u rrit.	Njerëzit që u vendosën në Rapa Nui përdorën barkat për t'i sjellë brejtesit polinezianë aty.
Pemët e larta u zhdukën nga Rapa Nui.	Banorëve të Rapa Nui i nevojiteshin burimet natyrore për t'i lëvizur moait.	Njerëzit prenë pemët për të pastruar tokën për bujqësi dhe arsye të tjera.

Blog Recencë Libri Lajme Shkencore

www.lajmeshkencore.com/Brejtesit_polinezianë_Rapa_Nui

LAJME SHKENCORE

A i shkatërruan Brejtesit Polinezianë pemët në Rapa Nui?

Nga Mondi Kruja, Reporter Shkencor

Në vitin 2005, Jared Diamond botoi *Shkatërrimi*. Në libër, ai përshkroi popullimin e njerëzve të Rapa Nui (të quajtur gjithashtu si Ishulli i Pashkëve).

Libri shkaktoi një mosmarrëveshje të madhe menjëherë pas botimit të tij. Shumë shkencëtar vunë pikëpyetje mbi teorinë e Diamondit për atë që ndodhi në Rapa Nui. Ata bien dakord se pemët e mëdha ishin zhdukur në kohën kur mbërritën Evropianët e parë në ishull në shek e 18^{te}, por nuk binin dakord me teorinë e Jared Diamond për shkakun e zhdukjes.

Tani, dy shkencëtarë, Carl Lipo dhe Terry Hunt, kanë publikuar një teori të re. Ata besojnë se brejtesit Polinezianë i hëngrën farat e pemëve, duke penguar rritjen e pemëve të reja. Ata besojnë se brejtesit u sollën ose aksidentalisht ose qëllimisht me kanoet e përdorura nga njerëzit e parë që u vendosën në Rapa Nui.

Studimet kanë treguar se popullata e brejtesve mund të dyfishohet çdo 47 ditë. Këta janë shumë brejtës për t'u ushqyer. Për të mbështetur teorinë e tyre, Lipo dhe Hunt tregojnë shenjat e bëra nga brejtesit në mbetjet e arrave të palmave. Sigurisht, ata pranojnë se njerëzit luajtën një rol në shkatërrimin e pyjeve në Rapa Nui. Por besojnë se brejtësi Polinezian ka qenë keqbërësi edhe më i madh mes një sërë faktorësh.

Procesi njohës	Integroni dhe gjeneroni (nxirrni) konkluzione nëpër burime të shumta
Formati i përgjigjes	Zgjedhje e thjeshtë e shumëfishtë – Kodim (pikëzim) me kompjuter
Burimi i kërkesës për kërkesën/pyetjen	E thjeshtë
Vështirësia	665 – Niveli 5

Për të marrë kredi (pikë) për këtë kërkesë/pyetje, nxënësit/es iu kërkua të merrte që të tri përgjigjet e sakta. Përgjigjet e sakta janë:

Shkaku (Jared Diamond) - Njerëzit presin pemë për të pastruar tokën për bujqësi dhe arsye të tjera.

Shkaku (Carl Lipo dhe Terry Hunt) - Minjtë polinezianë hëngrën farat e pemëve dhe si rezultat nuk mund të rriteshin pemët e reja. Efekti (i përbashkët) – Pemët e mëdha u zhdukën nga Rapa Nui.

Në këtë kërkesë/pyetje, nxënësit duhet të integrojnë informacionin nëpër tekste në lidhje me teoritë e ndryshme të paraqitura nga Jared Diamond nga njëra anë dhe Carl Lipo dhe Terry Hunt nga ana tjetër. Nxënësi duhet të identifikojë efektin e përbashkët (zhdukjen e pemëve të mëdha) duke hedhur poshtë informacionin e paraqitur në postimin e blogut se ku janë gdhendur moait (në të njëjtin guror). Më tej, nxënësi/ja duhet të kuptojë atë që secili shkencëtar beson se është shkaku i zhdukjes.

PISA

Rapa Nui
Pyetja 7 / 7

Referoju që të tre burimeve në të djathtë duke klikuar në secilën prej ikonave. Jep përgjigjen tënde për pyetjen.

Pas leximit të të tre burimeve, çfarë mendon se e shkaktoi zhdukjen e pemëve të mëdha në Rapa Nui? Jep informacion specifik nga burimet për të mbështetur përgjigjen tënde.

Blog Recencë Libri Lajme Shkencore

www.lajmeshkencore.com/Brejtësit_polinezianë_Rapa_Nui

LAJME SHKENCORE

A i shkatërruan Brejtësit Polinezianë pemët në Rapa Nui?
Nga Mondit Kruja, Reporter Shkencor

Në vitin 2005, Jared Diamond botoi *Shkatërrimi*. Në libër, ai përshkroi popullimin e njerëzve të Rapa Nui (të quajtur gjithashtu si Ishulli i Pashkëve).

Libri shkaktoi një mosmarrëveshje të madhe menjëherë pas botimit të tij. Shumë shkencëtar vunë pikëpyetje mbi teorinë e Diamondit për atë që ndodhi në Rapa Nui. Ata bien dakord se pemët e mëdha ishin zhdukur në kohën kur mbërritën Evropianët e parë në ishull në shek e 18^{te}, por nuk binin dakord me teorinë e Jared Diamond për shkakun e zhdukjes.

Tani, dy shkencëtarë, Carl Lipo dhe Terry Hunt, kanë publikuar një teori të re. Ata besojnë se brejtësit Polinezianë i hëngrën farat e pemëve, duke penguar rritjen e pemëve të reja. Ata besojnë se brejtësit u sollën ose aksidentalisht ose qëllimisht me kanoet e përdorura nga njerëzit e parë që u vendosën në Rapa Nui.

Studimet kanë treguar se popullata e brejtësve mund të dyfishohet çdo 47 ditë. Këta janë shumë brejtës për t'u ushqyer. Për të mbështetur teorinë e tyre, Lipo dhe Hunt tregojnë shenjat e bëra nga brejtësit në mbetjet e arrave të palmave. Sigurisht, ata pranojnë se njerëzit luajtën një rol në shkatërrimin e pyjeve në Rapa Nui. Por besojnë se brejtësi Polinezian ka qenë keqbërësi edhe më i madh mes një sërë faktorësh.

Procesi njohës	Zbuloni dhe trajtoni konfliktin
Formati i përgjigjes	Përgjigje e hapur – Koduar (pikëzuar) nga vlerësuesi
Burimi i kërkesës për kërkesën/pyetjen	Të shumëfishta
Vështirësia	588 – Niveli 4


Për kredi (pikë) të plota, përgjigja e nxënësit përfshin një ose më shumë nga përshkrimet e mëposhtme:

- 1. Njerëzit prenë ose përdorën pemët (për të lëvizur moai dhe/ose pastruar tokën për bujqësi).**
- 2. Minjtë hëngrën farat e pemëve (kështu që pemët e reja nuk mund të rriteshin).**
- 3. Nuk është e mundur të thuhet saktësisht se çfarë ka ndodhur me pemët e mëdha derisa të kryhen kërkime të mëtejshme.**

- Mendoj se pemët u zhdukën sepse njerëzit prenë shumë prej tyre për të lëvizur moain. [1]
- Njerëzit pastruan tokën për bujqësi. [1]
- Pemët përdoreshin për të lëvizur moai. [1]
- Njerëzit presin pemët. [1]
- Ishte faji i popullit sepse donin të lëviznin moain. [1 – kjo përgjigje nuk i referohet në mënyrë eksplicite prerjes së pemëve, por është e pranueshme sepse ato u referohen njerëzve dhe një arsye për të prerë pemët (për të lëvizur moai)]
- Faji i njerëzve. Ata shkatërruan mjedisin. [1 – kjo përgjigje nuk i referohet në mënyrë eksplicite prerjes së pemëve, por është një mënyrë e pranueshme për të përmbledhur rezultatet e prerjes së pemëve.]
- Mendoj se minjtë ndoshta shkaktuan dëmin më të madh duke ngrënë farat e pemëve. [2]
- Minjtë hëngrën farat. [2]

- Nuk ka asnjë provë që asnjëra prej tyre është e saktë, ndaj duhet të presim derisa të ketë më shumë informacion. [3]
- Të dyja. Njerëzit prenë pemët e mëdha për bujqësi, dhe pastaj minjtë hëngrën farat e pemëve! [1 dhe 2]

Nxënësi/ja duhet të integrojë informacionin nga të gjithë tekstet dhe të vendosë se cilën teori të mbështesë. Në këtë mënyrë, nxënësi/ja duhet të kuptojë teoritë - dhe se ato janë në kundërshtim me njëra-tjetrën - dhe duhet të paraqesë një përgjigje që përmban mbështetje nga tekstet. Për të marrë kreditë, një nxënës/e mund të zgjedhë të mbështesë njërën nga teoritë ose nuk mund të zgjedhë asnjërën nga ato për sa kohë që shpjegimi fokusohet në nevojën për kërkime shtesë.



The screenshot shows the PISA reading interface. At the top, there is a blue header with the word "PISA" on the left, a progress indicator (a row of seven green squares, with the first one white), a power button icon, a question mark icon, and navigation arrows. Below the header, the text "Qumështi i Lopës" and "Hyrje" is displayed in a blue box. Underneath, the instruction "Lexo Hyrjen. Më pas kliko shigjetën TJETËR." is shown. The main content area contains the following text:

Në disa vende, si në Shtetet e Bashkuara, pirja e qumështit të lopës është e zakonshme.

Imagjinoni që tre studentë, Anna, Christopher dhe Sam, janë në një kafene në Shtetet e Bashkuara. Pronari sapo ka vënë një shenjë në dritare që thotë: "Pas 5 Prillit nuk do të shërbejmë më qumësht lope këtu". Në vend të tij, do t'ju ofrojmë një zëvendësim qumështi të prodhuar nga soja."

Anna, Christopher dhe Sam janë kureshtarë se pse kafeneja nuk do të shërbejë më qumësht lope, kështu që Anna bën kërkim në Internet në telefonin e saj për "qumështin e lopës". Ata shohin rezultatin e parë dhe e diskutojnë.

Kliko shigjetën TJETËR për të lexuar burimin e parë.

PISA [Progress bar] [Clock icon] [Help icon] [Navigation icons]

Qumështi i Lopës
Pyetja 1 / 7

Referoju pjesës "Bulmet nga Ferma në Treg" në të djathtë. Kliko një alternativë për t'iu përgjigjur pyetjes.

Sipas IDFA, me cilën thënie bien dakord organizatat dhe profesionistët e rëndësishëm të shëndetit?

- Konsumi i qumështit dhe produktet e tij çojnë në obezitet.
- Qumështi është burim i mirë i vitaminave thelbësore dhe mineraleve.
- Qumështi përmban më shumë vitamina se sa minerale.
- Pirja e qumështit është shkaku kryesor i osteoporozës.

Nga Ferma në Treg
www.bulmetngafermanetreg.com

BULMET NGA FERMA NË TREG
Rreth Nesh Prodhimet Ushqimi

Vlera Ushqyese e Qumështit: Përfitime të Panumërta!

Produktet e qumështit *Bulmet nga Ferma në Treg* përmbajnë ushqyes të rëndësishëm: kalcium, protein, vitaminë D, vitaminë B12, riboflavin, dhe kalium. Këto vitamina dhe minerale i bëjnë produktet e qumështit *Bulmet nga Ferma në Treg* një pjesë të rëndësishme të një diete të shëndetshme. Konsumimi i produkteve të qumështit *Bulmet nga Ferma në Treg* çdo ditë është një mënyrë e mrekullueshme për të garantuar që të merrni vitaminat dhe mineralet që ka nevojë trupi juaj.

Konsumimi i produkteve të qumështit *Bulmet nga Ferma në Treg* nxit humbjen në peshë dhe ndihmon në ruajtjen e një peshë të shëndetshme. Qumështi rrit fortësinë dhe dendësinë e kockës. Ai madje përmirëson shëndetin kardiovaskular dhe ndihmon në parandalimin e kancerit. Një gotë qumësht është plot me vitamina, minerale, dhe me një mori të mirash shëndetësore.

Sipas Bill Sears, MD, Profesor Klinik i Asociuar në Pediatri në Universitetin e Kalifornisë në Irvine, qumështi përmban ushqyes të rëndësishëm në një vend të përshatshëm. Shoqata Ndërkombëtare për Ushqimet e Bulmetit (IDFA) e mbështet këtë ide. Në fakt, IDFA sugjeron se shumë profesionistë shëndetësor dhe grupe do të pajtoheshin gjithashtu.






Qumështi përmban një paketë të plotë ushqyese prej nëntë ushqyesh thelbësor. Përpos që është burim i shkëlqyer i kalciumit dhe vitaminës D, ai është edhe burim i mirë i vitaminës A, proteinës dhe kaliumit. Bulmeti rekomandohet nga mjekët. Roli i bulmetit në një dietë të shëndetshme është përcaktuar me kohë nga komuniteti shkencor i ushqimit. Kjo përfshin Fondacionin Kombëtar për Osteoporozën, Ministrinë e Shëndetësisë, Institutin Kombëtar të Shëndetit, Këshillin e Çështjeve Shkencore të Shoqatës Mjekësore Amerikane dhe shumë organizata të tjera shëndetësore të rëndësishme.

Shoqata Ndërkombëtare për Ushqimet e Bulmetit, 27 Shtator 2007

Procesi njohës	Paraqesin kuptimin e drejtpërdrejtë
Formati i përgjigjes	Zgjedhje e thjeshtë e shumëfishtë – Kodim (pikëzim) me kompjuter
Vështirësia	323 – Niveli 1b

Përgjigja e saktë është (B) Qumështi është një burim i mirë për vitaminat dhe mineralet thelbësore.

Njësia fillon me një kërkesë/pyetje e cila kërkon që nxënësi/ja të përfaqësojë kuptimin e mirëfilltë të informacionit të paraqitur nga IDFA. Në mënyrë të veçantë, nxënësi/ja duhet të kuptojë se IDFA sugjeron "shumë profesionistë shëndetësorë dhe grupe gjithashtu do të pajtoheshin" se "Qumështi përmban një paketë të plotë ushqyese prej nëntë lëndësh ushqyese thelbësore" dhe vazhdon të listojë vitaminat që gjenden në qumësht. Kështu, trangu i pyetjes lidhet mjaft drejtpërdrejt me fjalinë në faqen e internetit që prezenton citimin nga IDFA dhe opsioni B ofron një parafrazë të dy fjalive të para në citat. Nxënësi/ja nuk duhet të shkojë përtej kuptimit të mirëfilltë të paraqitur në faqen e internetit për të gjetur përgjigjen e saktë.

PISA     

Qumështi i Lopës
Pyetja 2 / 7

Referoju pjesës "Bulmet nga Ferma në Treg" në të djathtë. Kliko një alternativë për t'iu përgjigjur pyetjes.

Cili është qëllimi kryesor i këtij teksti?

- Të argumentojë se produktet e qumështit nxitin humbjen në peshë.
- Të krahasojë produktet e qumështit *Bulmet nga Ferma në Treg* me produktet e tjera bulmetore.
- Të informojë publikun për rreziqet e lidhura me sëmundjen e zemrës.
- Të mbështesë përdorimin e produkteve *Bulmet nga Ferma në Treg*.

Nga Ferma në Treg
www.bulmetngafermanetreg.com

BULMET NGA FERMA NË TREG
Rreth Nesh Prodhimet Ushqimi

Vlera Ushqyese e Qumështit: Përfitime të Panumërta!

Produktet e qumështit *Bulmet nga Ferma në Treg* përbajnë ushqyes të rëndësishëm: kalcium, protein, vitaminë D, vitaminë B12, riboflavin, dhe kalium. Këto vitamina dhe minerale i bëjnë produktet e qumështit *Bulmet nga Ferma në Treg* një pjesë të rëndësishme të një diete të shëndetshme. Konsumimi i produkteve të qumështit *Bulmet nga Ferma në Treg* çdo ditë është një mënyrë e mrekullueshme për të garantuar që të merrni vitaminat dhe mineralet që ka nevojë trupi juaj.

Konsumimi i produkteve të qumështit *Bulmet nga Ferma në Treg* nxit humbjen në peshë dhe ndihmon në ruajtjen e një peshe të shëndetshme. Qumështi rrit fortësinë dhe dendësinë e kockës. Ai madje përmirëson shëndetin kardiovaskular dhe ndihmon në parandalimin e kancerit. Një gotë qumësht është plot me vitamina, minerale, dhe me një mori të mirash shëndetësore.






Sipas Bill Sears, MD, Profesor Klinik i Asociuar në Pediatri në Universitetin e Kalifornisë në Irvine, qumështi përmban ushqyes të rëndësishëm në një vend të përshtatshëm. Shoqata Ndërkombëtare për Ushqimet e Bulmetit (IDFA) e mbështet këtë ide. Në fakt, IDFA sugjeron se shumë profesionistë shëndetësor dhe grupe do të pajtoheshin gjithashtu.

Qumështi përmban një paketë të plotë ushqyese prej nëntë ushqyesish thelbësor. Përpos që është burim i shkëlqyer i kalciumit dhe vitaminës D, ai është edhe burim i mirë i vitaminës A, proteinës dhe kaliumit. Bulmeti rekomandohet nga mjekët. Roli i bulmetit në një dietë të shëndetshme është përcaktuar me kohë nga komuniteti shkencor i ushqimit. Kjo përfshin Fondacionin Kombëtar për Osteoporozën, Ministrinë e Shëndetësisë, Institutin Kombëtar të Shëndetit, Këshillin e Çështjeve Shkencore të Shoqatës Mjekësore Amerikane dhe shumë organizata të tjera shëndetësore të rëndësishme.

Shoqata Ndërkombëtare për Ushqimet e Bulmetit, 27 Shtator 2007

Procesi njohës	Reflektoni për përmbajtjen dhe formën
Formati i përgjigjes	Zgjedhje e thjeshtë e shumëfishtë – Kodimi (pikëzimi) me kompjuter
Vështirësia	452 – Niveli 2

Përgjigja e saktë është (D) Për të mbështetur përdorimin e Produkteve të Qumështit nga Ferma në Treg. Në këtë kërkesë/pyetje, nxënësit/es i kërkohet të identifikojë qëllimin kryesor të faqes së internetit. Vini re se nxënësit/es nuk i kërkohet të identifikojë idenë kryesore. Në vend të kësaj, nxënësi/ja duhet të kuptojë domethënien e përgjithshme të faqes së internetit dhe më pas të marrë parasysh pse është paraqitur dhe si është shkruar. Nxënësi/ja duhet të reflektojë për përmbajtjen dhe formën e tekstit.

PISA     

Qumështi i Lopës

Lexo informacionin më poshtë. Më pas kliko shigjetën TJETËR.

Anna, Christopher dhe Sam po bisedojnë për vendimin e pronarit të kafenesë për të mos shitur qumësht lope. Sam thotë, "Ndoshta qumështi i lopës po bëhet shumë i shtrenjtë". Christopher po shikon telefonin e tij. "Ndoshta, por edhe unë bëra një kërkim në ueb për qumështin e lopës. Po të dërgoj linkun e një artikulli më të fundit që mund ta shpjegojë këtë".

Anna dhe Sam hapin linkun e dërguar nga Christopher dhe lexojnë artikullin, "Thjesht i Thoni Jo Qumështit të Lopës!"

Kliko shigjetën TJETËR për të lexuar burimin e dytë.

PISA

Qumështi i Lopës
Pyetja 4 / 7

Referoju pjesës "Thjesht i Thoni Jo Qumështit të Lopës!" në të djathtë. Shhtyp përgjigjen tënde për pyetjen.

Dr. Garza paraqet disa rezultate të kërkimit që mund të 'befasojnë' lexuesit.

Thuaj një prej tyre.

Nga Ferma në Treg Thejsh i Thoni Jo

www.artikujshëndetësorsot.com/qumështi

Bashkuara. Foshnjat e pine qumështin e lopës me snishe me biberon. Femijet hanë drithra me qumështin e lopës. Madje edhe të rriturit e shijojnë një gotë qumësht kohë pas kohe. Po, qumështi i lopës zë një pjesë e madhe në dietën e njerëzve në shumë vende të botës. Por, gjithnjë e më shumë studime sugjerojnë se qumështi mund të mos "i bejë mirë trupit" siç pohon slogani i njohur reklamues amerikan.

Departamenti i Bujqësisë së Shteteve të Bashkuara, Këshilli Amerikan për Bulmetrat, kompania Dairy Management, Inc., dhe organizata të tjera kanë punuar shumë për mbrojtjen e qumështit për shumë vite. Ata i inkurajojnë të rriturit të pinë së paku tri gota qumësht në ditë. Megjithatë, disa kërkime në dekadën e fundit kanë venë në pyetje fuqinë kockë-forcuese të qumështit si dhe pretendimet e tjera për përfitimet shëndetësore të qumështit. Rezultatet mund t'ju befasojnë.

Një nga studimet e fundit dhe më të rëndësishëm për efektet e pirjes së qumështit është botuar në numrin e tetorit të vitit 2014 të *British Medical Journal* (Revista Mjekësore Britanike). Gjetjet e këtij studimi çuan në disa pohime të fuqishme për konsumin e qumështit. Në këtë studim u ndoqën më shumë se 10.000 njerëz në Suedi gjatë periudhave prej 20-30 vjetësh. Kërkuesit zbuluan se pirësit e qumështit femra vuanin më shumë nga frakturat e kockave. Krahas kësaj, edhe pirësit meshkuj edhe pirësit femra të qumështit kishin më shumë gjasa të vuanin nga sëmundja e zemrës dhe kanceri. Këto rezultatet tronditëse janë të ngjashme me gjetjet nga studimet e tjera.

Komiteti i Mjekëve për Mjekësinë e Përgjegjshme (PCRM) komentoi për disa probleme shëndetësore të lidhura me konsumin e qumështit. Ai pretendon se produktet e qumështit dhe bulmetit "kanë pak ose aspak përfitime për kockat". PCRM shkon më tutje për t'i përshkruar disa probleme specifike të ndërlidhura me qumështin:

"Proteinat e qumështit, sheqeri i qumështit, yndyra dhe yndyra e ngopur në produktet e bulmetit sjellin rreziqe shëndetësore dhe favorizojnë zhvillimin e obezitetit, diabetit dhe sëmundjes së zemrës".

Këto janë pretendime serioze dhe nevojiten studime të tjera për të konfirmuar gjetjet. Megjithatë, ka shumë prova se pirja e qumështit të lopës mund të jetë më pak me përfitim për shëndetin tonë sesa mendohej në fillim. Nëse këto konstatime bëhen fakte të pakontestueshme, mund të ketë ardhur koha t'i thuhet 'jo' qumështit të lopës.

Procesi njohës	Paraqesin kuptimin e drejtpërdrejtë
Formati i përgjigjes	Përgjigje e hapur – Koduar (pikëzuara) nga vlerësuesi
Vështirësia	398 – Niveli 3

Kredi (pikë) të plota është dhënë nëse citimet ose parafrizat e një prej rezultateve të mëposhtme të kërkimit janë deklaruar në tekst:

1. Femrat që pinin qumësht pësuan më shumë fraktura të kockave.
 2. Si meshkujt ashtu edhe femrat që pinin qumësht kishin më shumë gjasa të vuanin nga sëmundjet e zemrës dhe kanceri.
- Gratë që pinin qumësht kishin më shumë kocka të thyera.
 - Njerëzit që pinin qumësht kishin më shumë sëmundje të zemrës dhe kancer.

PISA ? ◀ ▶

Qumështi i Lopës
Pyetja 5 / 7

Referoju të dy burimeve në të djathtë duke klikuar në secilën prej ikonave. Kliko alternativat në tabelë për t'iu përgjigjur pyetjes.


Bazuar në të dy tekstet për qumështin, a janë thënie në tabelën më poshtë fakte apo opinione? Kliko ose tek **Fakt** ose **Opinion** për secilën thënie.

A është thënia fakt apo opinion?	Fakt	Opinion
Studimet e fundit për dobisë shëndetësore të qumështit janë befasese.	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Studimet kanë treguar se pirja e qumështit ka efekte të dëmshme shëndetësore.	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Disa studime kanë vënë në pikëpyetje forcimin e kockave nga qumështi.	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Pirja e qumështit dhe produktet bulmetore të tjera janë mënyra më e mirë për humbjen e peshës.	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>

Nga Ferma në Treg Thejsh i Thoni Jo

www.artikujtshendetesor.com/qumeshti

ARTIKUJT SHËNETËSOR SOT



THJESH I THONI 'JO' QUMËSHIT TË LOPËS!

Nga Raportuesi për Shëndetin, Dr. R. Gashi

Qumështi i lopës zë një pjesë **e madhe** në jetën e shumë njerëzve në Shtetet e Bashkuara. Foshnjat e pinë qumështin e lopës me shishe me biberon. Fëmijët hanë drithra me qumështin e lopës. Madje edhe të rriturit e shijojnë një gotë qumësht kohë pas kohe. Po, qumështi i lopës zë një pjesë e madhe në dietën e njerëzve në shumë vende të botës. Por, gjithnjë e më shumë studime sugjerojnë se qumështi mund të mos "i bëjë mirë trupit" siç pohon slogani i njohur reklamues amerikan.

Departamenti i Bujqësisë së Shteteve të Bashkuara, Këshilli Amerikan për Bulmetrat, kompania Dairy Management, Inc., dhe organizata të tjera kanë punuar shumë për mbrojtjen e qumështit për shumë vite. Ata i inkurajojnë të rriturit të pinë së paku tri gota qumësht në ditë. Megjithatë, disa kërkime në dekadën e fundit kanë vënë në pyetje fuqinë kockë-forcuese të qumështit si dhe pretendimet e tjera për përfitimet shëndetësore të qumështit. Rezultatet mund t'ju befasojnë.

Një nga studimet e fundit dhe më të rëndësishëm për efektet e pirjes së qumështit është botuar në numrin e tetorit të vitit 2014 të *British Medical Journal* (Revista Mjekësore Britanike). Gjetjet e këtij studimi çuan në disa pohime të fuqishme për konsumin e qumështit. Në këtë studim u ndoqën më shumë se 10.000 njerëz në Suedi gjatë periudhave prej 20-30 vjetësh. Kërkuesit zbuluan se pirësit e qumështit femra vuanin më shumë nga frakturat e kockave. Krahas kësaj, edhe pirësit meshkuj edhe pirësit femra të qumështit kishin më shumë gjasa të vuanin nga sëmundja e zemrës dhe kanceri. Këto rezultatet tronditëse janë të ngjashme me gjetjet nga studimet e tjera.

Komiteti i Mjekëve për Mjekësinë e Përgjigjshme (PCRM) komentoi për disa probleme shëndetësore të lidhura me konsumin e qumështit. Ai pretendon se produktet e qumështit dhe bulmetit "kanë pak ose aspak përfitime për kockat".

Procesi njohës	Integrioni dhe gjeneroni (nxirrni) konkluzione nëpër burime të shumta
Formati i përgjigjes	Zgjedhje e thjeshtë e shumëfishtë –Kodimi (pikëzimi) me kompjuter
Vështirësia	662 – Niveli 5

Përgjigjet e sakta janë: Opinion, Fakt, Fakt, Opinion.

Në këtë kërkesë/pyetje, nxënësi/ja duhet të integrojë informacionin në të dy faqet e internetit dhe të konkludojë nëse deklaratat në tabelë përfaqësojnë fakte që janë paraqitur në faqet e internetit ose përfaqësojnë opinione që janë paraqitur në faqet e internetit. Për këtë kërkesë/pyetje, pikët e plota janë dhënë nëse nxënësi/ja ka marrë të gjitha 4 të sakta, dhe pikët i pjesshëm, janë dhënë nëse nxënësi ka marrë 3 nga 4 të sakta.

The screenshot shows a PISA assessment interface. On the left, there is a sidebar with the title 'Qumështi i Lopës' and 'Pyetja 6 / 7'. Below this, there is a paragraph of text: 'Referoju të dy burimeve në të djathtë duke klikuar në secilën prej ikonave. Kliko një alternativë për t'iu përgjigjur pyetjes.' This is followed by another paragraph: 'Autorët e dy teksteve nuk pajtohen për rolin e qumështit në një dietë të rregullt.' Then, a question is posed: 'Cila është pika kryesore për të cilën autorët nuk pajtohen?' Below the question are four radio button options:

- Efekti i qumështit në shëndet dhe roli i qumështit në dietat njerëzore.
- Numri i vitaminave dhe mineraleve të gjetura në qumësht.
- Produkti më i mirë i bulmetit për tu konsumuar rregullisht.
- Cila organizatë është autoriteti kryesor për qumështin.

 On the right, there is a browser window displaying an article titled 'THJESHT I THONI 'JO' QUMËSHTIT TË LOPËS!' with a sub-headline 'Nga Raportuesi për Shëndetin, Dr. R. Gashi'. The article text discusses the health benefits of milk, mentioning that it is a good source of calcium and protein, and that it is a healthy choice for children. It also mentions that the American Dairy Management Company has spent a lot of money on advertising milk. The article concludes by stating that milk is a healthy choice for children and that it is a good source of calcium and protein. Below the article, there is a small text box: 'Komiteti i Mjekëve për Mjekësinë e Përgjigjshme (PCRM) komentoi për disa probleme shëndetsore të lidhura me konsumin e qumështit. Ai pretendon se produktet e qumështit dhe bulmetit "kanë pak ose aspak përfitime për kockat".'

Procesi njohës	Zbuloni dhe trajtoni konfliktin
Formati i përgjigjes	Zgjedhje e thjeshtë e shumëfishtë – Kodimi (pikëzimi) me kompjuter
Vështirësia	406 – Niveli 1a

Përgjigja e saktë është (A) Efektet e qumështit në shëndet dhe roli i qumështit në dietat njerëzore. Në këtë kërkesë/pyetje, nxënësi/ja duhet të kuptojë se si çdo faqe interneti përshkruan rolin e qumështit në një dietë të rregullt dhe duhet të jetë në gjendje të identifikojë pikën kryesore për të cilën ata nuk pajtohen. Kjo është një kërkesë/pyetje "Zbulo dhe trajto konfliktin", por është më e lehtë se shumë të tjerë të paraqitur në Vlerësimin në terren PISA 2018, sepse kërkesa/pyetja tashmë i bën të ditur nxënësit se ka një konflikt midis dy faqeve të internetit. Në presim që vështirësia e këtyre llojeve të kërkesave/pyetjeve të rritet kur nxënësi/ja së pari duhet të zbulojë nëse ekziston apo jo një konflikt, më pas të përcaktojë se çfarë është konflikti dhe më pas të kuptojë se si ta trajtojë konfliktin.

PISA [Progress Bar] [Timer] [Help] [Navigation]

Qumështi i Lopës
Pyetja 7 / 7

Referoju të dy burimeve në të djathtë duke klikuar në secilën prej ikonave. Kliko një alternativë dhe më pas jep një shpjegim për t'iu përgjigjur pyetjes.

Anna, Christopher dhe Sam po bisedojnë për të dy tekstet.

Christopher: Pavarësisht se çfarë bën pronari i kafenesë, unë do të vazhdoj të pi qumështi çdo ditë. Është shumë i mirë për të gjithë.

Anna: Jo për mua! Unë do të pi shumë më pak qumësht nga tani nëse nuk të bën mirë.

Sam: Nuk e di, mendoj se duhet të dimë më shumë përpara se të nxjerrim një konkluzion.

Me kë pajtohesh?

Christopher
 Anna
 Sam

Shpjego përgjigjen tënde. Referoju informacionit nga të paktën një prej teksteve.

[Text Area]

ARTIKUJT SHËNDETËSOR SOT

THJESHT I THONI 'JO' QUMËSHIT TË LOPËS!

Nga Raportuesi për Shëndetin, Dr. R. Gashi

Qumështi i lopës zë një pjesë e madhe në jetën e shumë njerëzve në Shtetet e Bashkuara. Foshnjat e pinë qumështin e lopës me shishe me biberon. Fëmijët hanë drithra me qumështin e lopës. Madje edhe të rriturit e shijojnë një gotë qumësht kohë pas kohe. Po, qumështi i lopës zë një pjesë e madhe në dietën e njerëzve në shumë vende të botës. Por, gjithnjë e më shumë studime sugjerojnë se qumështi mund të mos "i bëjë mirë trupit" siç pohon slogani i njohur reklamues amerikan.

Departamenti i Bujqësisë së Shteteve të Bashkuara, Këshilli Amerikan për Bulmetrat, kompania Dairy Management, Inc., dhe organizata të tjera kanë punuar shumë për mbrojtjen e qumështit për shumë vite. Ata i inkurajojnë të rriturit të pinë së paku tri gota qumësht në ditë. Megjithatë, disa kërkime në dekadën e fundit kanë venë në pyetje fuqinë kockë-forcuese të qumështit si dhe pretendimet e tjera për përfitimet shëndetësore të qumështit. Rezultatet mund t'ju befasojnë.

Një nga studimet e fundit dhe më të rëndësishëm për efektet e pirjes së qumështit është botuar në numrin e tetorit të vitit 2014 të *British Medical Journal* (Revista Mjekësore Britanike). Gjetjet e këtij studimi çuan në disa pohime të fuqishme për konsumin e qumështit. Në këtë studim u ndoqën më shumë se 10.000 njerëz në Suedi gjatë periudhave prej 20-30 vjetësh. Kërkuessit zbuluan se pirësit e qumështit femra vuanin më shumë nga frakturat e kockave. Krahas kësaj, edhe pirësit meshkuj edhe pirësit femra të qumështit kishin më shumë gjasa të vuanin nga sëmundja e zemrës dhe kanceri. Këto rezultatet tronditëse janë të ngjashme me gjetjet nga studimet e tjera.

Komiteti i Mjekëve për Mjekësinë e Përgjigjshme (PCRM) komentoi për disa probleme shëndetësore të lidhura me konsumin e qumështit. Ai pretendon se produktet e qumështit dhe bulmetit "kanë pak ose aspak përfitime për kockat".

Procesi njohës	Zbuloni dhe trajtoni konfliktin
Formati i përgjigjes	Përgjigje e hapur – Koduar (pikëzuar) nga vlerësuesi
Burimi i kërkesës për kërkesën/pyetjen	Të shumëfishta
Vështirësia	506 – Niveli 3

Në këtë kërkesë/pyetje, nxënësi/ja lexon tre qëndrime të dhëna në bazën e trungut të kërkesës/pyetjes: një që mbështet vazhdimin e pirjes së qumështit, një që mbështet pirjen e më pak qumësht dhe një që thotë se duhet të dihet më shumë përpara se të arrihet një përfundim. Nxënësi/ja mund të zgjedhë cilindo nga tre nxënësit në skenarin që lidhet me këto qëndrime, por nxënësi/ja duhet të japë një arsye nga të paktën një prej teksteve për të mbështetur përzgjedhjen e tij/saj. Udhëzuesi i kodimit për këtë kërkesë/pyetje është dhënë më poshtë, i cili liston mënyrat e pranueshme që një nxënës/e mund të mbështesë përzgjedhjen e tyre për secilën nga tre opsionet. Kjo kërkesë/pyetje fokusohet kryesisht në elementin e trajtimit të konfliktit dhe jo në zbulimin e tij. Duke i kërkuar nxënësit/es të arrijë në një përfundim dhe të përdorë faqen e internetit ose faqet e internetit për të mbështetur përgjigjen, nxënësi/ja demonstroi se si e trajton ai ose ajo konfliktin midis informacionit të paraqitur në dy faqet e internetit. Kredi (pikë) të plota:

Kodi 1: Zgjedh një nga emrat dhe jep një shpjegim të përshtatshëm siç përshkruhet më poshtë. Nëse një emër nuk zgjidhet, përgjigjet tregojnë qartë një zgjedhje për Christopher, Anna ose Sam dhe japin një shpjegim për zgjedhjen duke iu referuar një prej teksteve.

Zgjedh "Christopher" dhe jep një ose më shumë nga shpjegimet më poshtë nga teksti i parë, "Vlera ushqyese e qumështit: përfitime të panumërta!"

OSE përmend se teksti i dytë "Vetëm thuaj 'Jo' qumështit të lopës!" nuk është i balancuar/objektiv.

1. Qumështi përmban lëndë ushqyese (kyç) / shumë vitamina / minerale / përmend në mënyrë specifike një ose më shumë vitamina ose minerale (p.sh. kalium) që është e rëndësishme për një shëndet të mirë.

2. Qumështi rrit humbjen e peshës/ndihmon në ruajtjen e një peshe të shëndetshme.
3. Qumështi përmirëson shëndetin kardiovaskular.
4. Qumështi parandalon kancerin.
5. Faqja e internetit Nga Ferma në Treg përdor mbështetje nga një mjek.
6. Faqja e internetit Nga Ferma në Treg citon Shoqatën Ndërkombëtare të Ushqimeve të Qumështit/ofron mbështetje nga IDFA.
7. "Vetëm thuaj 'Jo' qumështit të lopës!" artikulli/teksti i dytë nuk është i balancuar/nuk është objektiv ose jep një shembull se si nuk është i balancuar apo objektiv.

[Christopher] Një mjek thotë se përmban shumë lëndë ushqyese të rëndësishme.
[Shpjegimi 1/5] [Christopher] Qumështi ka minerale që na duhen për të qenë të shëndetshëm. [Shpjegimi 1]

OSE:

Zgjedh "Anna" dhe jep një ose më shumë nga shpjegimet më poshtë nga teksti i dytë, "Vetëm thuaj 'Jo' qumështit të lopës!"

OSE përmend se teksti i parë "Vlera ushqyese e qumështit: përfitime të panumërta!" është e njëanshme ose përpiqet të shesë produktet e saj.

1. Qumështi mund të mos jetë aq i mirë për ju sipas hulumtimeve të reja.
2. Qumështi mund të çojë në kocka më të dobëta/më shumë fraktura të kockave.
3. Qumështi mund të shkaktojë më shumë sëmundje/kancer të zemrës.
4. Artikulli ofron mbështetje nga Komiteti i Mjekëve për Mjekësinë Përgjegjëse (PCRM).
5. Artikulli flet për prova në rritje se qumështi nuk është aq i mirë për njerëzit sa mendohej fillimisht.
6. Një studim në Suedi tregoi se njerëzit që pinin qumësht kishin më shumë sëmundje të zemrës DHE/OSE kancer DHE/ose fraktura të kockave.
7. "Vlera ushqyese e qumështit: përfitime të panumërta!" (mund t'i referohet artikullit si teksti i parë) ose Nga Ferma në Treg është një burim i njëanshëm/po përpiqet të shesë produktet e tij dhe pretendimet nuk mund t'u besohen.

[Anna] Ata bënë një studim në Suedi që tregoi se gratë që pinin qumësht kishin më shumë kocka të thyera. [Shpjegimi 6]

[Anna] Ai i pari thjesht po përpiqet të na shesë qumështin e tij, kështu që nuk mund t'i besoni vërtet. [Shpjegimi 7]

OSE:

Zgjedh "Sam" dhe jep një shpjegim që i referohet përmbajtjes ose kufizimeve të teksteve për të mbështetur qëndrimin se një përfundim nuk mund të arrihet në këtë moment. Përgjigjet përfshijnë një nga shpjegimet e mëposhtme:

1. "Vetëm thuaj 'Jo' qumështit të lopës!" artikulli/teksti i dytë thekson se nevojiten më shumë studime për të konfirmuar gjetjet e hulumtimit.
2. Qumështi është konsumuar rregullisht për një kohë të gjatë dhe studimet e përmendura në artikullin e dytë janë të reja, ndaj duhet më shumë kohë ose kërkime për të nxjerrë një përfundim.
3. Këto janë vetëm dy tekste dhe ka nevojë për më shumë kërkime përpara se të arrihet një përfundim.
4. Do të ishte mirë të verifikonit informacionin që gjendet në çdo artikull përpara se të bëni një përfundim.
5. Dy tekstet kundërshtojnë njëri-tjetrin, kështu që nuk mund të nxirret një përfundim

OSE jep një shembull specifik se si ato kundërshtojnë njëra-tjetrën (një tekst thotë se qumështi krijon kocka të forta dhe tjetri thotë se shkakton më shumë fraktura).

[Sam] Thjesht Thuaj Jo thotë se nevojiten më shumë studime përpara se të dimë vërtet. [Shpjegimi 1]

[Sam] Më duhet të sigurohem që ajo që thotë çdo artikull është e vërtetë përpara se të vendos. [Shpjegimi 4]

VIII. Fusha e matematikës

Në PISA 2022, Matematika ka qenë fusha kryesore e vlerësimit ndërkombëtar dhe u organizua në tri pjesë kryesore:⁶

- Përkufizimi i aftësive në matematikë, shpjegon teorinë/ bazat e vlerësimit të matematikës në PISA, duke përfshirë përkufizimin formal të konstruktit në matematikë.
- Organizimi i fushës së matematikës, përshkruan katër aspekte:
 - a) arsyetimin matematik dhe tri proceset matematikore (të ciklit të modelimit/zgjidhjes së problemit);
 - b) mënyra se si janë njohuritë për përmbajtjen matematikore organizuar në kornizën PISA 2022, dhe njohuritë e përmbajtjes që janë relevante për një vlerësim të nxënësve 15-vjeçarë;
 - c) marrëdhëniet ndërmjet matematikës dhe të ashtuquajturave aftësi të shekullit të 21-të ; dhe
 - d) kontekstet në të cilat do të përballen nxënësit, sfidat matematikore.
- Vlerësimi i matematikës, përshkruan çështjet strukturore në lidhje me vlerësimin, duke përfshirë një plan testimi dhe informacione të tjera teknike.

Për qëllimet e PISA 2022, fusha e matematikës përkufizohet si 'njohuritë në matematikë janë aftësi të një individi për të arsyetuar matematikisht dhe për të formuluar, përdorur dhe interpretuar matematikën për të zgjidhur probleme në një sërë kontekstesh të botës reale. Kjo fushë përfshin koncepte, procedura, fakte dhe mjete për të përshkruar, shpjeguar dhe parashikuar fenomene. U ndihmon individëve të njohin rolin që luan matematika në botë dhe të marrin gjykimet dhe vendimet e bazuara mirë që u nevojiten qytetarëve konstruktiv, të angazhuar dhe reflektues të shekullit të 21-të.'

Si bazë për një vlerësim ndërkombëtar të nxënësve 15-vjeçarë, është e arsyeshme të pyesim: "Çfarë është e rëndësishme që nxënësit të dinë dhe të jenë në gjendje të bëjnë në situata që përfshijnë matematikën?" Më konkretisht, çfarë do të thotë për një 15- vjeçar, i cili pasi përfundon këtë nivel të shkollimit, ose përgatitet të ndjekë një trajnim më të specializuar për një karrierë ose pranim në universitet, të jesh i aftë matematikisht?

Është e rëndësishme që përmbajtja e fushës së matematikës, e cila përdoret në kuadër të këtij vlerësimi për të treguar aftësinë e individëve për të arsyetuar matematikisht dhe për të zgjidhur probleme në një sërë kontekstesh të shekullit të 21-të , të mos perceptohet si sinonim i njohurive minimale ose të nivelit të ulët të shkathtësive. Përkundrazi, synohet të përshkruajë aftësitë e individëve për të arsyetuar matematikisht dhe për të përdorur koncepte, procedura, fakte dhe mjete matematikore për të përshkruar, shpjeguar dhe parashikuar fenomene.

Për qëllime të vlerësimit, përkufizimi PISA 2022 në fushën e matematikës mund të analizohet në tri aspekte të ndërlidhura:

- Arsyetimi matematik (si deduktiv ashtu edhe induktiv) dhe zgjidhja e problemit (që përfshin proceset matematikore se çfarë bëjnë individët për të lidhur kontekstin e problemit me matematikën dhe për të zgjidhur kështu problemin);
- Përmbajtja matematikore që synohet të përdoret në kërkesat (pyetjet) vlerësuese; dhe
- Në çfarë konteksti fusha e matematikës mund të vëzhgohet dhe vlerësohet dhe si ndërvepron kjo fushë me aftësitë e identifikuara të shekullit të 21-të?

IX. Njohuri për përmbajtjen matematikore

Kurrikulat kombëtare të matematikës në shkolla zakonisht organizohen rreth elementeve të përmbajtjes (më së shpeshti: numrat, algjebra, funksionet, gjeometria dhe përpunimi i të dhënave) dhe listat e detajuara të temave që ndihmojnë për të përcaktuar pritshmëritë. Këto kurrikula janë krijuar për t'i pajisur nxënësit me njohuri dhe shkathtësi që trajtojnë të njëjtat dukuri matematikore si në përmbajtjen e PISA-s. Përmbajtja e vlerësimit në matematikë që organizohet në PISA është i lidhur ngushtë me përmbajtjen që zakonisht gjendet në kurrikulat kombëtare të matematikës. Kjo kornizë rendit një sërë temash të përmbajtjes të përshtatshme për vlerësimin në fushën e matematikës të nxënësve 15-vjeçarë.

⁶ <https://pisa2022-maths.oecd.org/files/PISA%202022%20Mathematics%20Framework%20Draft.pdf>

X. Arsyetimi në matematikë

Arsyetimi matematik (si deduktiv ashtu edhe induktiv) përfshin vlerësimin e situatave, zgjedhjen e strategjive, nxjerrjen e përfundimeve logjike, zhvillimin dhe përshkrimin e zgjidhjeve dhe njohjen se si mund të zbatohen ato zgjidhje. Nxënësit arsyetojnë matematikisht kur:

- Identifikojnë, njohin, organizojnë, lidhin dhe përfaqësojnë
- Ndërtojnë, abstraktojnë, vlerësojnë, deduktojnë, justifikojnë, shpjegojnë dhe mbrojnë; dhe
- Interpretojnë, gjykojnë, kritikojnë, vërtetojnë dhe argumentojnë.

Arsyetimi matematik (si deduktiv ashtu edhe induktiv), i mundësuar nga disa kuptime kyçe që mbështesin matematikën në shkollë, është thelbi i përmbajtjes në fushën e matematikës. Ndër këto, kryesoret janë:

- Kuptimi i sistemeve të sasive, numrave dhe vetive algjebrike të tyre;
- Vlerësimi i fuqisë së abstraksionit dhe përfaqësimit të simboleve;
- Strukturat matematikore dhe rregullat;
- Njohja e marrëdhënieve funksionale ndërmjet sasive;
- Përdorimi i modelimit matematikor si pamje më të qartë ndaj botës reale (p.sh. ato që dalin në shkencat fizike, biologjike, sociale, ekonomike dhe të sjelljes); dhe
- Kuptimi i variabilitetit si thelbësore në statistika

XI. Zgjidhja e problemeve

Përkufizimi i fushës së matematikës i referohet aftësisë së një individi për të formuluar, përdorur dhe interpretuar (dhe vlerësuar) matematikën.

Tri fjalët e përdorura më lartë, formulojnë, përdorin dhe interpretojnë, ofrojnë një strukturë të dobishme dhe kuptimplotë për organizimin e proceseve matematikore që përshkruajnë se çfarë bëjnë individët për të lidhur kontekstin e një problemi me matematikën dhe për të zgjidhur problemin.

Kërkesat (pyetjet) në testin e matematikës PISA 2022 janë bazuar në arsyetimin matematik ose në njërin nga tri proceset matematikore:

- Formulimi i situatave në mënyrë matematikore;
- Përdorimi i koncepteve, fakteve, procedurave dhe arsyetimit matematikor; dhe
- Interpretimi, zbatimi dhe vlerësimi i rezultateve matematikore.

XII. Përmbledhje e përshkrimit të tetë niveleve të aftësisë matematikore në PISA 2022

Niveli	Kufiri i pikëve nga më i ulëti	Përqindja e nxënësve që janë në gjendje të kryejnë detyra në çdo nivel apo më lart (mesatarja e OECD)	Karakteristikat e detyrave
6	669	2.0%	Në nivelin 6, nxënësit mund të punojnë përmes problemeve abstrakte dhe të demonstrojnë kreativitet dhe të menduar fleksibël për t'i zhvilluar zgjidhjet. Për shembull, ata mund të njohin kur një procedurë që nuk është e specifikuar në një detyrë mund të zbatohet nga konteksti jo standard ose kur demonstron një kuptim më i thellë i një koncepti matematikor e që është i nevojshëm si pjesë e një justifikimi. Ata mund të lidhin burime të ndryshme informacioni dhe përfaqësime, duke përfshirë përdorimin efektiv simulimet ose tabelat si pjesë e zgjidhjes së tyre. Nxënësit e këtij niveli janë të

DORACAK PËR SHKOLLA VLERËSIMI NDËRKOMBËTAR
PISA NË LEXIM, MATEMATIKË DHE SHKENCË

			aftë për të menduarit kritik dhe kanë një zotërim të veprimeve dhe marrëdhënieve matematikore simbolike dhe formale që ata përdorin për të komunikuar qartë arsyetimin e tyre. Ata mund të reflektojnë mbi përshtatshmërinë e veprimeve të tyre në lidhje me zgjidhjen e tyre dhe situatën origjinale.
5	607	8.7%	Në nivelin 5, nxënësit mund të zhvillojnë dhe punojnë me modele për situata komplekse, duke identifikuar ose vendosur kufizime dhe duke specifikuar supozimet. Ata mund të aplikojnë strategji sistematike dhe të mirë planifikuara për zgjidhjen e problemeve dhe detyra më sfiduese, të tilla si, vendosja se si të zhvillohet një eksperiment, hartimi i një procedure optimale, ose duke punuar me vizualizime më komplekse që nuk janë dhënë në detyrë. Nxënësit demonstrojnë një aftësi të shtuar për të zgjidhur probleme, zgjidhjet e të cilave shpesh kërkojnë përfshirjen e njohurive matematikore që nuk janë shprehur në mënyrë eksplicite në detyrë. Nxënësit e këtij niveli reflektojnë mbi punën e tyre dhe marrin parasysh rezultatet matematikore në lidhje me kontekstin real botëror.
4	545	23.6%	Në nivelin 4, nxënësit mund të punojnë në mënyrë efektive me modele eksplicite për situata komplekse konkrete, ndonjëherë që përfshijnë dy variabla, si dhe demonstrojnë një aftësi për të punuar me modele të padefinuara që ata nxjerrin duke përdorur një qasjeje të sofistikuar të të menduarit- llogaritës. Nxënësit në këtë nivel fillojnë të angazhohen me aspekte të të menduarit kritikës, siç është vlerësimi i arsyeshmërisë së një rezultati duke bërë gjykime cilësore atëherë kur llogaritjet nuk janë të mundshme nga informacioni i dhënë. Ata mund të zgjedhin dhe integrojnë paraqitje të ndryshme të informacionit duke përfshirë simbolet ose grafikët, duke i lidhur ato drejtpërdrejt me aspekte të situatave të botës reale. Në këtë nivel, nxënësit gjithashtu mund të ndërtojnë dhe të komunikojnë shpjegime dhe argumente bazuar në interpretimet, arsyetimin dhe metodologjinë.
3	482	45.6%	Në nivelin 3, nxënësit mund të bëjnë zgjidhje strategjike, përfshirë strategjitë që kërkojnë vendimmarrje të njëpasnjëshme apo fleksibilitet në të kuptuarit e koncepteve të njohura. Në këtë nivel, nxënësit fillojnë të përdorin aftësitë e të menduarit llogaritës për të zhvilluar strategjitë e tyre të zgjidhjes. Ata janë në gjendje të zgjidhin detyra që kërkojnë kryerjen e disa detyrave të ndryshme, përveç llogaritjeve rutinore që nuk janë plotësisht qartë të definuara në deklaratën e problemit. Ata mund të përdorin vizualizimin hapësinor si pjesë të strategjisë së një zgjidhjeje ose të përcaktojnë se si të përdorin një simulim për të mbledhur të dhëna të përshtatshme për detyrën. Nxënësit në këtë nivel mund të interpretojnë dhe të përdorin paraqitje të bazuara në burime të ndryshme të informatave dhe arsyes direkt nga ato, përfshirë vendimmarrjen e kushtëzuar dhe duke përdorur një tabelë të dyanshme. Ata zakonisht tregojnë

DORACAK PËR SHKOLLA VLERËSIMI NDËRKOMBËTAR
PISA NË LEXIM, MATEMATIKË DHE SHKENCË

			disa aftësi për të trajtuar përqindjet, thyesat dhe numrat dhjetorë dhe për të punuar me marrëdhënie proporcionale
2	420	68.9%	Në nivelin 2, nxënësit mund të njohin situata ku duhet të hartojnë strategji të thjeshta për të zgjidhur problemet, duke përfshirë ekzekutimin e simulimeve të drejtpërdrejta që përfshijnë një variabël si pjesë e strategjisë së tyre të zgjidhjes. Ata mund të nxjerrin informacionin përkatës nga një ose më shumë burime duke përdorur mënyra pak më komplekse të përfaqësimit, si p.sh tabela, tabela ose paraqitje dydimensionale të objekteve, tredimensionale me dy drejtime. Nxënësit e këtij niveli demonstronjë një kuptim bazë të marrëdhënieve funksionale dhe mund të zgjidhin probleme që përfshijnë raporte të thjeshta. Ata janë në gjendje të bëjnë interpretime fjalë për fjalë të rezultateve.
1 a	358	87.6%	Në nivelin 1a, nxënësit mund t'u përgjigjen pyetjeve që përfshijnë kontekste të thjeshta ku të gjitha informacionet e nevojshme janë të pranishme dhe pyetjet janë të definuara qartë. Informacioni mund të paraqitet në një sërë formatesh të thjeshta dhe nxënësit mund të kenë nevojë që njëkohësisht të punojnë me dy burime për të nxjerrë informacionin përkatës. Ata janë në gjendje të bëjnë procedura rutinore të thjeshta, bazuar në udhëzime të drejtpërdrejta në situata eksplicite, të cilat ndonjëherë mund të kërkojnë shumëfish përsëritje të një procedure rutinë për të zgjidhur një problem. Ata mund të kryejnë veprime që janë të dukshme ose që kërkojnë shumë sintezë minimale të informacionit, por në të gjitha rastet veprimet rrjedhin qartë nga stimujt e dhënë. Nxënësit në këtë nivel mund të përdorin algoritme bazë, formula ose procedura për të zgjidhur problemet që më së shpeshti përfshijnë numra të plotë.
1 b	295	97.4%	Në nivelin 1b, nxënësit mund t'u përgjigjen pyetjeve që përfshijnë kontekste që kuptohen lehtë ku të gjitha informacionet që nevojiten janë dhënë qartë në një paraqitje të thjeshtë (d.m.th., në formë tabelare ose grafike) dhe, sipas nevojës, të njohin kur ndonjë informacion është i parëndësishëm dhe mund të injorohet në lidhje me pyetjen specifike që bëhet. Ata janë në gjendje që të kryejnë llogaritje të thjeshta me numra të plotë, të cilat rrjedhin nga udhëzimet e përcaktuara qartë, të përcaktuara shkurt, tekst i thjeshtë sintaksor.
1 c	233	99.7%	Në nivelin 1c, nxënësit mund t'u përgjigjen pyetjeve që përfshijnë kontekste lehtësisht të kuptueshme ku i gjithë informacioni përkatës është dhënë qartë në një format të thjeshtë, të njohur (për shembull, një tabelë ose fotografi e vogël) dhe e përcaktuar në një formë shumë të shkurtër, tekst i thjeshtë sintaksor. Ata janë në gjendje të ndjekin një udhëzim të qartë që përshkruan një hap të vetëm apo veprim.

XIII. Shembuj nga Testi PISA në Matematikë:
Njësia CMA123-Sistemi diellor
Sistemi diellor, pyetja e liruara #1 (CMA123Q01)

PISA 2022

Sistemi diellor
Pyetja 1 / 2

Referohuni "Sistemit Diellor" në të djathtë. Përdorni tërhiq dhe lësho për t'u përgjigjur në pyetje.

Modeli vijues paraqet distancën mesatare mes tre planetëve. (Planetët dhe modeli nuk janë vizatuar sipas shkallës).

Bazuar në distancën e dhënë, cilët planetë përkasin në model. Tërhiqini tre planetët e saktë në radhitje të saktë. Për ta ndryshuar një përgjigje, së pari tërhiqeni jashtë planetin paraprak.

SISTEMI DIELLOR

Tabela më poshtë paraqet distancën mesatare nga Dielli deri te planetët kryesor në Njësine Astronomike (NJA).

1 NJA është afërsisht 150 milionë kilometra

Planeti	Distanca mesatare nga Dielli në NJA
Merkuri	0.39
Afërdita	0.72
Toka	1.00
Marsi	1.52
Jupiteri	5.20
Saturni	9.58
Urani	19.20
Neptuni	30.05

Kjo është pyetja e parë në njësinë për Sistemin diellor. Për këtë detyrë, nxënësit duhet të përcaktojnë se cilat nga tri planetët kanë distancat mesatare ndërmjet tyre, në Njësi Astronomike (au), që janë treguar në model. Për ta bërë këtë, nxënësit duhet të përdorin tabelën stimuluese që jep mesataren e secilit planet në largësi nga Dielli, në au. Përgjigja e saktë, nga e majta në të djathtë, është Jupiteri, Saturni, Urani.

Për t'iu përgjigjur pyetjes, nxënësit duhet të tërheqin dhe lëshojnë planetët në model (shih më poshtë një fotografi të planetëve të vendosura në model). Nuk ka asnjë ekran prezentimi ose të praktikohet përpara kësaj pyetje, por udhëzime se si duhet përgjigjur dhe për të ndryshuar një përgjigje jepen udhëzime në mënyrë eksplicite (të qartë) për rrjedhën e pyetjes. Për vendosjen e saktë të tre planetëve në përgjigje jepen kredi të plota, dhe kredi të pjesshme për vendosjen e saktë të çdo dy planetëve. Kjo është një pyetje mesatarisht e vështirë me kredi të plota dhe të pjesshme që janë në nivelin 3 në shkallën e zotësisë (aftësisë).

Më poshtë është një imazh se si duket pyetja dhe pjesa e përgjigjes pasi nxënësi ka tërhequr dhe lëshuar planetët në vendndodhjet e tyre përkatëse në model.

Sistemi Diellor
Pyetja 1 / 2

Referojuni "Sistemi Diellor" në të djathtë. Përdorni tërhiq dhe lësho për t'iu përgjigjur pyetjes. Modeli i mëposhtëm tregon distancat mesatare midis tre planeteve. (Planetet dhe modeli nuk janë paraqitur në shkallë.)

Jupiter 4.38 au Saturni 9.62 au Ûrani

Në bazë të dhënave të largësive, cilat planete bëjnë pjesë në model? Tërhiqni tri planetët e duhura në rendin e duhur. Për të ndryshuar një përgjigje, së pari tërhiqni planetin e mëparshëm.

Merkuri Venera Toka
Marsi
Neptuni

Emri i njësisë – Pyetja #	Sistemi diellor – CMA123Q01
Fusha e përmbajtjes	Sasia (Numrat)
Procesi	Interpreton / vlerëson
Konteksti	Shkencë
Formati i pyetjes	Zgjidhje komplekse e shumëfishtë - pikëzim me kompjuter
Përgjigjet	Kredi të plota: Të tre planetët janë vendosur saktë (nga e majta në të djathtë: Jupiteri, Saturni, Urani)
	Kredi të pjesshme: Çdo dy planetë janë vendosur saktë (planeti tjetër është i pasaktë ose mungon)
Nivelet e aftësisë	3 (pikë të plota)
	3 (pikë të pjesshme)

Sistemi diellor, pyetja e realizuar #2 (CMA123Q02)

PISA 2022

Sistemi diellor
Pyetja 2 / 2

Referohuni "Sistemit Diellor" në të djathtë. Klikoni një alternativë për t'ju përgjigjur pyetjes.

Mesatarisht, përafërsisht sa milionë kilometra nga Dielli është planeti Neptun?

5 milionë km
 30 milionë km
 180 milionë km
 4500 milionë km

SISTEMI DIELLOR

Tabela më poshtë paraqet distancën mesatare nga Dielli deri te planetët kryesor në Njësine Astronomike (NJA).

1 NJA është afërsisht 150 milionë kilometra

Planeti	Distanca mesatare nga Dielli në NJA
Merkuri	0.39
Aferdita	0.72
Toka	1.00
Marsi	1.52
Jupiteri	5.20
Saturni	9.58
Urani	19.20
Neptuni	30.05

Për pyetjen e dytë të kësaj njësie, nxënësit duhet të përcaktojnë afërsisht sa milion kilometra planeti Neptun është nga Dielli, një proces që kërkon konvertimin e Njësive Astronomike në miliona kilometra. Nga stimuli, nxënësve u jepet konvertimi se 1 au është afërsisht 150 milion kilometra, dhe ata mund të lexojnë nga tabela se Neptuni ka një distancë mesatare nga dielli prej 30.05 au. Për të përcaktuar distancën e përafërt të Neptunit në miliona kilometra, nxënësit duhet të shumëzojnë 30,05 herë 150. Kjo jep një rezultat prej 4,507,5, i cili rumbullakohet në 4500 (milion km). Kjo është një pyetje e Nivelit 2 (më e lehtë) për nxënësit. Detyra kërkon vetëm përdorimin e një procesi të konvertimit të njësive bazuar në informacionin e dhënë.

Emri i Njesisë – Pyetja #	Sistemi diellor – CMA123Q02
Fusha e përmbajtjes	Sasia (Numrat)
Procesi	Zbaton
Konteksti	Shkencë
Formati i Pyetjes	Zgjedhje e shumëfishtë e thjeshtë- pikëzim me kompjuter
Përgjigja	4500 milion km
Niveli i Aftësisë	2

Njësia CMA150 – Modelet trekëndore
Modelet trekëndore, pyetja e liruar #1 (CMA150Q01)

PISA 2022

Modelet Trekëndore
Pyetje 1 / 3

Referohuni "Modele Trekëndore" në të djathtë. Klikoni një alternativë për t'ju përgjigjur pyetjes.

Sa përqind të trekëndeshave në katër radhët e para të figurës së Aleksit janë të kaltër?

37.5%
 50.0%
 60.0%
 62.5%

MODELET TREKËNDORE

Aleksi i vizatoi modelet në vijim të trekëndeshave të kuq dhe të kaltër.

Katër radhët e para të figurës janë paraqitur më poshtë.

Kjo është pyetja e parë në njësinë *Modeli trekëndor* dhe nuk paraqitet hyrja në ekran. Për këtë njësi, nxënësit kanë një sërë pyetjesh që lidhen me një vizatim që një person ka bërë me rreshta duke përdorur alternativa/mundësi të trekëndeshave të kuq dhe të kaltër. Stimuli tregon katër rreshtat e parë të modelit dhe i njëjti imazh përsëritet në stimulin e të tri pyetjeve tjera në njësi.

Për pyetjen e parë nxënësve u kërkohet të llogarisin përqindjen e trekëndeshave të kaltër të paraqitur në katër rreshtat e parë të modelit. Janë gjashtë trekëndësha të kaltër dhe 16 trekëndësha gjithsej, kështu që përqindja e trekëndeshave të kaltër është 37,5% ($6 \div 16 = 0,375$). Kjo është një pyetje e lehtë (Niveli 1a) dhe synon t'i shtyjë nxënësit të mendojnë për modelin duke përdorur një algoritëm të thjeshtë me të gjithë informacionin e treguar.

Emri i njësisë –Pyetja #	Modeli trekëndor – CMA150Q01
Fusha e përmbajtjes	Sasia (Numrat)
Procedura/Procesi	Zbaton
Konteksti	Shkencë
Formati i pyetjes	Zgjedhje e thjeshtë e shumëfishtë-pikëzim me kompjuter
Përgjigja	37.50%
Niveli i aftësisë	1

Modelet trekëndore, pyetje e liruar #2 (CMA150Q02)

PISA 2022

Modelet Trekëndore
Pyetje 2 / 3

Referohuni "Modele Trekëndore" në të djathtë. Klikoni një alternativë për t'ju përgjigjur pyetjes.

Nëse Aleks i vizatoi figurën në radhën e pestë, sa do të ishte përqindja e trekëndëshave të kaltër në të gjitha pesë radhët e figurës?

40.0%
 50.0%
 60.0%
 66.7%

MODELET TREKËNDORE

Aleks i vizatoi modelet në vijim të trekëndëshave të kuq dhe të kaltër.

Katër radhët e para të figurës janë paraqitur më poshtë.

Pyetja e dytë në njësi formon pyetjen e parë duke u kërkuar përsëri nxënësve që të llogarisin përqindjen e trekëndëshave të kaltër, por këtë herë ai bazohet në pesë rreshta të modelit. Meqenëse rreshti i pestë nuk shfaqet, nxënësit duhet ta zgjasin modelin me një rresht për të përcaktuar vlera të reja për numrin e trekëndëshave të kaltër dhe numrin e përgjithshëm të trekëndëshave. Me pesë rreshta, përqindja e trekëndëshave të kaltër është 40,0% (10 trekëndësha të kaltër ÷ 25 trekëndësha gjithsej).

Kjo pyetje synon të jetë e lehtë dhe t'i shtyjë nxënësit të mendojnë për shtrirjen e modelit përtej asaj që tregohet, por jo ta zgjerojnë modelin në mënyrë që të kërkojnë përgjithësim. Kjo është një pyetje e nivelit 2, kështu që është pak më e vështirë se pyetja e parë në njësi, ndoshta sepse kërkon të punohet me një pjesë të modelit që nuk shfaqet, por është një pyetje përgjithësisht e lehtë për nxënësit.

Emri i njësisë–Pyetja #	Modeli trekëndor – CMA150Q02
Fusha e përmbajtjes	<i>(Koncepti-numri, funksioni dhe algjebra)</i>
Procedura/ Procesi	Formulon
Konteksti	Shkencor
Formati i pyetjes	Zgjedhje e shumëfishtë e thjeshtë- pikëzimi me kompjuter
Përgjigja	40.00%
Niveli i aftësisë	2

Modelet

PISA 2022

Modelet Trekëndore
Pyetje 3 / 3

Referohuni "Modele Trekëndore" në të djathtë. Kliko një opion dhe pastaj shkruaje një sqarim për t'u përgjigjur në pyetje.

Aleksi do të shtojë akoma radhë në modelin e tij.

Ai pretendon se përqindja e trekëndëshave të kaltër në model do të jetë gjithmonë më e vogël se 50%.

A ka Aleksi të drejtë?

Po
 Jo

Sqarojeni përgjigjen tuaj.

MODELET TREKËNDORE

Aleksi i vizatoi modelet në vijim të trekëndëshave të kuq dhe të kaltër.

Katër radhët e para të figurës janë paraqitur më poshtë.

Radha e 1^{-rë}

Radha e 2^{-të}

Radha e 3^{-të}

Radha e 4^{të}

Trekëndore, pyetje e liruar #3 (CMA150Q03)

Kjo është pyetja e fundit në këtë njësi dhe e cila formon dy pyetjet e mëparshme për të përgjithësuar modelin. Detyra për nxënësit është të vlerësojnë se përqindja e trekëndëshave të kaltër në model do të jetë gjithmonë më pak se 50% kur shtohen më shumë rreshta. Nxënësit duhet të zgjedhin "Po" ose "Jo" për të treguar nëse deklarata është apo nuk është e vërtetë, por më pas ata duhet të japin gjithashtu një shpjegim për të mbështetur përgjigjen e tyre. Kjo është një pyetje që kërkon arsyetim dhe kërkon nga nxënësit të analizojnë modelin për të njohur një marrëdhënie midis numrit të trekëndëshave të kuq dhe të kaltër në çdo rresht dhe më pas ta përdorin atë marrëdhënie për të mbështetur zgjedhjen e tyre.

Zgjedhja e saktë është "Po", deklarata është e vërtetë dhe komenti është i justifikueshëm, pranon se numri i trekëndëshave të kuq në çdo rresht do të jetë gjithmonë më i madh se numri i trekëndëshave të kaltër në çdo rresht. Vini re se nxënësit mund ta formulojnë përgjigjen e tyre ose në kuptimin që numri i trekëndëshave të kaltër është më i vogël ose numri i trekëndëshave të kuq është më i madh, për aq sa tregohet se ky relacion është i vërtetë në çdo rresht. Përgjigjet me kode të pjesshme në këtë pyetje kryesisht ose fokusohen në rreshtin e parë, i cili përmban vetëm trekëndëshat e kuq, ose nuk tregojnë relacionin ndërmjet çdo ngjyre të trekëndëshit që shfaqet në çdo rresht.

Kjo është një pyetje e koduar nga njeriu (koderi) (pjesa e kodimit paraqitet më poshtë). Është pyetje e vështirë për nxënësit (Niveli 5), përgjigjet e plota vlerësohen me kode të plota. Ka kode të pjesshme, por kjo është pyetje mesatarisht e vështirë (Niveli 4) për nxënësit. Vini re se pjesa e pikëzimit nuk përmban një listë komplete të përgjigjeve për asnjë nivel të pikëzimit. Megjithatë, përgjigjet e mundshme të nxënësve janë përfaqësuese, një mënyrë sesi nxënësit zakonisht u përgjigjen këtyre pyetjeve.

Emri i njësisë–Pyetja #	Modeli trekëndor – CMA150Q03
Fusha e Përmbajtjes	<i>Koncepti-numri, funksioni dhe Algjebra</i>
Procesi	Arsyeton (Vlerëson)
Konteksti	Shkencë
Formati i pyetjeve	Përgjigje e hapur- koduar nga koduesi
Përgjigja	Referoju pjesës më poshtë
Nivelet e aftësisë	5 (kredi të plota)
	4 (kredi të pjesshme)

Kredi (pikë) të plota

Kodi 2 : Zgjedh Po dhe jep një shpjegim të pranueshëm se pse do të ketë gjithmonë më shumë trekëndësha të kuq (ose më pak të kaltër. [Një shpjegim i pranueshëm duhet të thotë "në çdo rresht" (ose të përdorë formulime të ngjashme për atë koncept).]

- Ai ka të drejtë sepse ka gjithmonë një trekëndësh të kuq më shumë se trekëndësh të kaltër në çdo rresht. [Zgjedhja e "Po "nënkuptohe këtu.]
- [Po] Do të ketë gjithmonë një trekëndësh të kaltër më pak në çdo rresht.
- [Po] Ka një trekëndësh më shumë të kuq se të kaltër në çdo rresht. [*Përfitimi nga pasiguria e dhënë për mos saktësimin e "Gjithmonë" në përgjigje pasi është thënë tashmë në trugun e pyetjes.*]
- [Po] Sepse trekëndëshat e kuq janë në pjesën e jashtme të çdo rreshti dhe brenda tij alternojnë (kombinojnë) trekëndëshat e kuq dhe të kaltër. [Shpjegimi i pranueshëm që përcakton se ka më shumë të kuqe se të kaltër në çdo rresht.]

Kredi (pikë) të pjesshme

Kodi 1 : Zgjedh Po dhe shpjegimi është pjesërisht i saktë, por i paplotë.

- [Po] Sepse rreshti i parë ka vetëm një trekëndësh të kuq.
- [Po] Nuk ka trekëndësha të kaltër në rreshtin e parë.
- [Po] Ka një trekëndësh të kuq më shumë se trekëndësha të kaltër. [Përgjigja nuk specifikon "në çdo rresht". *Krahaso me Kodi 2, pika 3.*]
- [Po] Sepse trekëndëshat e kuq janë në pjesën e jashtme të çdo rreshti dhe trekëndëshat e kaltër qëndrojnë brenda. [Shpjegimi është i paplotë sepse trekëndëshat e kuq në brendësi nuk janë adresuar.

Krahaso me Kodi 2, pika 4.

Nuk ka kredi (pikë)

Kodi 0: Përgjigje të tjera, duke përfshirë zgjedhjen Po, por dhënien e një shpjegimi të pasaktë ose pa dhënë shpjegim OSE zgjedhjen e Jo me ose pa shpjegim.

- [Po] e kuqe = 62,5% dhe blu = 37,5%. [Përqindja e çdo trekëndëshi me ngjyra në katër rreshtat e parë.]
- [Po].

Kodi 9: Pa përgjigje

PISA 2022

Pikët
Pyetje 1 / 1

Referohuni "Pikët" në të djathtë. Kliko një opsion dhe pastaj shkruaje një sqarim për t'u përgjigjur në pyetje.

Duke e ditur diferencën e fitores për këtë sezon, a ka mundësi që ekipi në fakt nuk e ka fituar asnjë lojë me 19 pikë diferencë?

Po
 Jo

Sqaroheni përgjigjen tuaj.


PIKËT

Mbishkrimi në vijim për ekipin e basketbollit të Zedlandës u paraqit në gazetën lokale.

ZEDLAND TAIMS

Ekipi i basketbollit e fiton kampionatin.

- E fitoi çdo ndeshje këtë sezon.
- Këtë sezon pati një mesatare prej 19 pikësh diferencë për çdo fitore.



Diferenca e fitores është diferenca mes numrit të pikëve të shënuara nga ekipi fitues dhe numri i pikëve të shënuara nga ekipi humbës në një ndeshje.

Kjo është njësia Pikët dhe është një njësi tjetër me një pyetje pa hyrje në ekran. Për këtë pyetje, nxënësve u prezantohet një titull nga gazeta për një ekip lokal basketbolli, i cili vë në dukje se skuadra fitoi çdo ndeshje këtë sezon dhe se ata kishin mesatarisht 19 pikë diferencë fitoreje këtë sezon. Përkufizimi i diferencës së fitores jepet edhe në stimulim në rastet kur nxënësit nuk e njohin termin. Pyetja që shtrohet është, a është e mundur që skuadra të mos fitojë kurrë një ndeshje me 19 pikë, duke qenë se diferenca mesatare e fitores për sezonin është 19 pikë. Kjo është një pyetje është arsyetim abstrakt që kërkon që nxënësit të vlerësojnë një hamendje bazuar në të kuptuarit e tyre konceptual të një mesatareje (d.m.th., një mesatare aritmetike). Ata duhet të zgjedhin "Po" ose "Jo" dhe të japin një shpjegim për të mbështetur zgjedhjen e tyre.

Përzgjedhja e saktë është "Po", dhe është e mundur që skuadra të mos fitojë kurrë një ndeshje me 19 pikë, edhe pse 19 është diferenca mesatare e fitores. Nxënësit mund të përgjigjen duke ditur se mesatarja nuk duhet të jetë pjesë e grupit të të dhënave, ose ata mund të japin një shembull të grupit të të dhënave që ka një mesatare prej 19, por që nuk e përmban 19 –shin në grupin e të dhënave. Vini re se për këtë qasje të fundit, nxënësit mund të japin gjithashtu një shembull tjetër të bazuar në një vlerë të ndryshme nga 19, sepse ajo ende përfaqëson një linjë të përshtatshme arsyetimi në këtë kontekst. Për shembull, mesatarja aritmetike e grupit të të dhënave 6, 9 dhe 15 është 10, edhe pse 10 nuk është anëtar i grupit të të dhënave. Përgjigjet me pikë të pjesshme adresojnë idenë se disa vlera **në grupin e të dhënave duhet të jenë më të mëdha** dhe disa vlera në grupin e të dhënave duhet të jenë më të vogla se mesatarja, por mos përmendni qartë se mesatarja nuk duhet të jetë anëtare e grupit të të dhënave.

Kjo është gjithashtu një pyetje e koduar nga njeriu (rubrika e kodimit tregohet më poshtë) që është pyetje e vështirë për nxënësit. Përgjigja e saktë ka pikë të plota (Niveli 6 në shkallën e aftësisë). Ekzistojnë pikë të pjesshme në dispozicion, por kjo është gjithashtu e vështirë (Niveli 5 në shkallë). Natyra abstrakte e kësaj detyre mund të ketë kontribuar në vështirësi. Kjo do të thotë, nxënësit nuk kanë vlera numerike që mund t'i manipulojnë për të ditur se çfarë ka ndodhur

në të vërtetë, kështu që ata janë të detyruar të arsyetojnë bazuar në kuptimin e tyre të një koncepti në mënyrë që të gjejnë një mënyrë për ta shpjeguar këtë në lidhje me kontekstin. Vini re se rubrika e kodimit nuk përmban një listë të kompletuar të përgjigjeve në asnjë nivel të pikëzimit. Megjithatë, përgjigjet e mostrës në rubrikë janë përfaqësuese të mënyrës sesi nxënësit zakonisht i përgjigjen kësaj pyetje.

Emri i Njesisë – Pyetja #	Pikët CMA156Q01
Fusha e Përmbajtjes	Të dhënat dhe Probabiliteti
Proces	Arsyeton (Vlerëson)
Konteksti	Sociale
Formati i pyetjes	Përgjigje e hapur- Koduar nga koduesi
Përgjigja	Referoju pjesës më poshtë
Nivelet e aftësisë	6 (Kredi të plota)
	5 (Kredi të pjesshme)

Kredi (pikë) të plota

Kodi 2 : Zgjedh Po dhe shpjegimi tregon se mesatarja nuk duhet të jetë pjesë e grupit të të dhënave.

- Është e mundur sepse mesatarja në fakt nuk duhet të jetë një nga vlerat në grupin tuaj të të dhënave. [Përzgjedhja “Po” nënkuptohet këtu.]
- [Po] Nëse kufijtë e fitores krijojnë një mesatare prej 19, nuk duhet domosdoshmërisht të ketë një diferencë fitoreje prej 19 pikësh në asnjë prej tyre. [*Pikë të plota për, “...nuk duhet domosdoshmërisht të ketë një diferencë fitoreje prej 19 pikësh në asnjë prej tyre”.*]
- [Po] Nëse një diferencë ishte 16 pikë dhe një tjetër 22 pikë, atëherë diferenca mesatare do të ishte 19 pikë, por 19 nuk ishte një nga diferencat.
- [Po] Mesatarja e numrave 2, 4 dhe 9 është 5, por 5 nuk është një nga numrat.

Kredi të pjesshme

Kodi 1: Zgjedh Po dhe shpjegimi është pjesërisht i saktë, por i paplotë.

- [Po] Është një diferencë mesatare, kështu që disa lojëra janë fituar me më shumë se 19 pikë dhe disa ndeshje janë fituar me më pak se 19 pikë. [*I pakompletuar; nuk thotë se 19 nuk ka nevojë të jetë një nga vlerat. Që një përgjigje si kjo të marrë pikë të pjesshme, duke fituar me më shumë dhe me më pak se 19 pikë duhet të shprehet në mënyrë eksplicite në përgjigje.*]

Nuk ka kredi

Kodi 0 (pikë): Përgjigje të tjera, duke përfshirë zgjedhjen Po, por dhënien e një shpjegimi të pasaktë ose pa dhënë shpjegim OSE zgjedhjen e Jo me ose pa shpjegim.

- [Jo] Ata duhet të kenë fituar të paktën një ndeshje me 19 pikë.
- [Po].
- [Po] Sepse mesatarja është nga të gjithë kufijtë e tyre të fitores për sezonin, të mbledhura së bashku dhe më pas pjesëtuar me numrin e ndeshjeve që kanë luajtur atë sezon. [*Shpjegim i papranueshëm që përshkruan vetëm si të llogaritet një mesatare.*]
- [Po] Sepse është thjesht një mesatare. [*Nuk është dhënë asnjë arsye pse një mesatare do të thotë se është e mundur që ata kurrë nuk kanë fituar një lojë me 19 pikë.*]
- [Po] Është një diferencë mesatare, kështu që disa ndeshje janë fituar me më shumë se 19 pikë. [*E papranueshme sepse fitorja me më pak se 19 pikë gjithashtu nuk ishte shprehur saktësisht në përgjigje.*]

Kodi 9 : Mungon përgjigja

PISA 2022

Sipërfaqja e pyllëzuar
Hyrje


Lexojeni hyrjen. Pastaj klikoni shigjetën TJETËR.

SIPËRFAQJA E PYLLËZUAR

Në këtë njësi do të përdorni pasqyrën tabelare për t'u përgjigjur në pyetjet lidhur me situatat në vijim:

Pylli është një ekosistem në të cilin mund të gjendet një llojlojshmëri drurësh, bimësh, dhe kafshësh.

Madhësia e sipërfaqes së pyllëzuar në një vend mund të ndryshojë me kohë.



Në ekranin tjetër, ju do të praktikoni përdorimin e pasqyrës tabelare.

Ky është prezantimi i njësisë Sipërfaqja e pyllëzuar, e cila u ofron nxënësve disa informata rreth kontekstit të njësisë – që sasia e sipërfaqes së pyllëzuar në një vend mund të ndryshojë me kalimin e kohës – dhe u bën të ditur se do të përdorin pasqyrën tabelare për të ndihmuar në përgjigje të pyetjeve.

PISA 2022

Sipërfaqja e pyllëzuar
Ushtrim

Tash do të ushtroni duke e përdorur pasqyrën tabelare para se të vazhdoni te pyetjet.

Përdoreni pasqyrën tabelare për t'i zgjidhur tri veprimet vijuese.

- Klasifikoni një kolonë.
 - Klikoni simbolin në kolonën B, C, ose D për ta klasifikuar atë kolonë në rend rritës (nga më e ulëta te më e larta).
 - Vini re që të gjitha kolonat do të klasifikohen në bazë të mënyrës se si klasifikohet cilado kolonë.
- Bëjeni një llogaritje
 - Zgjidhni një kolonë nga menya e parë lësho-poshtë që ndodhet nën pasqyrën tabelare.
 - Pastaj, zgjidhni një veprim nga mesi i menysë lësho-poshtë.
 - Pastaj zgjidhni një kolonë nga menya e fundit lësho-poshtë.
 - Klikoni "Fillo".
 - Rezultatet do të paraqiten në kolonën e parë të disponueshme të zbrazët.
- Paraqiteni mesataren e kolonës
 - Zgjidhni një kolonë nga menya lësho-poshtë pranë "Mesatare", që ndodhet nën pasqyrën tabelare.
 - Klikoni "Fillo".
 - Rezultatet do të paraqiten në katrorin e tabelës nën atë kolonë.

Klikoni në për të vazhduar.

SIPËRFAQJA E PYLLËZUAR

Pasqyra tabelare më poshtë tregon madhësinë e sipërfaqes së pyllëzuar si përqindje e sipërfaqes totale tokësore në secilin nga 15 vendet në këtë grup të dhënash. Të dhënat e paraqitura janë për vitet 2005, 2010, dhe 2015.

Kolona A	Kolona B	Kolona C	Kolona D	Kolona E	Kolona F	Kolona G
Vendi	2005	2010	2015			
Koreja Jugore	64.42	64.08	63.69	128.50	128.50	128.50
Panamaja	64.33	63.21	62.11	127.54	127.54	127.54
Peru	59.01	58.45	57.79	117.46	117.46	117.46
Kolumbia	54.26	52.85	52.73	107.11	107.11	107.11
Senegali	45.05	44.01	42.97	89.06	89.06	89.06
Portugalia	36.52	35.89	35.25	72.41	72.41	72.41
Shtetet e Bashkuara të Amerikës	33.26	33.7	33.85	66.96	66.96	66.96
Gjermania	32.66	32.73	32.76	65.39	65.39	65.39
Tajlanda	31.51	31.81	32.1	63.32	63.32	63.32
Greqia	29.11	30.28	31.45	59.39	59.39	59.39
India	22.77	23.47	23.77	46.24	46.24	46.24
Libani	13.34	13.38	13.42	26.72	26.72	26.72
Armenia	11.77	11.74	11.77	23.51	23.51	23.51
Kazakistani	1.24	1.23	1.23	2.47	2.47	2.47
Algjeria	0.64	0.81	0.82	1.45	1.45	1.45
	33.33	33.18	33.05	66.50		

Llogarit

Kolona C Zbritni Kolona B

Mesatarja Kolona D

Pas ekranit për hyrje, nxënësit shohin një ekran praktik ku ata duhet të kryejnë disa veprime për t'u njohur me funksionalitetin e tabelës. Veprimet përfshijnë renditjen e çdo kolone, kryerjen e një llogaritjeje (mbledhje, zbritja, shumëzimi ose pjesëtimi) me të dhënat në çdo dy kolona dhe gjenerimi i mesatares së çdo kolone. Çdo veprim vjen me udhëzime se si të përdoret mjete për të përfunduar atë veprim dhe çdo veprim duhet të kryhet përpara se të shfaqet veprimi tjetër (për lehtësi, të gjitha tregohen në këtë imazh). Shigjeta për të kaluar në ekranin tjetër bëhet aktive vetëm pasi të kenë përfunduar të tre veprimet. Vini re se të dhënat që nxënësit përdorin në ekranin për praktikim janë të njëjtat të dhëna që përdoren për njësinë.

Nëse nxënësit hutohen se çfarë të bëjnë në këtë ekran dhe janë joaktivë për një kohë të caktuar, shfaqet një mesazh pop-up për t'u kujtuar atyre veprimin që duhet të kryejnë. Nëse kalon një periudhë tjetër pasiviteti pasi shfaqet mesazhi pop-up, atëherë një animacion tregon se si të kryhet çdo veprim. Pasi të jenë ekzekutuar të gjitha animacionet, nxënësit mund të kalojnë në ekranin tjetër.

PISA 2022

Sipërfaqja e pyllëzuar
Udhëzim

Udhëzimet se si të përdoret pasqyra tabelare janë në dispozicion në secilën pyetje.

Ato gjenden në menyne e quajtur "Si të përdoret pasqyra tabelare" që mund të hapet dhe të mbyllet.

Klikoni shiritin më poshtë për të hapur udhëzimet. Klikoni shiritin përsëri për t'i mbyllur udhëzimet.

Si të përdoret pasqyra tabelare

- Klikoni për të **klasifikuar** një kolonë në rendin **ritës** (nga poshtë-lart) Klikoni sërish ikonën për ta **klasifikuar** kolonën në rendin **zvogëlues** (nga lart-poshtë).
- Për të bërë **përlogaritjet**:
 - Zgjidhni një kolonë nga menya e parë lësho-poshtë.
 - Zgjidhni një veprim nga menya e mesme lësho-poshtë.
 - Zgjidhni një kolonë nga menya e fundit lësho-poshtë.
 - Klikoni "Fillo".
 Rezultatet do të paraqiten në kolonën e parë të disponueshme të zbrazët.
- Për të paraqitur **mesataren** e kolonës, zgjidhni një kolonë nga menya lësho-poshtë dhe klikoni "Fillo". Rezultati do të paraqitet në katorrin e tabelës nën atë kolonë.
- Për ta zhbërë një veprim në kolonë, klikoni
- Për ta fshirë kolonën, klikoni .
- Për ta fshirë plotësisht pasqyrën tabelare, klikoni "Fshij të gjitha."

SIPËRFAQJA E PYLLËZUAR

Pasqyra tabelare më poshtë tregon madhësinë e sipërfaqes së pyllëzuar si përqindje e sipërfaqes totale tokësore në secilin nga 15 vendet në këtë grup të dhënash. Të dhënat e paraqitura janë për vitet 2005, 2010, dhe 2015.

Kolona A	Kolona B	Kolona C	Kolona D	Kolona E	Kolona F	Kolona G
Vendi	2005	2010	2015		<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>
Algeria	0.64	0.81	0.82			
Armenia	11.77	11.74	11.77			
Gjermania	32.66	32.73	32.76			
Greqia	29.11	30.28	31.45			
India	22.77	23.47	23.77			
Kazakistani	1.24	1.23	1.23			
Kolumbia	54.26	52.85	52.73			
Koreja Jugore	64.42	64.08	63.69			
Libani	13.34	13.38	13.42			
Panamaja	64.33	63.21	62.11			
Peru	59.01	58.45	57.79			
Portugalia	36.52	35.89	35.25			
Senegali	45.05	44.01	42.97			
Shtetet e Bashkuara të Amerikës	33.26	33.7	33.85			
Tajlanda	31.51	31.81	32.1			

Llogarit

Kolona Veprimi Kolona

Mesatarja Kolona

Pas ekranit për praktikim, nxënësit dalin në një ekran për udhëzime, i cili është thjesht për t'i bërë të ditur se udhëzimet për përdorimin e pasqyrës tabelare janë në dispozicion në çdo pyetje dhe mund të kenë qasje gjithmonë duke klikuar në shiritin me tekstin, "Si të përdorim pasqyrën tabelare". Duke klikuar në këtë shirit hapet lista e udhëzimeve, siç tregohet më sipër. Duke klikuar përsëri në shirit mbyllet lista e udhëzimeve.

Ashtu si në ekranin për praktikim, nxënësve nuk u lejohej të kalojnë ekranin derisa të kenë kryer veprimin (d.m.th., të hapin udhëzimet). Përsëri, nëse ka një periudhë pasiviteti, atëherë një mesazh pop-up u kujton nxënësve veprimin që duhet të kryejnë. Nëse ata ende nuk e kryejnë veprimin, atëherë pas një periudhe tjetër të shkurtër kohe, luan një animacion. Pas luajtjes së animacionit, nxënësit mund të kalojnë në pyetjen e parë të njësisë.

Të dhënat e përdorura për të gjitha pyetjet në këtë njësi janë madhësia e sipërfaqes së pyllëzuar si përqindje e sipërfaqes totale të tokës për 15 vende për vitet 2005, 2010 dhe 2015 dhe këto të dhëna janë gjithmonë në kolonat B, C dhe D. Kolonat E, F dhe G janë gjithmonë bosh kur nxënësit arrijnë për herë të parë te secila pyetje dhe renditja e parazgjedhur e vendeve është sipas alfabetit, bazuar në mënyrën se si përkthehen emrat e shteteve në secilën gjuhë. Vini re se në fotografinë e mësipërme, të dhënat janë manipuluar tashmë për të korresponduar me përshkrimin e zgjidhjes që vijon.

Pika e parë e njësisë kërkon që nxënësit të identifikojnë, në përqindje, tri vendet që patën midis 2005 dhe 2015, fitimin më të madh në përqindjen e sipërfaqes së pyllëzuar, asnjë ndryshim të përgjithshëm në përqindjen e sipërfaqes së pyllëzuar dhe humbjen më të madhe në përqindjen e saj të sipërfaqes pyjore. Përgjigjet futen në çdo rresht të tabelës nëpërmjet menyeve rënëse që përmbajnë emrat e të 15 vendeve.

Një metodë e mundshme zgjidhjeje, e cila pasqyrohet në fotografinë e mësipërme, është përdorimi i pasqyrës tabelare për të kryer llogaritjen e mëposhtme: "Kolona D zbret kolonën B", e cila zbret përqindjen e sipërfaqes së pyllëzuar në 2005 nga përqindja e sipërfaqes së

pyllëzuar në 2015 për çdo shtet. Rezultatet e llogaritjes paraqiten në kolonën E. Më pas, nxënësi mund të zgjedhë të renditë të dhënat në kolonën E për ta bërë më të lehtë identifikimin e secilit shtet.

PISA 2022
▶
▶

Sipërfaqja e pyllëzuar
Pyetje 1 / 4

▶ Si të përdoret pasqyra tabelare

Shihni "Sipërfaqja e pyllëzuar" në anën e djathtë. Përdoreni pasqyrën tabelare për t'ju ndihmuar që të përgjigjeni në pyetjen e mëposhtme. Zgjidhni nga menyte lësho-poshtë për t'ju përgjigjur në secilën pyetje.

Në tabelën më poshtë, përgjigjuni në secilën pyetje duke e përzgjedhur një vend nga menya përkatëse lësho-poshtë.

Pyetja	Vendi
Sipas pikëve të përqindjes, cili vend ka përfitur më së shumti mes viteve 2005 dhe 2015?	Zgjedhni
Cili vend nuk ka pasur ndryshim të gjithëmbarshtëm mes viteve 2005 dhe 2015?	Zgjedhni
Sipas pikëve të përqindjes, cili vend ka pasur humbje më të mëdha mes viteve 2005 dhe 2015?	Zgjedhni

SIPËRFAQJA E PYLLËZUAR

Pasqyra tabelare më poshtë tregon madhësinë e sipërfaqes së pyllëzuar si përqindje e sipërfaqes totale tokësore në secilin nga 15 vendet në këtë grup të dhënash. Të dhënat e paraqitura janë për vitet 2005, 2010, dhe 2015.

Kolona A	Kolona B	Kolona C	Kolona D	Kolona E	Kolona F	Kolona G
Vendi	2005	2010	2015	↻ ✕	↻ ✕	↻ ✕
Algjeria	0.64	0.81	0.82			
Armenia	11.77	11.74	11.77			
Gjermania	32.66	32.73	32.76			
Greqia	29.11	30.28	31.45			
India	22.77	23.47	23.77			
Kazakistani	1.24	1.23	1.23			
Kolumbia	54.26	52.85	52.73			
Koreja Jugore	64.42	64.08	63.69			
Libani	13.34	13.38	13.42			
Panamaja	64.33	63.21	62.11			
Peru	59.01	58.45	57.79			
Portugalia	36.52	35.89	35.25			
Senegali	45.05	44.01	42.97			
Shtetet e Bashkuara të Amerikës	33.26	33.7	33.85			
Tajlanda	31.51	31.81	32.1			

Llogarit

Kolona ▼
Veprimi ▼
Kolona ▼
Fillo

Mesatarja
Kolona ▼
Fillo
Fshij të gjitha

Të dhënat e përdorura për të gjitha pyetjet në këtë njësi janë madhësia e sipërfaqes së pyllëzuar si përqindje e sipërfaqes totale të tokës për 15 vende për vitet 2005, 2010 dhe 2015 dhe këto të dhëna janë gjithmonë në kolonat B, C dhe D. Kolonat E, F dhe G janë gjithmonë bosh kur nxënësit arrijnë për herë të parë të secila pyetje dhe renditja e parazgjedhur e vendeve është sipas alfabetit, bazuar në mënyrën se si përkthehen emrat e shteteve në secilën gjuhë. Vini re se në fotografinë e mësipërme, të dhënat janë manipuluar tashmë për të korresponduar me përshkrimin e zgjidhjes që vijon.

Pika e parë e njësisë kërkon që nxënësit të identifikojnë, në përqindjeje, tri vendet që patën midis 2005 dhe 2015, fitimin më të madh në përqindjen e sipërfaqes së pyllëzuar, asnjë ndryshim të përgjithshëm në përqindjen e sipërfaqes së pyllëzuar dhe humbjen më të madhe në përqindjen e saj të sipërfaqes pyjore. Përgjigjet futen në çdo rresht të tabelës nëpërmjet menyve rënëse që përmbajnë emrat e të 15 vendeve.

Një metodë e mundshme zgjidhjeje, e cila pasqyrohet në fotografinë e mësipërme, është përdorimi i pasqyrës tabelare për të kryer llogaritjen e mëposhtme: "Kolona D zbret kolonën B", e cila zbret përqindjen e sipërfaqes së pyllëzuar në 2005 nga përqindja e sipërfaqes së pyllëzuar në 2015 për çdo shtet. Rezultatet e llogaritjes paraqiten në kolonën E. Më pas, nxënësi mund të zgjedhë të renditë të dhënat në kolonën E për ta bërë më të lehtë identifikimin e secilit shtet.

Vendi me përfitimin më të madh është vendi me rezultatin më të madh pozitiv, që është Greqia me 2.34 përqindje të pikëve; vendi pa ndryshim të përgjithshëm është vendi me një diferencë prej 0.00, që është Armenia; dhe vendi me humbjen më të madhe është vendi me rezultatin më të vogël negativ, që është Panama me -2.22 përqindje të pikëve.

Një përgjigje me pikë të plota jepet kur bëhet identifikimi i saktë i të tre vendeve dhe i shkallëzuar në nivelin 5, që do të thotë se ishte një detyrë e vështirë për nxënësit. Pikë të pjesshme jepen për identifikimin e saktë të çdo dy shteteve dhe kjo është një detyrë mesatarisht e vështirë e shkallëzuar në nivelin 4, gjë që nuk është befasuese duke pasur parasysh se pikët e pjesshme kërkojnë të njëjtën punë si një përgjigje me pikë të plota. Kjo do të thotë, për të identifikuar saktë çdo dy ose tre vende, nxënësit duhet të përcaktojnë se çfarë përlllogaritjesh duhet të kryejnë, si të përdorin tabelat për t'i kryer ato dhe në fund të interpretojnë rezultatet në lidhje me kontekstin.

Gjithashtu, në varësi të radhës që nxënësi kryen llogaritjen, identifikimi i vendeve mund të jetë më i vështirë. Për shembull, nëse nxënësi llogarit "Kolona B zbret kolonën D" (në vend të "Kolones D zbret kolonën B"), atëherë shenja e secilit rezultat që shfaqet në kolonën E do të jetë e kundërta (p.sh., Greqia = -2.34 dhe Panama = +2.22). Megjithatë, bazuar në këto të dhëna, përqindja e sipërfaqes pyjore për Greqi në fakt u rrit për çdo vit të treguar dhe përqindja e sipërfaqes pyjore për Panamanë në fakt u ul për çdo vit të treguar.

Emri i Njësisë – Pyetja #	Sipërfaqja e pyllëzuar – CMA161Q01
Fusha e Përmbajtjes	Të dhënat dhe Probabiliteti
Procesi	Formulon/ Analizon
Konteksti (situate)	Sociale
Formati i Pyetjes	Zgjedhje komplekse e shumëfishtë-pikëzimi me kompjuter
Përgjigja	Kredi të plota: Të tri vendet janë identifikuar saktë (nga lartë poshtë: Fitues = Greqia; Asnjë ndryshim = Armenia; Humbje = Panama)
	Kredi të pjesshme: Çdo dy shtete janë identifikuar saktë (shteti tjetër është i pasaktë ose mungon)
Nivelet e aftësisë	5 (Kredi të plota)
	4 (Kredi të pjesshme)

PISA 2022

Sipërfaqja e pyllëzuar
Pyetje 2 / 4

► **Si të përdoret pasqyra tabelare**

Shihni "Sipërfaqja e pyllëzuar" në anën e djathtë. Përdoreni pasqyrën tabelare për t'u ndihmuar që të përgjigjeni në pyetjen e mëposhtme. Klikoni një opsion për t'u përgjigjur në pyetje.

Shqyrtojini dy periudhat kohore: nga 2005 deri në 2010 dhe nga 2010 deri në 2015.

Cili nga formulimet në vijim e përshkruan saktë ndryshimin mesatar të përqindjes së sipërfaqes së pyllëzuar për të dy periudhat kohore?

Ndryshimi mesatar ishte pozitiv për të dy periudhat kohore?

Ndryshimi mesatar ishte negativ për të dy periudhat kohore.

Ndryshimi mesatar ishte i njëjtë për të dy periudhat kohore.

Ndryshimi mesatar ishte pozitiv për njëri periudhë kohore, dhe negativ për periudhën tjetër kohore.

SIPËRFAQJA E PYLLËZUAR

Pasqyra tabelare më poshtë tregon madhësinë e sipërfaqes së pyllëzuar si përqindje e sipërfaqes totale tokësore në secilin nga 15 vendet në këtë grup të dhënash. Të dhënat e paraqitura janë për vitet 2005, 2010, dhe 2015.

Kolona A	Kolona B	Kolona C	Kolona D	Kolona E	Kolona F	Kolona G
Vendi	2005	2010	2015	↻ ×	↻ ×	↻ ×
Algjeria	0.64	0.81	0.82			
Armenia	11.77	11.74	11.77			
Gjermania	32.66	32.73	32.76			
Greqia	29.11	30.28	31.45			
India	22.77	23.47	23.77			
Kazakistani	1.24	1.23	1.23			
Kolumbia	54.26	52.85	52.73			
Koreja Jugore	64.42	64.08	63.69			
Libani	13.34	13.38	13.42			
Panamaja	64.33	63.21	62.11			
Peru	59.01	58.45	57.79			
Portugalia	36.52	35.89	35.25			
Senegali	45.05	44.01	42.97			
Shtetet e Bashkuara të Amerikës	33.26	33.7	33.85			
Tajlanda	31.51	31.81	32.1			

Llogarit

Kolona ▼ Veprimi ▼ Kolona ▼ Fillo

Mesatarja Kolona ▼ Fillo Fshij të gjitha

Në pikën e dytë në këtë njësi, nxënësve u thuhet të marrin në konsideratë të dhënat në terma të dy periudhave kohore, 2005-2010 dhe 2010-2015, pastaj u kërkohet të identifikojnë deklaratën që përshkruan saktë ndryshimin mesatar në përqindjen e sipërfaqes së pyllëzuar për çdo periudhë kohore.

Një metodë e mundshme zgjidhjeje është që nga pasqyra tabelare të llogarisë mesataren e kolonave B, C dhe D ku dhe vërehet se ajo u ul nga 2005 në 2010 (nga 33.33 në 33.18) dhe se gjithashtu u ul nga 2010 në 2015 (nga 33.18 deri në 33.05). Meqenëse ndryshimi mesatar u zvogëluar në çdo periudhë kohore, përgjigjja e saktë është se "Ndryshimi mesatar ishte negativ për të dyja periudhat kohore".

Nxënësit mund të zgjedhin gjithashtu të kryejnë një sërë veprimesh, të tilla si:

- "Kolona C zbrit kolonën B" (rezultatet e këtij veprimi tregohen në kolonën E), që paraqet ndryshimin në përqindjen e sipërfaqes së pyllëzuar për periudhën kohore 2005-2010.
- "Kolona D zbrit kolonën C" (rezultatet e këtij veprimi tregohen në kolonën F), e cila përfaqëson
- Ndryshimi i përqindjes së sipërfaqes së pyllëzuar për periudhën kohore 2010-2015.
- Llogaritni mesataren e kolonave E dhe F.

Kjo është një pyetje e vështirë që është e shkallëzuar në nivelin 5 në shkallën e aftësisë. Nxënësit përsëri duhet të hartojnë një strategji për përdorimin e tabelës, por këtë herë ka më shumë fleksibilitet në mënyrën se si mund të përdoret tabela përpara se të interpretojnë rezultatet. Ndoshta vështirësia e kësaj pyetje kontribuon në interpretimin e saktë të "ndryshimit" në kontekstin e problemit, kur rezultatet mund të jenë pozitive ose negative në varësi të veprimit që kryen nxënësi dhe rendit të cilin ata i kryejnë ato.

Emri I Njesisë –Pyetja #	Sipërfaqja e pyllëzuar – CMA161Q02
Fusha e Përmbajtjes	Të dhënat dhe probabiliteti
Procesi	Interpreton/Vlerëson
Konteksti (situatë)	Sociale
Formati i Pyetjes	Zgjedhje e thjeshtë e shumëfishtë – pikëzimi me kompjuter
Përgjigja	Ndryshimi mesatar ishte negativ për të dyja periudhat kohore.
Niveli i Aftësisë	5

PISA 2022

?
◀ ▶

Sipërfaqja e pyllëzuar
 Pyetje 3 / 4

▶ Si të përdoret pasqyra tabelare

Shihni "Sipërfaqja e pyllëzuar" në anën e djathtë. Përdoreni pasqyrën tabelare për t'ju ndihmuar që të përgjigjeni në pyetjen e mëposhtme. Zgjidhni nga menyte lësho-poshtë për t'u përgjigjur në pyetje.

Shqyrtojini dy periudhat kohore: nga 2005 deri në 2010 dhe nga 2010 deri në 2015.

Nga aspekti i përqindjes, cilat dy vende e patën ndryshimin më të madh në përqindjen e sipërfaqes së pyllëzuar nga njëra periudhë kohore në periudhën tjetër kohore?

Përgjigjet: Zgjedhni dhe Zgjedhni

SIPËRFAQJA E PYLLËZUAR

Pasqyra tabelare më poshtë tregon madhësinë e sipërfaqes së pyllëzuar si përqindje e sipërfaqes totale tokësore në secilin nga 15 vendet në këtë grup të dhënash. Të dhënat e paraqitura janë për vitet 2005, 2010, dhe 2015.

Kolona A	Kolona B	Kolona C	Kolona D	Kolona E	Kolona F	Kolona G
Vendi	2005	2010	2015	↻ ✕	↻ ✕	↻ ✕
Algeria	0.64	0.81	0.82			
Armenia	11.77	11.74	11.77			
Gjermania	32.66	32.73	32.76			
Greqia	29.11	30.28	31.45			
India	22.77	23.47	23.77			
Kazakistani	1.24	1.23	1.23			
Kolumbia	54.26	52.85	52.73			
Koreja Jugore	64.42	64.08	63.69			
Libani	13.34	13.38	13.42			
Panamaja	64.33	63.21	62.11			
Peru	59.01	58.45	57.79			
Portugalia	36.52	35.89	35.25			
Senegali	45.05	44.01	42.97			
Shtetet e Bashkuara të Amerikës	33.26	33.7	33.85			
Tajlanda	31.51	31.81	32.1			

Llogarit Kolona ▼ Veprimi ▼ Kolona ▼ Fillo

Mesatarja Kolona ▼ Fillo Fshij të gjitha

Në pyetjen e tretë të kësaj njësie, nxënësve u thuhet sërish të marrin në konsideratë të dhënat në terma të dy periudhave kohore, 2005-2010 dhe 2010-2015, por kësaj here u kërkohet të identifikojnë dy vendet që kanë pasur ndryshimin më të madh në përqindje të zonës pyjore nga një periudhë kohore në periudhën tjetër kohore. Përgjigjet jepen duke zgjedhur emrin e shtetit nga një meny rënëse. Nuk ka rëndësi rendi që u jepet vendeve në përgjigje.

Një metodë e mundshme zgjidhjeje, e cila pasqyrohet në imazhin e mësipërm, është të kryeni veprimin e mëposhtëm duke përdorur tabelën (Vini re se këto dy llogaritje janë të njëjtat dy llogaritjet që mund të kryhen edhe në pyetjen e dytë të njësisë):

“Kolona C zbret kolonën B” (rezultatet e veprimit tregohen në kolonën E), që paraqet ndryshimin në përqindjen e sipërfaqes së pyllëzuar për periudhën kohore 2005-2010.

“Kolona D zbret kolonën C” (rezultatet e atij operacioni tregohen në kolonën F), që paraqet ndryshimin në përqindjen e sipërfaqes së pyllëzuar për periudhën kohore 2010-2015.

Pasi nxënësit të kenë llogaritur ndryshimin në përqindjen e sipërfaqes së pyllëzuar për çdo periudhë kohore, ata duhet të llogarisin ndryshimin midis dy periudhave kohore duke kryer një llogaritje të tillë si "Kolona E zbret kolonën F" (rezultatet e atij veprimi tregohen në kolonën G). Nxënësve mund t'u duket e dobishme edhe renditja e rezultateve në kolonën G.

Dy vendet me ndryshimin më të madh midis periudhave kohore janë India (0.40 përqindje të pikëve) dhe Kolumbia (-1,29 përqindje të pikëve). Pikë të plota jepen për identifikimin e saktë të të dy vendeve dhe pike të pjesshme jepet për identifikimin e saktë të një vendi.

Kjo është një pyetje shumë e vështirë që u shkallëzua në nivelin 6 në shkallën e aftësisë. Pikëzimi i pjesshëm i kësaj pyetje është i Nivelit 5 dhe ngjashëm me pyetjen e parë në njësi, kërkon të bësh të njëjtën punë që nevojitet për një përgjigje me pikë të plota. Nxënësit përsëri duhet të hartojnë një strategji për përdorimin e tabelës, e cila këtë herë kërkon kryerjen e veprimeve të shumta, përpara se të jenë në gjendje të vlerësojnë rezultatet në lidhje me kontekstin. Ndoshta në vështirësinë e kësaj pyetje ka kontribuar identifikimi i "ndryshimit të madh" në këtë kontekst që nuk do të thotë vetëm rritje në fakt, një nga përgjigjet e sakta është vendi me rënien më të madhe në përqindjen e sipërfaqes së pyllëzuar ndërmjet periudhave kohore. Megjithatë, ndryshe nga pyetjet e mëparshme në këtë njësi, vendet e sakta ende mund të identifikohen edhe nëse shenjat e rezultateve janë të kundërta (për shkak të rendit të kryerjes së veprimeve) nxënësit kërkojnë ndryshim në termat e vlerës absolute dhe jo duke interpretuar rezultatet në mënyrë specifike si rritje ose ulje.

Emri i Njësisë – Pyetja #	Sipërfaqja e pyllëzuar – CMA161Q03
Fusha e Përmbajtjes	Të dhënat dhe probabiliteti
Proces	Interpreton/vlerëson
Konteksti (situate)	Sociale
Formati i Pyetjes	Zgjedhje komplekse e shumëfishtë – pikëzim me kompjuter
Përgjigja	Kredi të plota: India dhe Kolumbia [në çfarëdo renditje]
	Kredi të pjesshme: Vetëm një përzgjedhje është e saktë (përzgjedhja tjetër është e pasaktë ose mungon)
Niveli i aftësisë	6 (kredi të plota)
	5 (kredi të pjesshme)

PISA 2022

Sipërfaqja e pyllëzuar
Pyetje 4 / 4

► Si të përdoret pasqyra tabelare

Shihni "Sipërfaqja e pyllëzuar" në anën e djathtë. Përdoreni pasqyrën tabelare për t'ju ndihmuar që të përgjigjeni në pyetjen e mëposhtme. Klikoni një opsion dhe pastaj shkruani një sqarim për t'u përgjigjur në pyetje.

Helena pohon që Koreja Jugore ka më shumë sipërfaqe të pyllëzuar se çdo vend tjetër në këtë listë për vitet e dhëna.

A mbështetet pohimi i saj nga të dhënat në pasqyrën tabelare?

Po
 Jo

Sqarojeni përgjigjen tuaj.

SIPËRFAQJA E PYLLËZUAR

Pasqyra tabelare më poshtë tregon madhësinë e sipërfaqes së pyllëzuar si përqindje e sipërfaqes totale tokësore në secilin nga 15 vendet në këtë grup të dhënash. Të dhënat e paraqitura janë për vitet 2005, 2010, dhe 2015.

Kolona A	Kolona B	Kolona C	Kolona D	Kolona E	Kolona F	Kolona G
Vendi	2005	2010	2015	↻ ✕	↻ ✕	↻ ✕
Algeria	0.64	0.81	0.82			
Armenia	11.77	11.74	11.77			
Gjermania	32.66	32.73	32.76			
Greqia	29.11	30.28	31.45			
India	22.77	23.47	23.77			
Kazakistani	1.24	1.23	1.23			
Kolumbia	54.26	52.85	52.73			
Koreja Jugore	64.42	64.08	63.69			
Libani	13.34	13.38	13.42			
Panamaja	64.33	63.21	62.11			
Peru	59.01	58.45	57.79			
Portugalia	36.52	35.89	35.25			
Senegali	45.05	44.01	42.97			
Shtetet e Bashkuara të Amerikës	33.26	33.7	33.85			
Tajlanda	31.51	31.81	32.1			

Llogarit

Kolona Veprimi Kolona Fillo

Mesatarja Kolona Fillo Fshij të gjitha

Kjo është pyetje e fundit në këtë njësi. Nxënësve u paraqitet një deklaratë se Koreja e Jugut ka më shumë sipërfaqe pyjore se 15 vendet e tjera në listë për vitet e treguara dhe ata duhet të përcaktojnë nëse deklarata mbështetet nga të dhënat në tabelë. Ashtu si me disa pyetje të tjera të koduara nga njeriu, nxënësit duhet të zgjedhin "Po" ose "Jo" dhe më pas të japin një shpjegim për të mbështetur zgjedhjen e tyre. Ndryshe nga pyetjet e mëparshme në njësi, kjo pyetje në fakt nuk kërkon përdorimin e të dhënave në tabelë për t'u përgjigjur; megjithatë, i gjithë funksionaliteti i tabelës është ende në dispozicion.

Edhe pse Koreja e Jugut është vendi në këtë listë me përqindjen më të lartë të sipërfaqes pyjore për secilin prej tre viteve, përgjigjja e saktë është "Jo", deklarata nuk mbështetet nga të dhënat në tabelë. Nga të dhënat e paraqitura nuk është e mundur të konkludohet asgjë për sasinë aktuale të sipërfaqes pyjore në këto vende, sepse të dhënat e paraqitura janë vetëm përqindja e sipërfaqes pyjore. Sipërfaqja totale e tokës së çdo vendi gjithashtu nuk jepet në tabelë dhe ky informacion "i cili mungon" është i nevojshëm për të përcaktuar sasinë aktuale të sipërfaqes së pyllëzuar në secilin vend. Kjo do të thotë, për shkak se të dhënat e paraqitura janë përqindje të sasive të ndryshme (d.m.th., sipërfaqe të ndryshme toke, të cilat nuk janë përfshirë në tabelë), ato nuk e mbështesin deklaratën.

Kjo është një pyetje me arsytim që kërkon nga nxënësit të vlerësojnë një deklaratë duke kuptuar kufijtë e asaj që mund të nxirret nga të dhënat e disponueshme. Kjo do të thotë, nxënësit nuk duhet të përcaktojnë nëse deklarata specifike për Korenë e Jugut është e vërtetë apo jo; ata duhet të përcaktojnë nëse kërkesa mbështetet nga të dhënat në dispozicion. Është një pyetje shumë e vështirë e shkallëzuar në nivelin 6. Nuk ka asnjë përgjigje me pikë të pjesshme për këtë pyetje. Rubrika e kodimit është paraqitur më poshtë. Vini re se rubrika e kodimit nuk përmban një listë complete të përgjigjeve. Megjithatë, përgjigjet e mostrës në rubrikë janë përfaqësuese të mënyrës sesi nxënësit zakonisht i përgjigjen kësaj pyetje.

Emri i Njesisë – Pyetja #	Sipërfaqja e Pyllëzuar – CMA161Q04
Fusha e Përmbajtjes	Të dhënat dhe probabiliteti
Procesi	Arsyeton (Vlerëson)
Konteksti (situatë)	Sociale
Formati i pyetjes	Përgjigje e hapur – pikëzim nga koderi
Përgjigja	Referojuni pjesës më poshtë
Niveli i shkathtësisë	6

Kredi (pikë) të Plota

Kodi 1: Zgjedh Jo dhe shpjegon se tabela tregon vetëm përqindjen e sipërfaqes së pyllëzuar OSE që tabela nuk tregon sipërfaqen totale të tokës për çdo vend OSE që zonat e vendeve janë të ndryshme.

- [Jo] Kjo nuk është e vërtetë sepse tabela tregon vetëm vlerat si përqindje.
- Deklarata e saj nuk mbështetet nga të dhënat në tabela, sepse ne nuk e dimë sipërfaqen totale për secilin nga vendet e listuara. [Përzgjedhja e "Jo" nënkuptohet këtu.]
- [Jo] Sepse sipërfaqja totale e çdo vendi është e ndryshme.
- [Jo] Çdo vend nuk ka të njëjtën zonë.

Nuk ka Kredi (pikë)

Kodi 0 : Përgjigje të tjera, duke përfshirë zgjedhjen Jo, por dhënien e një shpjegimi të pasaktë ose pa dhënë një shpjegim OSE zgjedhjen Po me ose pa shpjegim.

- [Jo].
- [Jo] Sepse është ndryshe.
- [Po] Koreja e Jugut ka sasinë më të madhe të treguar për çdo vit.

Kodi 9 : Mungon përgjigja

PISA 2022

Blerja e veturës
Hyrje

Lexojeni hyrjen. Pastaj klikoni shigjetën TJETËR.

BLERJA E VETURËS

Tanja planifikon të blejë një veturë të re. Ajo dëshiron të dijë sa do të kushtojë të blejë një veturë dhe që ta ngasë atë vitin e parë.

Ajo e gjen këtë Llogaritës Kostoje në internet dhe i bën këto përlogaritje:

- Ajo do të kalojë një distancë të përafërt prej rreth 20 000 km në vit të parë
- Kostoja mesatare e karburantit do të jetë 1.54 zed për një litër.
- Kostoja e përafërt e mirëmbajtjes është 250 zed në vitin e parë.

LLOGARITËSI I KOSTOS

Çmimi i veturës (zed)

Shpenzimi i karburantit (L/100 km)

Distanca e përafërt e kaluar

Kostoja mesatare e karburantit (zed/L)

Kostoja e përafërt e mirëmbajtjes (zed)

PISA 2022

Blerja e veturës
Pyetje 1 / 2

► Si të përdoret Llogaritësi i Kostos

Shihni "Blerja e veturës" në anën e djathtë. Përdoreni Llogaritësin e Kostos për t'ju ndihmuar që të përgjigjeni në pyetjen më poshtë. Klikoni një opsion për t'u përgjigjur në pyetje.

Për të parë si përdoret Llogaritësi i Kostos, klikoni më lart në "Si përdoret Llogaritësi i Kostos".

Bazuar në llogaritjet e Tanjës, cila veturë do t'i kushtojë asaj më së liri për ta blerë dhe për ta ngarë vitin e parë?

Vetura A
 Vetura B
 Vetura C
 Vetura D

BLERJA E VETURËS

Çmimet dhe shpenzimet e karburantit të katër veturave që Tanja synon t'i blejë janë paraqitur në tabelën më poshtë.

Shpenzimi i karburantit është numri i litrave të karburantit që nevojitet për t'i kaluar 100 km. Kjo është një llogaritje bazuar në kombinimin e ngasjes në qytet dhe autostradë.

	Vetura A	Vetura B	Vetura C	Vetura D
Çmimi i veturës (zed) Çmimi i veturës përfshin të gjitha taksat dhe pagesat e regjistrimit.	8000	8700	9900	10 500
Shpenzimi i karburantit (L/100 km)	18.9	15.7	12.4	14.1

Disa nga katrorët në Llogaritësin e Kostos janë plotësuar në bazë të vlerësimeve të Tanjës.

LLOGARITËSI I KOSTOS

Çmimi i veturës (zed)

Shpenzimi i karburantit (L/100 km)

Distanca e përafërt e kaluar

Kostoja mesatare e karburantit (zed/L)

Kostoja e përafërt e mirëmbajtjes (zed)

REZULTATET

PISA 2022



Blerja e veturës

Pyetje 2 / 2

Shihni "Blerja e veturës" në anën e djathtë. Klikoni një opion për t'u përgjigjur në pyetje.

Çmimi i rishitjes së një veture është çmimi i llogaritur me të cilin mund të shitet përsëri më vonë.

Për një veturë që mbetet në gjendje të shkëlqyer, vlera e saj do të ulet 5% për çdo vjet.

Nëse Tanja vendosë të blejë veturën D dhe ta shesë atë përsëri pas tre vitesh në gjendje të shkëlqyer, sa do të jetë vlera e përafërt e veturës në zed?

- 1575
- 8925
- 9000
- 9975

BLERJA E VETURËS

Çmimet dhe shpenzimet e karburantit të katër veturave që Tanja synon t'i blejë janë paraqitur në tabelën më poshtë.

Shpenzimi i karburantit është numri i litrave të karburantit që nevojitet për t'i kaluar 100 km. Kjo është një llogaritje bazuar në kombinimin e ngasjes në qytet dhe autostradë.

	Vetura A	Vetura B	Vetura C	Vetura D
Çmimi i veturës (zed) Çmimi i veturës përfshin të gjitha taksat dhe pagesat e regjistrimit.	8000	8700	9900	10 500
Shpenzimi i karburantit (L/100 km)	18.9	15.7	12.4	14.1

PISA 2022



Shitja e DVD-ve

Hyrje

Lexojeni hyrjen. Pastaj klikoni shigjetën **TJETËR**.


SHITJA E DVD-ve

Numri total i DVD-ve të shitura çdo vit në Mbretërinë e Bashkuar nga viti 2008 deri në 2014 është paraqitur në diagramin më poshtë.

Vlerat në boshtin horizontal paraqesin numrin e viteve **pas** vitit 2008. Vendoseni kursorin mbi pikat në diagram për t'i parë koordinatat e asaj pike. Për shembull, pika (0,252.9) tregon që janë shitur 252.9 milionë DVD në vitin 2008. Pika (1,234.6) tregon që janë shitur 234.6 milionë DVD gjatë vitit 2009, etj.



Shitja e DVD-ve në Mbretërinë e Bashkuar



PISA 2022

Shitja e DVD-ve

Pyetje 1 / 3

Shihni "Shitja e DVD-ve" në anën e djathtë. Klikoni opsionet në tabelë për t'u përgjigjur në pyetje.

A mbështeten formulimet në tabelën e mëposhtme nga informatat e paraqitura në diagram. Klikoni **Po** ose **Jo** për çdo formulim.

Formulimi	Po	Jo
Numri i DVD-ve të shitura zbriti për rreth 50% nga viti 2008 deri në vitin 2014.	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Numri i DVD-ve të shitura zbriti në sasi të njëjtë çdo vit nga viti 2008 deri në vitin 2014.	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Vija e pjerrtë është rënia mesatare e shitjes së DVD-ve nga viti 2008 deri në vitin 2014.	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>


SHITJA E DVD-ve

Numri total i DVD-ve të shitura çdo vit në Mbretërinë e Bashkuar nga viti 2008 deri në 2014 është paraqitur në diagramin më poshtë.

Vlerat në boshtin horizontal paraqesin numrin e viteve **pas** vitit 2008. Vendoseni kursorin mbi pikat në diagram për t'i parë koordinatat e asaj pike. Për shembull, pika (0,252.9) tregon që janë shitur 252.9 milionë DVD në vitin 2008. Pika (1,234.6) tregon që janë shitur 234.6 milionë DVD gjatë vitit 2009, etj.

Një vijë është shtuar në diagram për t'i modeluar këto pika të dhënash.

Shitja e DVD-ve në Mbretërinë e Bashkuar



PISA 2022

Shitja e DVD-ve

Pyetje 2 / 3

Shihni "Shitja e DVD-ve" në anën e djathtë. Me përdorimin e tasteve të numrave, shënojeni përgjigjen tuaj në pyetje.

Ekuacioni i vijës është $d = 254 - 22n$ ku d është numri i DVD-ve të shitura (në miliona) dhe n është numri i viteve pas vitit 2008.

Nëse ky trend i shitjes vazhdon, në cilin vit numri i DVD-ve të shitura do të jetë më pak se 1 milion sipas modelit?

Përgjigja


SHITJA E DVD-ve

Numri total i DVD-ve të shitura çdo vit në Mbretërinë e Bashkuar nga viti 2008 deri në 2014 është paraqitur në diagramin më poshtë.

Vlerat në boshtin horizontal paraqesin numrin e viteve **pas** vitit 2008. Vendoseni kursorin mbi pikat në diagram për t'i parë koordinatat e asaj pike. Për shembull, pika (0,252.9) tregon që janë shitur 252.9 milionë DVD në vitin 2008. Pika (1,234.6) tregon që janë shitur 234.6 milionë DVD gjatë vitit 2009, etj.

Një vijë është shtuar në diagram për t'i modeluar këto pika të dhënash.

Shitja e DVD-ve në Mbretërinë e Bashkuar



PISA 2022

Shitja e DVD-ve

Pyetje 3 / 3

Shihni "Shitja e DVD-ve" në anën e djathtë Zgjidhni nga menyte lësho-poshtë për t'u përgjigjur në pyetje.

Që nga viti 1998, ka pasur disa ndryshime në trendin e shitjes për numrin e DVD-ve të shitura.

Cilat janë trendet e shitjes dhe modelet matematikore që më së miri përputhen me këto të dhëna për vitet 1998-2004 dhe 2005-2007?

Plotësojeni tabelën duke i zgjedhur përgjigjet tuaja nga menyte lësho-poshtë. E fundit është plotësuar për ju si shembull.

Vitet	Trendi i shitjes	Modeli matematikor
1998 – 2004	Zgjedhni	Zgjedhni
2005 – 2007	Zgjedhni	Zgjedhni
2008 – 2014	Zbritje	Linear

SHITJA E DVD-ve

Numri total i DVD-ve të shitura çdo vjet në Mbretërinë e Bashkuar nga viti 1998 deri në 2014 është paraqitur në diagram. Vendoseni kursorin mbi pikat në diagram për t'i parë koordinatat e asaj pike.

Shitja e DVD-ve në Mbretërinë e Bashkuar

Viti	Numri i DVD-ve të shitura (në miliona)
1998	5
1999	10
2000	20
2001	40
2002	90
2003	140
2004	190
2005	210
2006	230
2007	250
2008	240
2009	210
2010	180
2011	160
2012	140
2013	130
2014	125

PISA 2022

Kamioni për zhvendosje

Hyrje

Lexojeni hyrjen. Më pas klikoni mbi shigjetën TJETER.

KAMIONI PËR SHPËRNGULJE

Familja e Marës po zhvendoset.

Ata mund të zgjedhin për të huazuar një nga dy madhësitë e kamionëve për zhvendosje. Dimensionet e rimorkios së kamionit janë dhënë në tabelën e mëposhtme. Të gjitha muret dhe dyshemetë e rimorkios së kamionit janë drejtkëndor.

Përmasat e Kamionit	Gjatësia e Dyshemesë	Gjerësia e Dyshemesë	Lartësia
A	4 metra	2 metra	2 metra
B	6.6 metra	2.3 metra	2.3 metra

Tri madhësi të kutive janë në dispozicion. Dimensionet e këtyre kutive janë dhënë në tabelën e mëposhtme.

Madhësia e kutisë	Gjatësia	Gjerësia	Lartësia
E vogël	0.4 metra	0.3 metra	0.3 metra
E Mesme	0.5 metra	0.5 metra	0.5 metra
E madhe	0.5 metra	0.5 metra	0.75 metra

PISA 2022

Kamioni për zhvendosje
Pyetja 1 / 2


Referohuni "Kamionit të Shpërnguljes" në të djathtë.
Klikoni një alternativë për t'ju përgjigjur pyetjes.

Familja e Marës vendos ta huazojë kamionin A.

Sa është numri më i madh i kutive të mesme që mund të ngarkohen në kamionin A.

320
 128
 26
 16

KAMIONI PËR SHPËRNGULJE



Hapësira e brendshme - Dimensionet e rimorkios.

Përmasat e Kamionit	Gjatësia e Dyshemesë	Gjerësia e Dyshemesë	Lartësia
A	4 metra	2 metra	2 metra

Dimensionet e kutisë

Madhësia e kutisë	Gjatësia	Gjerësia	Lartësia
E Mesme	0.5 metra	0.5 metra	0.5 metra

PISA 2022

Kamioni për zhvendosje
Pyetja 2 / 2

Referohuni "Kamionit të Shpërnguljes" në të djathtë.
Klikoni një alternativë për t'ju përgjigjur pyetjes.

Kompania e cila i huazon kamionët konfirmoi që kamioni A mund të mbushet vetëm me kuti të mesme ashtu që i tërë rimorkio përdoret.

Mara pohon që një kuti e mesme merr deri në 2/3 e hapësirës së një kutie të madhe, andaj ajo përfundoi se numri i kutive të mëdha që do ta mbushin kamionin A është sa 2/3 e numrit të kutive të mesme.

Cili nga formulimet vijuese për përfundimin e Marës është i saktë

Ajo ka të drejtë, sepse lartësia e kutisë së mesme është sa 2/3 e lartësisë së kutisë së madhe.
 Ajo ka të drejtë, sepse 3 kuti të mesme gjithmonë mund të futen në të njëjten hapësirë sa 2 kuti të mëdha.
 Ajo nuk ka të drejtë, sepse asnjë nga dimensionet e rimorkios së kamionit A nuk janë shumëfishi i 0.75, e cila është lartësia e kutisë së madhe.
 Ajo nuk ka të drejtë, sepse lartësia e kutisë së madhe është 1.5 herë më e madhe se sa e kutisë së mesme.

KAMIONI PËR SHPËRNGULJE

Hapësira e brendshme - Dimensionet e rimorkios.

Përmasat e Kamionit	Gjatësia e Dyshemesë	Gjerësia e Dyshemesë	Lartësia
A	4 metra	2 metra	2 metra

Dimensionet e kutisë

Madhësia e kutisë	Gjatësia	Gjerësia	Lartësia
E Mesme	0.5 metra	0.5 metra	0.5 metra
E madhe	0.5 metra	0.5 metra	0.75 metra

PISA 2022



Rrotullueset

Pyetje 1 / 3

Shihni "Rrotullueset" në anën e djathtë. Klikoni një opsion dhe pastaj shkruani një sqarim për t'u përgjigjur në pyetje.

Piteri mendon se probabiliteti është më i madh që shigjeta të ndalet në të kaltër të Rrotulluesja A se sa të Rrotulluesja B.

A ka të drejtë Piteri?

- Po
 Jo

Sqarojeni përgjigjen tuaj.

RROTULLUESET


Klasa e Piterit do të bëjë një eksperiment duke përdorur dy rrotullueset e paraqitura më poshtë.

Rrotulluesja A është ndarë në dy pjesë të të njëjtës madhësi, njëra është e kaltër dhe tjetra është e kuqe. Rrotulluesja B është ndarë në katër pjesë të të njëjtës madhësi, dy që janë të kaltra dhe dy që janë të kuqe.

Nxënësit i kanë marrë këto udhëzime: nëse shigjeta ndalet në një vijë mes dy pjesëve, atëherë rrotullimi nuk duhet të numërohet dhe duhet përsëri ta rrotullojnë shigjetën.



Rrotulluesja A



Rrotulluesja B

XIV. Fusha e shkencës

Shkenca⁷ e ka vendin e saj në tabelën e kurrikulës së bashku me matematikën dhe shkrim-leximin për dy arsye themelore:

Së pari, njohuritë shkencore përfaqësojnë një arritje të madhe kulturore dhe intelektuale. Shkenca ka ndryshuar rrënjësisht të kuptuarit tonë për universin ku ne banojmë, natyrën e trupit të njeriut, çështjet që na rrethojnë, mënyrën se si u krijuam, transmetimin e sëmundjeve dhe parandalimin e saj dhe shumë e shumë më tepër se kaq. Arsimi është mënyra se si kjo arritje transmetohet në brezat e ardhshëm.

Së dyti, njohuria dhe të kuptuarit e shkencës dhe mënyrave në të cilat ajo gjeneron njohuri të besueshme, është thelbësore për qytetarët që duhet të marrin vendime personale të informuara për fenomene të lidhura me shkencën si shëndeti dhe mjedisi, për t'u përfshirë në veprime brenda familjeve të tyre, komunitetet lokale dhe shoqëritë më të gjera. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në shekullin e 21-të, kur njerëzimi përballlet me një të ardhme të pasigurt ndërsa hyn në epokën njerëzore ('antropocene), një epokë në të cilën ndikimi njerëzor po ndryshon ndjeshëm sistemet e Tokës dhe njohuritë e shkencës kanë rëndësi në nivele individuale, rajonale dhe globale, për të adresuar këto ndikime.

Fusha e shkencës në PISA 2025 është fushë prioritare dhe rezultatet e edukimit shkencor për 15-vjeçarët në PISA 2025, përcaktohen nga tri kompetenca:

Kompetencat shkencore - Një person i arsimuar shkencërisht mund të përfshihet në bisedime (diskurs) të arsyetuar rreth shkencës, qëndrueshmërisë dhe teknologjisë, për të informuar veprimet.

Kompetencat shkencore që do të vlerësohen janë për të:

1) Shpjeguar fenomenet shkencërisht	→ Të njohë, ndërtojë, zbatojë dhe vlerësojë shpjegimet për një sërë dukurish natyrore dhe teknologjike.
2) Ndërtuar dhe vlerësuar dizajne për kërkimin shkencor dhe interpretuar të dhënat dhe provat shkencore në mënyrë kritike	→ Të vlerësojë mënyrat e hetimit/hulumtimit shkencor të pyetjeve dhe interpretojë dhe gjykoj në mënyrë kritike të dhënat shkencore.
3) Hulumtuar, vlerësuar dhe përdorur informacionin shkencor për vendimmarrje dhe veprim	→ Të marrë informacion shkencor mbi një çështje specifike globale, lokale ose personale që ka të bëjë me shkencën dhe vlerësojë besueshmërinë e tij, të metat e mundshme dhe ndikimet për vendimet personale dhe të përbashkëta.

Të gjitha kompetencat kërkojnë njohuri, si për shembull:

- shpjegimi i fenomeneve në mënyrë shkencore, kërkon njohuri të përmbajtjes shkencore (njohuri përmbajtësore) dhe përveç kësaj, natyrën e shpjegimeve shkencore dhe provat që i mbështesin ato.
- njohuritë e përmbajtjes shkencore gjithashtu mund të përdoren për të njohur ose zhvilluar hipoteza paraprake shpjeguese në kontekste ku ka mungesë njohurish ose të dhënash.
- 15-vjeçarët duhet të jenë në gjendje të shpjegojnë implikimet e mundshme të njohurive shkencore për shoqërinë (për shembull, njohuri për sjelljen e viruseve dhe baktereve për të

⁷ https://pisa-framework.oecd.org/science-2025/assets/docs/PISA_2025_Science_Framework.pdf

informuar një politikë të mirë sociale për të parandaluar transmetimin, ose njohuri për proceset kimike për të informuar zgjidhje më të qëndrueshme, p.sh. zhvillimi i baterive me jetëgjatësi).⁸

Kompetenca e dytë dhe e tretë kërkojnë më shumë njohuri të asaj që ne dimë dhe varen nga të kuptuarit se si krijohet njohuria shkencore dhe shkalla e besimit në të cilën njohuria mbështetet.

Nivelet e njohurisë në fushën e shkencës, sipas OECD-së ndahen sipas niveleve të thellësisë kognitive duke e bërë përshkrimin dhe pikëzimin e rezultatit të tyre nga kufiri më i ulët deri tek më i larti.

Tabela në vijim, paraqet një përmbledhje të përshkrimit të shtatë niveleve të njohurisë shkencore në PISA 2022

Niveli	Kufiri i pikëve nga më i ulëti	Përqindja e nxënësve që janë në gjendje të kryejnë detyra në çdo nivel apo më lart (mesatarja e OECD)	Karakteristikat e detyrave
6	708	1.2%	Në nivelin 6, nxënësit mund të përdorin një sërë idesh dhe konceptesh shkencore të ndërlidhura nga shkencat fizike, të jetës, të tokës dhe të hapësirës si dhe të përdorin njohuritë përmbajtësore, procedurale dhe epistemike, për të ofruar hipoteza shpjeguese për fenomenet e reja shkencore, ngjarjeve dhe proceseve ose për të bërë parashikime. Në interpretimin e të dhënave dhe provave, ata janë në gjendje të bëjnë dallimin midis informacionit përkatës dhe të parëndësishëm dhe mund të përdorin njohuritë jashtë kurrikulës shkollore. Ata mund të bëjnë dallimin midis argumenteve që bazohen në teorinë dhe provat shkencore dhe të tyre të bazuara në faktorë të tjerë. Nxënësit e nivelit 6 mund të vlerësojnë projektet konkurruese të eksperimenteve komplekse, studimeve në terren ose simulimeve dhe të arsyetojnë zgjedhjet e tyre.
5	633	7.5%	Në nivelin 5, nxënësit mund të përdorin ide ose koncepte abstrakte shkencore për të shpjeguar dukuritë e panjohura dhe më komplekse, ngjarjet dhe proceset që përfshijnë lidhje të shumta shkakore. Ata janë në gjendje të aplikojnë njohuri më të sofistikuara epistemike për të vlerësuar projektet eksperimentale alternative, për të arsyetuar zgjedhjet e tyre dhe për të përdorur njohuritë teorike për të interpretuar informacione, ose për të bërë parashikime. Nxënësit e nivelit 5 mund të vlerësojnë mënyrat e hulumtimit shkencor të një çështjeje dhe të identifikojnë kufizimet në interpretimet e grupeve të të dhënave, duke përfshirë burimet dhe efektet e pasigurta në të dhënat shkencore.
4	559	24.6%	Në nivelin 4, nxënësit mund të përdorin njohuri të përmbajtjes më komplekse ose më abstrakte, të cilat sigurohen ose kujtohen, për të ndërtuar shpjegime për ngjarjet dhe proceset më komplekse ose më pak të

⁸ https://pisa-framework.oecd.org/science-2025/assets/docs/PISA_2025_Science_Framework.pdf

DORACAK PËR SHKOLLA VLERËSIMI NDËRKOMBËTAR
PISA NË LEXIM, MATEMATIKË DHE SHKENCË

			njohura. Ata mund të kryejnë eksperimente që përfshijnë dy ose më shumë variabla të pavarura në një kontekst të kufizuar. Ata janë në gjendje të arsyetojnë një dizajn eksperimental duke u mbështetur në elemente të njohurive procedurale dhe epistemike. Nxënësit e nivelit 4 mund interpretojnë të dhënat e nxjerra nga një grup të dhënash mesatarisht komplekse ose më pak të njohura, të nxjerrin përfundime të përshtatshme që shkojnë përtej të dhënave dhe japin arsyetime për zgjedhjet e tyre.
3	484	50.3%	Në nivelin 3, nxënësit mund të përdorin njohuri të përmbajtjes mesatarisht komplekse për të identifikuar ose ndërtuar shpjegime të dukurive të njohura. Në situata më pak të njohura ose më komplekse, ata mund të ndërtojnë shpjegime me mbështetje përkatëse. Ata mund të përdorin elemente të njohurive procedurale ose epistemike për të kryer një eksperiment të thjeshtë në një kontekst të kufizuar. Nxënësit e nivelit 3 janë në gjendje të bëjnë dallimin midis çështjeve shkencore dhe joshkencore dhe të identifikojnë provat që mbështesin një pretendim shkencor.
2	410	75.5%	Në nivelin 2, nxënësit janë në gjendje të përdorin njohuritë e përditshme të përmbajtjes dhe njohuritë themelore procedurale për ta identifikuar një shpjegim të duhur shkencor, për të interpretuar të dhëna dhe për të identifikuar pyetjen që trajtohet në një dizajn të thjeshtë eksperimental. Ata mund të përdorin njohuritë shkencore bazë ose të përditshme për të identifikuar një përfundim të vlefshëm nga një grup i thjeshtë i të dhënave. Nxënësit e nivelit 2 demonstrojnë njohuritë bazë epistemike duke qenë në gjendje të identifikojnë pyetjet që mund të hulumtohen në mënyrë shkencore.
1 a	335	92.6%	Në nivelin 1a, nxënësit janë në gjendje të përdorin përmbajtje themelore ose të përditshme dhe njohuri procedurale, për të njohur ose identifikuar shpjegime të dukurive të thjeshta shkencore. Me mbështetje, ata mund të ndërmarrin kërkime të strukturuar shkencore me jo më shumë se dy variabla. Ata janë në gjendje të identifikojnë marrëdhënie të thjeshta shkakore ose korrelative dhe të interpretojnë të dhëna grafike dhe vizuale që kërkojnë një nivel të ulët të kërkesës njohëse. Nxënësit e nivelit 1a mund të zgjedhin shpjegimin më të mirë shkencor për të dhënat në kontekste të njohura personale, lokale dhe globale.
1 b	261	98.9%	Në nivelin 1b, nxënësit mund të përdorin njohuritë themelore ose të përditshme për të njohur aspektet e fenomeneve të njohura apo të thjeshta. Ata janë në gjendje të identifikojnë modele të thjeshta në të dhëna, të njohin termat shkencorë dhe të ndjekin udhëzimet e qarta për të kryer një procedurë shkencore.

XV. Shembuj nga fusha e shkencës nga testi PISA 2018

VRAPIMI NË KOHË TË NXEHTË – HYRJE

PISA 2025


Vrapimi në kohë të nxehtë/ngrohtë

HYRJE

Gjatë vrapimit në distancë të gjatë, temperatura e trupit rritet dhe ndodh djersitja.

Nëse vrapuesit nuk pijnë mjaftueshëm për ta zëvendësuar ujin të cilin ata e humbin gjatë djersitjes, ata mund të dehidrohen. Humbja e ujit për 2% dhe më lartë të masës trupore konsiderohet si gjendje dehidruese. Kjo përqindje është etiketuar në matësin (metrin) e humbjes së ujit, të paraqitur më poshtë.

Nëse temperatura e trupit rritet në 40°C dhe më lartë, vrapuesit mund të përjetojnë një gjendje kërcënuese për jetën e ashtuquajtur 'sulm'. Kjo temperaturë është etiketuar në termometrin e temperaturës së trupit të paraqitur më poshtë.



Metri	Vlerë	Shprehje
Humbja e ujit (%)	2	Dehidrimi
Temperatura e trupit (°C)	40	Sulmi nga nxehtësia

Ky shembull paraqet një kërkim shkencor rreth termorregullimit në kontekstin e trajnimit të vrapuesve në distanca të gjata në një vend ku kushtet e motit ndonjëherë janë të nxehta dhe/ose të lagështa. Simulimi u mundëson nxënësve të manipulojnë temperaturën e ajrit dhe nivelet e lagështisë së ajrit, si dhe nëse vrapuesi i simuluar pi ujë apo jo.

Për çdo provë, paraqiten të dhëna në lidhje me variablat e përzgjedhur, duke përfshirë: temperaturën e ajrit, lagështinë e ajrit, pirjen e ujit (po/jo), vëllimin e djersës, humbjen e ujit dhe temperaturën e trupit. Vëllimi i djersës së vrapuesit, humbja e ujit dhe temperatura e trupit shfaqen gjithashtu në panelin e sipërm në panelin e simulimit. Kur kushtet shkaktojnë dehidrim ose goditje të nxehtësisë, këto rreziqe shëndetësore shënohen me flamuj të kuq.

VRAPIMI NË KOHË TË NXEHTË – PRAKTIKONI

Përpara fillimit të shembullit, nxënësit njihen me kontrollet e simulimit dhe u kërkohet të praktikojnë vendosjen e çdo kontrolli. Mesazhet e ndihmës shfaqen nëse nxënësit nuk kryejnë veprimet e kërkuara brenda 1 minute. Nëse nxënësit pushojnë duke mos vepruar brenda 2 minutave, atyre u tregohet se si do të dukej simulimi nëse kontrollet do të vendoseshin siç specifikohet në udhëzimet e dhëna. Siç shpjegohet në orientimin që nxënësit marrin përpara se të fillojnë seksionin "Shkenca", përkujtuesit për mënyrën e përdorimit të kontrolleve, si dhe se si të zgjedhin ose fshijnë një rresht të dhënash të cilat janë të disponueshme në çdo ekran pyetjeje duke klikuar në "Si të ekzekutoni simulimin Skeda " në panelin e majtë.

PISA 2025

Vrapimi në kohë të nxehtë/ngrohtë


Simulimi është bazuar në një model që e llogaritë vëllimin e djersitjes, humbjen e ujit dhe temperaturën së trupit të vrapuesit pas një ore vrapim.

Për të parë se si funksionojnë të gjitha kontrollet në këtë simulim, përcjellni hapat në vijim:

1. Lëvize treguesin për **Temperaturën e Ajrit**.
2. Lëvize treguesin për **Lagështinë e Ajrit**.
3. Shtype (kliko) "Po" ose "Jo" për **Ujin e pijshëm**.
4. Shtype pullën "Vrapo" për të parë rezultatet.

Vërejeni se humbja e ujit për 2% dhe më lartë e shkakton dehidratimin, dhe temperatura e trupit më e lartë se 40°C dhe më lartë shkakton sulmin nga nxehtësia. Rezultatet, poashtu do të shfaqen në tabelë.

Shënim: rezultatet e paraqitura në simulim janë bazuar në një model të thjeshtëzuar matematikor, për ate se si funksionon trupi për individë të caktuar pas vrapimit një orësh, në gjendje të ndryshme.



Temperatura e ajrit (°C) 20 25 30 35 40

Lagështia e Ajrit (%) 20 40 60

Uji i pijshëm Po Jo

Vrapim

Temperatura e ajrit (°C)	Lagështia e Ajrit (%)	Uji i pijshëm	Vëllimi i djersitjes (litër)	Humbja e ujit (%)	Temperatura e trupit (°C)

VRAPIMI NË KOHË TË NXEHTË – PYETJA 1

PISA 2025

Vrapimi në kohë të nxehtë/ngrohtë

Vazhdo me simulimin për të mbledhur të dhëna bazuar në informatat më poshtë. Zgjedhë nga menyja lartë – poshtë për t’iu përgjigjur pyetjes.

Vrapuesi vrapon një orë në një ditë të nxehtë dhe të thatë (temperatura e ajrit 40°C, lagështia e ajrit për 20%). Vrapuesi nuk pi fare ujë.

Me çfarë rreziku përballet vrapuesi nën këto kushte?

Rreziku për shëndetin me të cilin ballafaqohet vrapuesi është .
Kjo është paraqitur nga vrapuesi pas një ore vrapim.

Temperatura e ajrit (°C)	Lagështia e Ajrit (%)	Uji i pijshëm	Vëllimi i djersitjes (litër)	Humbja e ujit (%)	Temperatura e trupit (°C)
40	20	Jo	1,6	2,3	39,8

Nxënësve u kërkohet të përdorin simulimin dhe të dhënat që ata gjenerojnë për të identifikuar nëse personi që vrapon në kushtet e specifikuara është në rrezik ose nga dehidrimi ose nga goditja e nxehtësisë. Atyre u kërkohet gjithashtu të specifikojnë nëse kjo tregohet nga vëllimi i djersës së vrapuesit, humbja e ujit ose temperatura e trupit.

Lloji i pyetjes	Zgjidhje komplekse me zgjidhje të shumëfishtë
Kompetenca	Interpretimi i të dhënave dhe dëshmive shkencërisht
Njohuri – Sistemi	Procedurale -Jetesa
Konteksti	Personal-Shëndeti dhe Sëmundjet
Vështirësia	497– Niveli 3

Kodimi

- Kredi (Pikë) të plota

Nxënësi përzgjedh:

Rreziku për shëndetin që has vrapuesi është (dehidrimi/1goditja e nxehtësisë).

Kjo tregohet nga (vëllimi i djersës/humbja e ujit/temperatura e trupit) të vrapuesit pas një vrapimi prej një ore.

Koment

Në këtë pyetje, nxënësve u jepen vlera specifike për secilën nga variablat në simulim. Ata duhet të vendosin kontrollet siç janë specifikuar dhe të ekzekutojnë simulimin një herë. Shfaqet një flamur i kuq që tregon se në këto kushte vrapuesi do të vuante nga humbja e ujit që çon në dehidrim. Kjo është pyetja më e lehtë në këtë shembull, që kërkon nga nxënësit të kryejnë një procedurë të thjeshtë, të identifikojnë gjendjen e theksuar në ekran siç tregohet më poshtë dhe të interpretojnë ekranin për të identifikuar saktë humbjen e ujit si shkakun e dehidrimit të vrapuesit.

1. Vini re se nënvizimi tregon përgjigjen e saktë.

VRAPIMI NË KOHË TË NXEHTË – PYETJA 2

PISA 2025

Vrapimi në kohë të nxehtë/ngrohtë

Vazhdo me simulimin për të mbledhur të dhëna bazuar në informatat më poshtë. Shtyp (kliko) në zgjedhjen dhe pastaj zgjedhi të dhënat në tabelë për t'iu përgjigjur pyetjes.

Vrapuesi vrapon për një orë në kohë të nxehtë dhe të lagësht (temperatura e ajrit 35°C, dhe lagështia e ajrit 60%) pa pirë fare ujë. Ky vrapues është në rrezik të dehidrimit dhe sulmit nga nxehtësia.

Cili do të ishte efekti i pirjes së ujit gjatë vrapimit lidhur me rrezikun e vrapuesit nga dehidratimi dhe sulmi nga nxehtësia?

- Pirja e ujit do ta zvogëlojë rrezikun e sulmit nga nxehtësia por jo dehidrimin.
- Pirja e ujit do ta zvogëlojë rrezikun e dehidrimit por jo të sulmit nga nxehtësia.
- Pirja e ujit do ta zvogëlojë edhe rrezikun e sulmit nga nxehtësia edhe dehidrimin.
- Pirja e ujit nuk do ta zvogëlojë as rrezikun e sulmit nga nxehtësia dhe as dehidrimin.

Zgjedhi dy rreshta të të dhënave në tabelë për ta mbështetur përgjigjen tuaj.

Temperatura e ajrit (°C)	Lagështia e Ajrit (%)	Uji i pijshëm	Vëllimi i djerstjes (litër)	Humbja e ujit (%)	Temperatura e trupit (°C)
35	60	Jo	1,8	2,5	40,5
35	60	Po	1,8	0,0	40,5

Lloji i pyetjes	Zgjedhje e thjeshtë e shumëfishtë/Përgjigje e hapur
Kompetenca	Interpretimi i të dhënave dhe dëshmive shkencërisht
Njohuri Sistemi	Përmbajtja e Sistemit – Jetesa
Konteksti	Personal-Shëndeti dhe Sëmundjet
Vështirësia	580 – Niveli 4

Kodimi

Kredi (Pikë) të plota

Nxënësi përzgjedh:

Pirja e ujit do të zvogëlonte rrezikun e dehidrimit, por jo goditjen nga nxehtësia DHE zgjedh dy rreshtat e mëposhtëm në tabelën e të dhënave:

- Temperatura e ajrit është vendosur në 35°C, lagështia e ajrit 60% dhe "Jo" për ujin e pijshëm. DHE

- Temperatura e ajrit është vendosur në 35°C, lagështia e ajrit 60% dhe "Po" për ujin e pijshëm.

Kredi (Pikë) të pjesshme

Nxënësi përzgjedh:

Pirja e ujit do të zvogëlonte rrezikun e dehidrimit, por jo goditjen nga nxehtësia DHE zgjedh të dhëna të pasakta ose jo të plota.

Koment

Në pyetjen 2, nxënësve u kërkohet të ekzekutojnë simulimin duke mbajtur temperaturën dhe lagështinë e ajrit konstante, duke përdorur vlera të specifikuar dhe ata duhet të manipulojnë variablin nëse vrapuesi pi apo jo ujë. Simulimi tregon se vrapimi në kushtet e specifikuar pa ujë të pijshëm çon në dehidrim dhe në goditje të nxehtësisë. Në të kundërtën, pirja e ujit zvogëlon rrezikun e dehidrimit, por jo rrezikun e goditjes nga nxehtësia. Nxënësit duhet ta ekzekutojnë simulimin dy herë në mënyrë që të mbledhin të dhënat që mbështesin përgjigjen e tyre. Për shkak se nxënësit duhet të manipulojnë një variabël dhe të krahasojnë rezultatet e dy provave, kjo pyetje është më e vështirë se pyetja e parë në këtë shembull.

VRAPIMI NË KOHË TË NXEHTË – PYETJA 3A DHE 3B

Lloji i pyetjes	Zgjedhja e shumëfishtë dhe përgjigje e hapur (zgjidhni të dhëna) - Kodim me kompjuter
Kompetenca	Vlerësimi dhe projektimi i kërkimit shkencor 3A
Njohuri – Sistemi	Përmbajtja e Sistemit – Jetesa
Konteksti	Personal-Shëndeti dhe Sëmundjet
Vështirësia	531 – Niveli 3

Lloji i pyetjes	Pyetje e hapur – Kodim manual
Kompetenca	Shpjegon fenomenet shkencërisht 3B
Njohuri – Sistemi	Përmbajtja e Sistemit – Jetesa
Konteksti	Personal-Shëndeti dhe Sëmundjet
Vështirësia	6411 – Niveli 5

Kodimi

3A • Kredi (Pikë) të plota

Nxënësi përzgjedh:

Vëllimi i djersës rritet.

DHE

Dy rreshtat e përzgjedhur duhet të kenë lagështinë e ajrit 60% dhe të përzgjedhura dy temperatura të ndryshme të ajrit (njëra më e ulët dhe një më e lartë – si 20°C në një rresht dhe 25°C në rreshtin e dytë ose 35°C në një rresht dhe 40°C në të dytën, etj.) Përveç kësaj, uji i pijshëm duhet të ketë të njëjtin cilësim (ose "Po" ose "Jo") në të dy rreshtat e zgjedhur.

3B • Kredi (Pikë) e plotë

Përgjigja e nxënësit tregon ose nënkupton funksionin e djersës në ftohjen e trupit dhe/ose rregullimin e temperaturës së trupit.

Djersa avullohet për të ftohur trupin kur temperaturat janë të larta.

Rritja e niveleve të djersës në temperatura të larta e mban trupin të mos nxehet shumë.

Djersa ndihmon në ruajtjen e temperaturës së trupit në një nivel të sigurt.

Koment

Ky grup përfshin dy pyetje të koduara veçmas: 3A është një pyetje me zgjedhje të shumëfishta dhe gjithashtu kërkon përzgjedhjen e të dhënave për të mbështetur atë përgjigje; 3B u kërkon nxënësve të shpjegojnë arsyen e rritjes së vëllimit të djersës sipas kushteve specifike.

Në 3A, përcaktohet një variabël - niveli i lagështisë - dhe nxënësit duhet të ekzekutojnë simulimin duke përdorur të paktën dy temperatura të ndryshme për të treguar efektin e rritjes së temperaturës në vëllimin e djersës. Nxënësit duhet të identifikojnë të paktën dy rreshta në tabelën e të dhënave që mbështesin përgjigjen e tyre. Kjo pyetje i takon nivelit 3.

Pyetja 3B është pyetja më e vështirë, i takon nivelit 5. Ajo kërkon që nxënësit të mbështeten në njohuritë e tyre për biologjinë (njohuri për përmbajtjen) për të shpjeguar se djersitja ftoh trupin në temperatura më të larta.

Vrapimi në kohë të nxehtë/ngrohtë

Vazhdo me simulimin për të mbledhur të dhëna bazuar në informatat më poshtë. Shtyp (kliko) në zgjedhjen, zgjedhi të dhënat në tabelë, dhe pastaj shtype përgjigjen për t'iu përgjigjur pyetjes.

Bazuar në simulimin, ku lagështia e ajrit është 40%, cila është temperatura më e lartë e ajrit në të cilën personi mund të vrapojë për një orë pa pësuar sulm nga nxehtësia?

20°C
 25°C
 30°C
 35°C
 40°C

Zgjedhi dy rreshta të të dhënave në tabelë për ta mbështetur përgjigjen tuaj.

Shpjego se si këto të dhëna e mbështesin përgjigjen tuaj.

Temperatura e ajrit (°C)	Lagështia e Ajrit (%)	Uji i pijshëm	Vëllimi i djersitjes (litër)	Humbja e ujit (%)	Temperatura e trupit (°C)
20	40	Po	0,8	0,0	38,8
25	40	Po	1,0	0,0	39,0
30	40	Po	1,2	0,0	39,3
35	40	Po	1,5	0,0	39,8
40	40	Po	1,9	0,0	40,7

Lloji i pyetjes	Përgjigje e hapur – e koduar nga njeriu
Kompetenca	Vlerësimi dhe projektimi i kërkimit shkencor
Njohuri – Sistemi	Përmbajtja e Sistemit – Jetesa
Konteksti	Personal-Shëndeti dhe Sëmundjet
Vështirësia	592 – Niveli 4

Kredi (Pikë) të plota

Nxënësi përzgjedh **35°C**

DHE

Dy rreshtat e përzgjedhur kanë 40% lagështi në temperaturën e ajrit 35°C dhe lagështi 40% në temperaturën e ajrit 40°C.

DHE

Nxënësi jep një shpjegim që tregon ose nënkupton se në lagështinë 40%, 35°C është temperatura më e lartë e ajrit që është e sigurt nga goditja e nxehtësisë, pasi lëvizja e temperaturës së ajrit nga 35°C në 40°C e vë vrapuesin në goditje të nxehtësisë.

Ndërsa temperatura e jashtme rritet nga 35° në 40°C , temperatura e trupit shkon mbi 40° , duke e vënë vrapuesin në goditje të nxehtësisë.

Në lagështinë 40%, vrapimi në temperaturën e ajrit 40°C çon në goditje të nxehtësisë, por në 35°C temperatura e trupit të vrapuesit mbetet pak nën nivelin e goditjes nga nxehtësia.

Kur temperatura e ajrit rritet, 40°C është hera e parë që vrapuesi pëson goditje nga nxehtësia.

Kur lagështia është 40%, vrapuesi merr goditje nga nxehtësia vetëm në 40°C . Temperatura tjetër më e lartë është 35°C .

40°C , jo 35°C . [Përgjigja minimale]

Kredi (Pikë) të pjesshme

Nxënësi përzgjedh **35°C** DHE

Dy rreshtat e përzgjedhur kanë 40% lagështi në temperaturën e ajrit 35°C dhe lagështi 40% në temperaturën e ajrit 40°C .

DHE

Shpjegimi i nxënësit mungon, është i paqartë ose i pasaktë.

OSE

Nxënësi përzgjedh **35°C** .

DHE

Rreshtat e sakta nuk janë përzgjedhur.

DHE

Nxënësi jep një shpjegim të saktë.

OSE

Nxënësi përzgjedh **40°C** .

DHE

Dy rreshtat e përzgjedhur kanë 40% lagështi në temperaturën e ajrit 35°C dhe lagështi 40% në temperaturën e ajrit 40°C .

DHE

Nxënësi jep një shpjegim që tregon ose nënkupton se me lagështinë 40%, 35°C është temperatura më e lartë e ajrit që është e sigurt nga goditja e nxehtësisë.

Shënim: Këtij kombinimi të fundit i jepet kredi (pikë) sepse nxënësit thjesht mund ta interpretojnë pyetjen si: “Cila është temperatura më e ulët që është e pasigurt?”

Koment

Në këtë pyetje, përcaktohet një variabël. Me një lagështi të caktuar ajri prej 40%, nxënësit duhet të bëjnë të paktën dy prova për të përcaktuar temperaturën më të lartë në të cilën një person mund të vrapojë pa marrë goditje nga nxehtësia. Ata duhet të përdorin njohuritë procedurale për të shpjeguar se si të dhënat që kanë mbledhur mbështesin përgjigjen e tyre duke treguar se në lagështinë 40%, një temperaturë e ajrit më e lartë se 35°C rezulton në goditje të nxehtësisë.

VRAPIMI NË KOHË TË NXEHTË - PYETJA 5

PISA 2025

Vrapimi në kohë të nxehtë/ngrohtë

Vazhdo me simulimin për të mbledhur të dhëna bazuar në informatat më poshtë. Shtyp (kliko) në zgjedhjen, zgjedhi të dhënat në tabelë, dhe pastaj shtype përgjigjen për t'iu përgjigjur pyetjes.

Simulimi ju lejon juve që të zgjedhni 20%, 40% apo 60% për lagështinë e ajrit.

A pritni që vrapimi për një orë të jetë i sigurtë apo i pasigurtë, derisa pirja e ujit me lagështin e ajrit është 50% dhe temperatura e ajrit është 40°C?

I sigurtë
 I pasigurtë

Zgjedhi dy rreshta të të dhënave në tabelë për ta mbështetur përgjigjen tuaj.

Shpjego se si këto të dhena e mbështesin përgjigjen tuaj.

Temperatura e ajrit (°C)	Lagështia e Ajrit (%)	Uji i pijshëm	Vëllimi i djersitjes (litër)	Humbja e ujit (%)	Temperatura e trupit (°C)
40	20	Po	1,6	0,0	39,8
40	40	Po	1,9	0,0	40,7
40	60	Po	2,5	0,0	41,2

Lloji i pyetjes	Përgjigje e hapur – e koduar nga njeriu
Kompetenca	Vlerësimi dhe projektimi i kërkimit shkencor
Njohuri – Sistemi	Përmbajtja e Sistemit – Jetesa
Konteksti	Personal-Shëndeti dhe Sëmundjet
Vështirësia	598 – Niveli 4

Kodimi

Kredi (Pikë) të plota

Nxënësi përzgjedh **Të pasigurt**

DHE

Dy rreshtat e përzgjedhur kanë:

- Lagështia 40% në 40°C me ujë të pijshëm = Po, dhe
- Lagështia 60% në 40°C me ujë të pijshëm = Po

DHE

Nxënësi jep një shpjegim që tregon se kur vrapuesi vuan nga goditja nga nxehtësia me lagështi 40% dhe 60%, ekziston rreziku i goditjes nga nxehtësia me lagështi 50% në të njëjtat kushte. Me një temperaturë prej 40°C dhe me ujin e pijshëm, vrapuesi do të përjetojë goditje nga nxehtësia me lagështi 40% dhe 60%, kështu që vrapuesi ndoshta do të përjetojë goditje të nxehtësisë midis këtyre dy niveleve të lagështisë, në 50%.

50% është në gjysmë të rrugës midis 40% dhe 60%, dhe të dyja këto nivele përfshijnë goditje të nxehtësisë, kështu që ndoshta përfshin 50% gjithashtu.

40% është e pasigurt, kështu që më e lartë se kaq do të jetë më keq. [Përgjigja minimale. Me një përzgjedhje të saktë të të dhënave, kjo përgjigje mund të lexohet se shpjegon se si të dhënat mbështesin një përzgjedhje të pasigurt për 50%.]

Kredi (Pikë) të pjesshme

Nxënësi përzgjedh **Të pasigurt**

DHE

Dy rreshtat e përzgjedhur kanë:

Lagështia 40% në 40°C me ujë të pijshëm=Po dhe

Lagështia 60% në 40°C me ujë të pijshëm=Po

DHE

Shpjegimi i nxënësit mungon, është i paqartë ose i pasaktë.

OSE

Nxënësi përzgjedh **Të pasigurt**

DHE

Rreshtat e sakta **nuk** janë përzgjedhur

DHE

Nxënësi jep një shpjegim të saktë duke iu referuar rezultateve të simulimit.

Koment

Kjo pyetje kërkon që nxënësit të ekstrapolojnë përtej të dhënave që mund të mblidhen drejtpërdrejt përmes simulimit. Ata duhet të zhvillojnë një hipotezë për sigurinë e vrapimit në 40°C me lagështi 50% të ajrit, ku vetëm nivelet e lagështisë 40% dhe 60% janë të disponueshme në mjetet e simulimit. Përgjigja e saktë është se do të ishte e pasigurt dhe nxënësit duhet të zgjedhin një rresht me një nivel lagështie në 40% dhe një në 60% me temperaturë dhe ujë të pijshëm të vendosur siç specifikohet në pyetje në të dy rreshtat. Shpjegimi duhet të tregojë se, duke pasur parasysh se vrapuesi do të vuante nga goditja e nxehtësisë në lagështinë 40% dhe 60% në 40°C ndërsa pi ujë, ka të ngjarë që goditja nga nxehtësia të ndodhë edhe në lagështinë 50%.

METEORËT DHE KRATERET – PYETJA 1

PISA 2025


Meteorët dhe krateret

Referoju "Meteorët dhe krateret" në të djathtë. Shtyp në zgjedhjen për t'iu përgjigjur pyetjes.

Kur meteori i afrohet tokës dhe atmosferës së saj, ai e rritë shpejtësinë. Pse ndodh kjo?

- Meteori tërhiqet nga rotacioni i Tokës.
- Meteori tërhiqet nga drita e Diellit.
- Meteori joshet nga masa e Tokës.
- Meteori lëviz/kthehet nga vakumi në hapësirë.

Shkëmbinjtë në hapësirë të cilët hyjnë në atmosferën e Tokës quhen meteorë. Meteorët nxehen, dhe shndërrisin duke rënë nëpër atmosferën e tokës. Shumica e meteorëve djegen para se të bijnë në sipërfaqen e tokës. Kur meteori bjen në tokë, mund të bëjë një vrimë që quhet krater.



Lloji i pyetjes	Zgjidhje e thjeshtë e shumëfishtë
Kompetenca	Shpjegimi i fenomeneve shkencërisht
Njohuri – Përmbajtja e Sistemit	Fizikë
Konteksti	Global–kombëtar
Vështirësia	483 – Niveli 2
ID-ja e pyetjes	S641Q01

Kodimi

Kredi (Pikë) të plota

Nxënësi përzgjedh:

Meteori është tërhequr nga masa e Tokës.

Koment

Pyetja 1 kërkon që nxënësit të zbatojnë njohuri të thjeshta shkencore për të zgjedhur shpjegimin e saktë përse objektet përshpejtohen ndërsa i afrohen Tokës. Kjo është përmbajtje e pyetjes e cila kërkon që nxënësit të shpjegojnë fenomenin shkencërisht, është në majën/maksimumin e nivelit 2.

METEORËT DHE KRATERET – PYETJA 2

PISA 2025 [Icons: Calculator, Help, Navigation]


Meteorët dhe krateret

*Referoju "Meteorët dhe krateret" në të djathtë.
Zgjedhe nga menyja lartë poshtë për t'iu përgjigjur pyetjes.*

Cili është efekti i atmosferës së planetit në numrin e kraterëve në sipërfaqen e planetit?

Sa më e trashë që është atmosfera e planetit , kraterë të sipërfaqes së saj do të ketë për shkak se meteorët do të digjen në atmosferë.

Shkëmbinjtë në hapësirë të cilët hyjnë në atmosferën e Tokës quhen meteorë. Meteorët nxehen, dhe shndërrisin duke rënë nëpër atmosferën e tokës. Shumica e meteorëve djegen para se të bijnë në sipërfaqen e tokës. Kur meteori bjen në tokë, mund të bëjë një vrimë që quhet krater.



Lloji i pyetjes	Komplekse me zgjedhje të shumëfishtë
Kompetenca	Shpjegimi i fenomeneve shkencërisht
Njohuri–Përmbajtja e Sistemit	Toka dhe Hapësira
Konteksti	Global – kombëtar
Vështirësia	450 – Niveli 2
ID-ja e pyetjes	S641Q02

Kodimi

Kredi (Pikë) të plota

Nxënësi përzgjedh:

Sa më e trashë që është atmosfera e planetit aq më shumë/më pak kraterë të sipërfaqes së saj do të ketë për shkak se më shumë/më pak meteorët do të digjen në atmosferë.

Koment

Kjo pyetje e Nivelit 2 kërkon që nxënësit të zgjedhin dy përgjigje që shpjegojnë marrëdhënien midis trashësisë së atmosferës së një planeti, gjasave që meteoroidet të digjen në atmosferë dhe për rrjedhojë, numrit të kraterëve që do të jenë në sipërfaqen e planetit.


METEORËT DHE KRATERET – PYETJA 3A dhe 3B¹

PISA 2025

Meteorët dhe krateret

Referoju “Meteorët dhe krateret” në të djathtë.
Përdore tërhiq dhe lësho për t’iu përgjigjur pyetjeve më poshtë:

Konsidero tri krateret në vijim:




Vendosi krateret në rend sipas madhësisë së meteorëve që i kanë shkatuar ata, nga më i madhi tek më i vogli:

	Më i madhi	→	Më i vogli
A			

Vendosi krateret në rend sipas kohës kur janë krijuar, nga më i vjetri tek më i ri:

	Më i vjetri	→	Më i ri
A			

Shkëmbinjtë në hapësirë të cilët hyjnë në atmosferën e Tokës quhen meteorë. Meteorët nxehen, dhe shndërrisin duke rënë nëpër atmosferën e tokës. Shumica e meteorëve djegen para se të bijnë në sipërfaqen e tokës. Kur meteori bjen në tokë, mund të bëjë një vrimë që quhet krater.



Lloji i pyetjes	Me zgjedhje komplekse të shumëfishta (zvarrit dhe lësho)
Kompetenca	Interpretimi i të dhënave dhe dëshmive shkencërisht
Njohuri – Përmbajtja e Sistemit	Toka dhe Hapësira
Konteksti	Global – kombëtar
Vështirësia	3A: 299 - Niveli 1b 3B: 438 - Niveli 2
ID-ja e pyetjes	3A: S641Q03 3B: S641Q04

Kodimi

3A • Kredi (pikë) të plota
Nxënësi rendit krateret: A, C, B.

3B • Kredi (Pikë) të plota
Nxënësi rendit krateret: C, A, B.

Koment

Pyetja 3A, një pyetje bazë për interpretimin e të dhënave, ishte pyetja më e lehtë në vlerësimin shkencor të vitit 2015. Kërkon njohuri të thjeshta, të përditshme që një objekt më i madh do të shkaktonte një krater më të madh dhe një më i vogël do të shkaktonte një krater më të vogël. Pyetja 3B është disi më e vështirë sepse nxënësit duhet të krahasojnë tre krateret e paraqitura në figurë për të përcaktuar kur u formuan krateret, nga më i vjetri tek më i ri, bazuar në mënyrën se si mbivendosen në figurë – p.sh. krateri C duhet të jetë formuar së pari sepse krateri A mbivendos pak C dhe krateri B duhet të jetë krateri më i fundit sepse ndodhet brenda A.

1. Vini re se këto dy pyetje janë identifikuar si Q03 dhe Q04 në kodet e artikujve.

XVI. LITERATURA

1. PISA 2022 Results: The state of learning and equality in Education (https://read.oecd-ilibrary.org/view/?ref=1235_1235421-gumq51fbgo&title=PISA-2022-Results-Volume-I)
2. PISA Test Questions (<https://www.oecd.org/pisa/test/>),
3. Pyetjet për fushën e leximit në gjuhën shqipe (<https://www.oecd.org/pisa/test/other-languages/pisa2018testquestions-otherlanguages.htm>),
4. Summary description of the seven levels of proficiency in science in PISA 2015 (Përmbledhje e përshkrimit të shtatë niveleve të aftësisë në shkencë në PISA 2015), OECD, 2019 (<https://www.oecd.org/pisa/test/summary-description-seven-levels-of-proficiency-science-pisa-2015.htm>)
5. Shembuj të detyrave nga tri fushat e vlerësimit, të nxjerra nga dokumentet publike të OECD-së, (të përkthyer/përshtatura dhe të ofruara nga Zyra e Standardeve/MASHTI-t).

Shënim: Lidhjet më poshtë për qasje në publikimet e OECD-së, për mësimdhënësit dhe të tjerët, me njoftimin për dokumentet/publikimet disa janë të disponueshme edhe në gjuhën shqipe.

1. <https://www.oecd.org/pisa/test/>
2. <https://www.oecd.org/pisa/test/other-languages/pisa2018testquestions-otherlanguages.htm>
3. https://pisa-framework.oecd.org/science-2025/ksv_sqi
4. <https://www.oecd.org/publications/pisa-2022-results-volume-i-53f23881-en.htm>